

# ROLI I TRANSPARENCËS INSTITUCIONALE

NË PËRBALLJE  
ME DEZINFORMATAT  
DHE SPEKULIMET NË  
MAQEDONINË E VERIUT

**Botues:**

Instituti për Studime të Komunikimit, rr. Jurij Gagarin 17-1-1, Shkup www.iks.edu.mk

**Publikuar nga:**

prof. dr. Zaneta Trajkoska

**Edicioni:**

ResPublica

**Autorë:**

prof. dr. Vesna Shopar, prof. dr. Ana Mukoska

**Redaktorë:**

prof. dr. Zaneta Trajkoska, Aleksandra Temenugova

Përkthyer nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe

**Titulli Origjinal:** Улогата на институционалната транспарентност во справувањето со дезинформациите и шпекулациите во Северна Македонија

**Përktheu në shqip:**

Vjosa Taipi

**Dizajni grafik:**

Tatjana Koceva-Spirova

**Redaktim i tekstit:**

Dejan Joveski

Shkup, 2023

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.776.23:[35.075:005.332.5(497.7)](047.31)

SHOPAR, Vesna

Roli i transparencës institucionale në përballje me dezinformatat dhe spekulimet në Maqedoninë e Veriut [Електронски извор] / [autorë Vesna Shopar, Ana Mukoska ; përkthyer nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe, përktheu në shqip Vjosa Taipi]. - Shkup : Instituti për studime të komunikimit, 2023. - (Edicioni ResPublica)

Начин на пристапување (URL):

<https://respublica-edu.mk.b-cdn.net/wp-content/uploads/2023/04/transparentnost-na-instituciite-al.pdf>

- Превод на делото: Улогата на институционалната транспарентност во справувањето со дезинформациите и шпекулациите во Северна Македонија. - Текст во PDF формат, содржи 78 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 18.04.2023. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 54-60. - Содржи и: Aneksi

ISBN 978-608-4805-26-7

1. Mukoska, Ana [автор]

а) Државни органи -- Транспарентност -- Дезинформации -- Спечување -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 60100357

# **ROLI I TRANSPARENCËS INSTITUCIONALE**

**NË PËRBALLJE  
ME DEZINFORMATAT  
DHE SPEKULIMET NË  
MAQEDONINË E VERIUT**

# Përmbajtja

|   |           |
|---|-----------|
| Akronime  | 6         |
| Rezyme  | 7         |
| Hyrje   | 9         |
| <b>1. Rreth hulumtimit</b>  | <b>10</b> |
| 1.1 Qasja metodologjike   | 10        |
| 1.2 Postulatet teorike për transparencën dhe dezinformimin  | 11        |
| 1.2.1 Rreth dezinformimit   | 11        |
| 1.2.2 Rreth transparencës   | 12        |
| 1.3 Marrëdhënia midis dezinformimit dhe transparencës   | 13        |
| 1.4 Metodot dhe rreziqet në ballafaqimin e dezinformative   | 14        |
| <b>2. Rregullativa evropiane për dezinformatat dhe transparencën</b>  | <b>16</b> |
| 2.1 Qasja gjithëpërfshirëse evropiane e BE-së në luftën kundër dezinformative                                 | 16        |
| 2.2 Transparenca si një imperativ i qasjes evropiane  | 21        |
| <b>3. Transparenca institucionale dhe dezinformatat në kontekstin maqedonas</b>                               | <b>23</b> |
| 3.1 Aktet kombëtare në lidhje me transparencën  | 24        |
| Partneritet për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership)  | 24        |
| Strategjia për të dhëna të hapura   | 26        |
| Strategji për transparencë  | 27        |
| 3.2 Aktet kombëtare në lidhje me dezinformatat  | 28        |
| Plani i propozuar për veprim vendimtar kundër përhapjes së dezinformative dhe kundër sulmeve ndaj demokracisë | 29        |
| Dokumente të tjera  | 30        |
| <b>4. Praktika e transparencës së institucioneve shtetërore në luftën kundër dezinformative</b>               | <b>31</b> |
| Në fokus: funksionimi transparent i institucioneve shtetërore   | 31        |
| Në fokus: ballafaqimi me dezinformatat në sferën publike  | 35        |

|  |           |
|--|-----------|
| <b>5. Mediat dhe gazetarët janë në një udhëkryq mes transparencës së institucioneve dhe rritjes së dezinformatave of Institutions and the Inflow of Disinformation</b> | <b>42</b> |
| Për transparencën e pushtetit qendror  | 42        |
| Një vështrim i afërt i një gazetari ndaj dezinformatave  | 46        |
| <b>6. Shënime përfundimtare</b>  | <b>49</b> |
| <b>7. Rekomandime</b>  | <b>52</b> |
| <b>8. Bibliografia</b>   | <b>54</b> |
| <b>Aneksi 1. Rregullativa evropiane për transparencën dhe dezinformatat</b>  | <b>61</b> |
| Komunikatë e Komisionit Evropian për përballim me dezinformata   | 61        |
| Plan veprimi kundër dezinformatave   | 61        |
| Plani Veprimi Evropian për Demokraci   | 62        |
| Kodi i Sjelljes kundër dezinformatave të 2022  | 63        |
| Ligji për shërbime digjitale   | 63        |
| Akti Evropian për lirinë e medias  | 64        |
| Plani i Veprimit Evropian për Media dhe Çështje Audiovizuale   | 64        |
| Observatori Evropian për Media Digjitale   | 65        |
| <b>Aneksi 2. Aktet kombëtare në lidhje me dezinformatat</b>  | <b>66</b> |
| Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike e Republikës së Maqedonisë (2018-2022)   | 66        |
| Strategjia Kombëtare për Ndërtimin e Rezistencës dhe Ballafaqimin me   |           |
| Kërcënimet Hibride   | 67        |
| <b>Aneksi 3. Intervistë - pyetje për institucionet shtetërore - Ministritë</b>   | <b>70</b> |
| 3.a) Pyetje shtesë për ministri të caktuara  | 71        |
| <b>Aneksi 4. Intervistë – pyetje për organet qeveritare</b>  | <b>74</b> |
| <b>Aneksi 5. Pyetje për fokus grupet me gazetarë</b>   | <b>76</b> |

# Akronime

- MPJ** - Ministria e Punëve të Jashtme  
**MM** - Ministria e Mbrojtjes  
**MASH** - Ministria e Arsimit dhe Shkencës  
**MPB** - Ministria e Punëve të Brendshme  
**ME** - Ministria e Ekonomisë  
**MD** - Ministria e Drejtësisë  
**MTL** - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve  
**MPPS** - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale  
**MF** - Ministria e Financave  
**MSH** - Ministria e Shëndetësisë  
**MPPS** - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale  
**MK** - Ministria e Kulturës  
**MSPMNB** - Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive  
**MMJPH** - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor  
**MBPEU** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave  
**MVL** - Ministria e Vetëqeverisjes Lokale  
**MSHIA** - Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës  
**ZQRMV** - Zëvendëskryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut  
**ZPQRMV** - Zyra e Presidentit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut  
**SPQRMV** - Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut  
**ARMV** - Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut  
**ASK** - Agjencia për Siguri Kombëtare  
**AR** - Agjencia për Kundërzbulim  
**AE** - Agjencia për Energjetikë  
**AKE** - Agjencia për Komunikimeve Elektronike  
**ARM** - Agjencia për Rezerva të Mallrave  
**AU** - Akademia Ushtarake  
**DSIK** - Drejtoria për Siguri të Informacioneve të Klasifikuara  
**IKSKFD** - Instituti Kombëtar për Siguri Kibernetike dhe Forenzikë Digjitale  
**RTVM** - Radio Televizioni i Maqedonisë  
**KKSK** - Këshilli Kombëtar për Siguri Kibernetike  
**ÇÇE** - Sekretariati për Çështje Evropiane  
**QMK** - Qendra për Menaxhim me Kriza  
**ENER** - Regjistri Kombëtar Elektronik i dispozitave ligjore i RMV-së .  
**SHGM** - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

# Rezyme

Zhvillimi dhe përhapja e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, ndër të tjera, ka çuar edhe në një rritje të ndikimit të dezinformatave me pasoja të gjera politike në shoqëritë demokratike në mbarë botën. Në epokën digjitale, keqinformimi mund të përhapet shpejt dhe të shkaktojë dëme të konsiderueshme, të minojë besimin tek institucionet dhe të çojë në përhapjen e informacionit të rremë me pasoja potencialisht serioze. Kjo është bërë veçanërisht e dukshme në vitet e fundit, gjatë pandemisë Covid-19 dhe luftës në Ukrainë.

Analiza e Institutit për Studime të Komunikimit (IKS) «Roli i transparencës institucionale në përballjen me dezinformatat dhe spekulimet në Maqedoninë e Veriut» është një përpjekje që në mënyrë konceptuale-hulumtuese të kuptohen marrëdhëniet midis një qeverie të hapur dhe të përgjegjshme ndaj informacioneve të rreme/mashtruese që minojnë besimin në institucionet shtetërore. Në hulumtim, theksi vihet në dy entitete kryesore shoqërore, institucionet e pushtetit qendror dhe mediat (elektronike dhe të shtypura). Në përgjithësi, qëllimi është «zbulimi» nëse dhe sa është (jo)transparenca e institucionet mund të kontribuojnë në (luftën kundër) përhapjes së dezinformatave.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë për sfida të shumta, si në rrafshin normativo-ligjor, organizativ dhe teknologjik-teknik. Në tejkalimin e këtyre sfidave, qasja gjithëpërfshirëse e BE-së për trajtimin e dezinformatave, si dhe normat dhe aktet e përgjithshme të BE-së për transparencën institucionale dhe luftën kundër korrupsionit, ofrojnë udhëzime të dobishme. Rekomandimet e tyre synojnë: forcimin e rezistencës së shoqërive demokratike kundër dezinformimit, mbështetjen e medias së lirë dhe të pavarur dhe gazetarisë cilësore, promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në platformat dhe reklammat online, forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe partnerëve ndërkombëtarë, fuqizimin e qytetarëve duke përmirësuar edukimin mediatik dhe aftësi për mendim kritik.

Transparenca konsiderohet si një nga parakushtet e rëndësishme në luftën kundër korrupsionit. Ky hulumtim tregoi se marrëdhënia ndërmjet transparencës dhe dezinformimit është e ngjashme, pra janë të lidhura në mënyrë të kundërt. Transparenca është shfaqur si një kundërpeshë ndaj dezinformimit, për shkak të rolit të saj në hapjen, ndërtimin e besimit, parandalimin e informacionit të rremë dhe promovimin e informacionit të saktë dhe të hapur. Në kushtet e transparencës dhe hapjes institucionale, zvogëlohet mosbesimi institucional dhe hapësira për përhapjen e dezinformatave. Kjo nuk do të thotë se ajo hapësirë mund të eliminohet plotësisht, sepse në përhapjen e dezinformatave luajnë rol edhe një sërë aktorësh dhe procesesh të tjera shoqërore të ndërthurura, të cilat shpesh nuk kufizohen brenda kufijve shtetërorë. Prandaj, rritja e transparencës institucionale është hapi logjik që mund të ndërmerret për të reduktuar ndikimin e dezinformimit.

Mungesa e transparencës institucionale nënkupton shkurtim të së drejtës së qytetarëve për qasje në informacion, pra marginalizimin e tyre nga proceset vendimmarrëse dhe politikë-bërëse. Këto tendenca jo vetëm që nuk i lejojnë qytetarët të ndjekin vendimmarrjen në qeveri në mënyrë të informuar, por edhe rrisin rrezikun e dezinformimit. Kur institucionet nuk janë transparente për veprimet dhe vendimet e tyre, mungesa e transparencës institucionale mund të çojë në përhapjen e dezinformatave. Kur njerëzit nuk kanë qasje në fakte, ata bëhen i nënshtrohen besimit ndaj keqinformimit. Kur institucionet nuk janë transparente, mund të jetë e vështirë për njerëzit që të dinë se kujt t'i besojnë, duke i bërë ata më të prirë të besojnë në dezinformatat që përputhen me bindjet ose paragjykimet e tyre. Prandaj, siç është rasti me qasjen evropiane, transparenca duhet të luajë një rol kyç në qasjen maqedonase për trajtimin e dezinformimit dhe të konsiderohet si mjet kyç për zgjidhjen e problemit të dezinformimit, pasi u mundëson

përdoruesve të identifikojnë burimet e informacionit dhe të marrin vendime të informuara në lidhje me besueshmërinë e informacionit që ata hasin në internet. Në përgjithësi, transparencja duhet të konsiderohet si një vegël për tu përballur me dezinformatat, pasi ndihmon në krijimin e një mjedisi informacionesh më të hapura, të përgjegjshëm dhe më të besueshëm dhe mbështet përpjekjet e politikëbërësve, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile për të adresuar sfidat e paraqitura nga dezinformatat.

Lufta kundër dezinformimit është një proces kompleks që as mediat, as institucionet, as organizatat e shoqërisë civile, më së paku vetë qytetarët, nuk mund ta luftojnë të vetme. Dhe më e rëndësishmja, është një proces afatgjatë në të cilin një nga faktorët kyç është arsimimi i përgjithshëm dhe edukimi mediatik. Për këtë na duhet një plan strategjik me masa të mira që do të zbatohen në mënyrë konsekuente. Natyrisht, me një përcaktim të qartë të dezinformatave, për të shmangur “kurthin” e interpretimit të lirë, vullnetarist dhe vënien në dyshim të krijimit të politikave dhe masave efikase dhe të koordinuara për të parandaluar përhapjen e dezinformatave.

Gjatë përpjekjes për të rregulluar dezinformatat, është e nevojshme të jeni të vetëdijshëm për rreziqet, më i madhi prej të cilëve lidhet me censurën dhe kufizimin e lirisë së fjalës. Duke marrë parasysh rreziqet e mundshme, qasja më e mirë për ballafaqimin me dezinformatat duhet të synojë zvogëlimin e kushteve për krijimin dhe përhapjen e dezinformatave, në vend që ta censurojë atë. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë është një qasje proaktive dhe jo reaktive, e cila përfshin disa nga qasjet e mëposhtme: rritjen e edukimit mediatik dhe transparencës institucionale, bashkëpunimin e hapur ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë qeveritë, kompanitë teknologjike, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile në gjetjen dhe monitorimin e problemit, nxitja e vetë rregullimit veçanërisht në media dhe media online, investimi në hulumtime dhe reduktimi i përfitimeve strukturore ekonomike nga përhapja e dezinformatave.

Ky studim synon t’u shërbejë politikëbërësve, profesionistëve të medias dhe aktorëve të shoqërisë civile që përpjekin të përmirësojnë transparencën e institucioneve dhe të luftojnë kundër dezinformimit, por edhe atyre që duan të kuptojnë fenomenin e dezinformimit, ndikimin e tij, si dhe rregulloret evropiane dhe kombëtare që synojnë frenimin e tyre.



# Hyrje

Zhvillimi dhe përhapja marramendëse e teknologjive të informacionit dhe komunikimit ka krijuar një sërë sfidash socio-politike për shoqëritë demokratike në mbarë botën. Këto procese u bënë veçanërisht të dukshme në dekadën e dytë të shekullit të 21-të me shfaqjen dhe përdorimin masiv të mediave të reja, dhe veçanërisht u intensifikuan vitet e fundit në kontekstin e pandemisë globale të Covid-19 dhe luftës në Ukrainë. Paralelisht me këto zhvillime, termat si “dezinformim” dhe “fake news” kanë gjetur vendin e tyre si në fjalorë ashtu edhe në realitetin shoqëror, ndërkohë që sjell pasojë politike të gjera (Martens et al, 2018).

Duke pasur parasysh këtë, hulumtimi që synon të studiojë marrëdhëniet e ndërsjella midis dezinformimit dhe proceseve demokratike përfaqëson një hap të parë të domosdoshëm drejt një kuptimi më të mirë të këtyre fenomeneve komplekse sociale, ndikimeve dhe pasojave të tyre. Ky hulumtim synon të japë pikërisht një kontribut të tillë, përmes një analize cilësore të raportit ndërmjet keqinformimit dhe transparencës institucionale në kontekstin maqedonas. Në përpjekje për të hetuar problemin, ai përqendron vëmendjen në transparencën e institucioneve në nivel kombëtar (kryesisht pushtetin ekzekutiv: Qeveria dhe ministritë, si dhe Kuvendi dhe Presidenti), si një nga parakushtet për parandalimin e përhapjes së dezinformimit, por edhe për mediat si një aktor i rëndësishëm në këto procese komplekse.

# Rreth hulumtimit

## 01

**H**ulumtimi është fokusuar, para së gjithash, në dy entitete kryesore shoqërore – institucionet shtetërore në nivel kombëtar dhe masmediat (si mediat tradicionale ashtu edhe ato online). Qëllimi i përgjithshëm është të “zbulohet” nëse dhe në çfarë mase (jo)transparenca e institucioneve të shtetit mund të kontribuojë në (luftën kundër) përhapjes së dezinformatave. Krahas kësaj, hulumtimi synon të përcaktojë rolin e medias në atë “labirint”. Analiza është një përpjekje për t’iu përgjigjur pyetjeve kryesore të mëposhtme:

- *Cila është vetëdija/perceptimi aktual i situatës së dezinformimit, si dhe raporti ndërmjet transparencës dhe dezinformimit midis institucioneve dhe mediave?*
- *A kontribuon dhe si, politika e transparencës, llogaridhënies dhe hapjes së institucioneve shtetërore në nivel kombëtar në luftën kundër fluksit të dezinformatave në sferën publike?*
- *Me çfarë forma dhe metoda specialistët e komunikimit në institucionet shtetërore ushtrojnë transparencën dhe luftën kundër dezinformimit?*
- *Nëse dhe si zbatohen standardet evropiane në legjisllacionin e Maqedonisë për transparencën, llogaridhënien dhe hapjen e institucioneve shtetërore?*
- *A ndikon dhe si ndikon fluksi i dezinformatave dhe manipulimeve, si dhe niveli aktual i transparencës së institucioneve në media dhe gazetarë dhe anasjelltas?*
- *A mund dhe si mund të parandalohen dezinformatat? Çfarë roli mund të luajë zhvillimi i akteve dhe mekanizmave/trupave për parandalimin e dezinformimit dhe me çfarë pasojash të mundshme?*

## 1.1. Qasja metodologjike

Pjesa empirike e hulumtimit shqyrton marrëdhëniet ndërmjet transparencës institucionale dhe dezinformimit në kontekstin maqedonas. Metodologjikisht, hulumtimi bazohet në katër metoda/teknika: desk hulumtimi, analiza e përmbajtjes së dokumenteve përkatëse, fokus grupe me përfaqësues të medias dhe intervista me përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel kombëtar:

- 1) Desk-hulumtimi- analiza e të dhënave dytësore që synojnë analizimin e faqeve të internetit të institucioneve shtetërore (ministrive), planet e veprimit për transparencë dhe dezinformim, raportet mediatike, në mënyrë që të fitohet një pasqyrë e formave, metodave të praktikimit të tyre; si dhe Analiza

e Përmbajtjes – një qasje sasiore-cilësore ndaj dokumenteve kyçe siç janë ligjet, strategjitë, rekomandimet, planet, kodet e rregulloreve evropiane dhe maqedonase për transparencën institucionale dhe dezinformimin.

- 2) Fokus grupet me gazetarët - intervista interaktive në grup me qëllim marrjen e informacionit për perceptimet që ekzistojnë në mesin e gazetarëve të akredituar që ndjekin punën e qeverisë dhe institucioneve qeveritare, për nivelin e transparencës në institucione, si dhe perspektivat e tyre për marrëdhëniet reciproke ndërmjet transparencës dhe dezinformimit. Pyetjet ishin të ndara në dy segmente - një pjesë për transparencën e institucioneve dhe një pjesë për dezinformimin. Janë realizuar 4 fokus grupe me 6-8 gazetarë secili nga media e shtypit (ditore, javore, agjenci lajmesh), stacione televizive (publike dhe private, kombëtare, rajonale), radio (publike, kombëtare, rajonale) dhe media online. Diskutimet kanë përfshirë gjithsej 35 gazetarë nga i njëjti numër mediash që ofrojnë përmbajtje informative ditore. Pyetësorët janë në dispozicion për inspektim në Aneksin 5 të dokumentit.
- 3) Intervistat gjysmë të strukturuar - me përfaqësues të Qeverisë, Kuvendit, Kabinetit të Presidentit dhe institucioneve shtetërore - ministrive, kryesisht të synuara drejt personave përgjegjës për komunikim, menaxherët apo koordinatorët për komunikim, zëdhënësit dhe personat përgjegjës për qasjen në informacion publik. Pyetjet u ndanë në dy blloqe, njëri për transparencën e institucioneve shtetërore dhe i dyti për dezinformimin. Intervistat u kryen në dy mënyra: një pjesë gojarisht (kryesisht me përfaqësues të Qeverisë, Parlamentit dhe Kabinetit të Presidentit të Shtetit), dhe shumica me e-mail (kryesisht me ministrinë). Janë dorëzuar gjithsej 26 pyetësorë dhe janë marrë përgjigje për 20 pyetësorë. Pyetësorët janë në dispozicion për inspektim në Aneksin 3 dhe 4 të dokumentit. Përgjigje janë marrë nga përfaqësues të Kuvendit, Agjencisë për Kundërzbulim, 9 ministrive dhe 8 përfaqësuesve të Qeverisë të ngarkuar me çështjet e transparencës, si dhe nga Kabineti i Presidentit. Të dhënat u mbledhën midis nëntorit 2022 dhe janarit 2023.

## 1.2 Postulatet teorike për transparencën dhe dezinformimin

Kur marrim parasysh kompleksitetin e termave “dezinformim” dhe “transparencë” si koncepte dhe dukuri socio-politike, atëherë bëhet e qartë se sqarimi i marrëdhënies së tyre është një detyrë komplekse, të cilën duhet trajtuar me saktësi shkencore dhe përgjegjësi sociale. Prandaj, analiza e marrëdhënies midis dezinformimit dhe transparencës institucionale duhet të fillojë duke analizuar kuptimin e secilit prej këtyre dy koncepteve individualisht.

### 1.2.1 Rreth dezinformimit

Dezinformimi nënkupton vendosjen e informacionit të verifikueshëm të pasaktë dhe mashtrues, publikimin e tij me qëllim përfitimi ekonomik dhe/ose mashtrimin e qëllimshëm të publikut (Edson et al 2017). Nuk janë një fenomen i ri. Keqinformimi në komunikimin njerëzor ka qenë i pranishëm që në fillimet e qytetërimit dhe krijimit të shoqërive të organizuara. Me ardhjen e mediave elektronike, dezinformimi ka kaluar nga letra në ekranet dhe altoparlantët. Ajo që ka ndryshuar në mënyrë drastike në vitet e fundit është sasia dhe shpejtësia me të cilën ata mund të arrijnë një audiencë të synuar përmes teknologjive të reja dhe të shkaktojnë dëme në interesin publik (Martens et al, 2018).

Në shekullin e 21-të, dezinformimi i referohet shpërndarjes së informacionit të rremë ose mashtrues, shpesh me qëllim të manipulimit të opinionit publik ose minimimit të besimit të institucioneve. Ato mund të marrin shumë forma, duke përfshirë edhe të pavërteta, manipulime mediatike, teoritë e konspiracionit dhe

propaganda, dhe gjithashtu mund të përhapet përmes kanaleve të ndryshme, të tilla si media sociale, lajme tradicionale dhe aplikacione digjitale (Kapantai et al 2021). Në mjedisin modern të informacionit dhe falë metodave, teknikave dhe teknologjive të reja të prodhimit dhe shpërndarjes së informacionit, sasia dhe shpejtësia e tij arrijnë përmasa të papara pa asnjë kufizim. E gjithë bota po përballet seriozisht me këtë fenomen, dhe Maqedonia nuk është shumë prapa, nëse bëhet fjalë për (dez)informacion në sferën e politikës, ekonomisë, kulturës, shëndetësisë, mjedisit jetësor etj. (Bayet et al, 2019).

## 1.2.2 Rreth transparencës

Evoluimi i përdorimit dhe kuptimit të fjalës “transparencë” është i lidhur ngushtë me organizatat mbi-kombëtare dhe joqeveritare (Ball, 2009). Ajo shfaqet për herë të parë në fillim të viteve nëntëdhjetë në dokumentet që lidhen me themelimin e Bashkimit Evropian, Marrëveshja e Përgjithshme mbi detyrimet doganore dhe tregtisë si dhe në dokumente të tjera që burojnë nga institucionet evropiane dhe organizatat ndërkombëtare joqeveritare (Cooper & Yodder, 2012). Por ajo që ndihmoi në vendosjen e fjalës në publikun e gjerë dhe botën akademike ishte zgjedhja e emrit “Transparency International” për organizatën joqeveritare të themeluar në vitin 1993, për shkak të lidhjes së fjalës transparencë me idenë e hapjes (Ball, 2009).

Në vitet që pasuan, përdorimi është përhapur përmes dokumenteve të organizatave ndërkombëtare, të cilat përfshijnë rekomandime për politikat publike për të garantuar transparencë, politika të besueshme për shmangien e konfliktit të interesit, përgatitje të hapur dhe zbatim të buxhetit dhe, lirinë e informimit, pjesëmarrjen e qytetarëve në formulimin dhe zbatimin e politikave publike, si dhe përgjegjësinë e ndërmarrjeve që janë në pronësi publike ose shtetërore. Transparency International publikon çdo vit një indeks që mat perceptimet për korrupsionin dhe e zhvillon gjithashtu të ashtuquajturin Sistemi i Integritetit Kombëtar, i cili përfaqëson vegzë vlerësimi, i të gjithë aktorëve kryesorë në luftën kundër korrupsionit dhe i referohet integritetit, transparencës dhe llogaridhënies së tyre (TI 1995, 2000). Vlerësimi gjithëpërfshirës i “sistemit të integritetit” të vendit synon të zbulojë pikat e forta dhe të dobëta, si dhe të identifikojë rekomandimet për krijimin e politikave (TI 2006). Sistemet e integritetit, përveç strukturave zyrtare transparente dhe të hapura, përfshijnë edhe kritere si media të lira, një sektor privat i ndershëm dhe i pa korruptueshëm dhe një shoqëri civile që përdor informacion dhe pret që bizneset dhe qeveria të veprojnë hapur dhe me ndershmëri. Një rol të rëndësishëm në evolucionin e termit “transparencë” ka marrëdhënia e tij me korrupsionin. Transparenca konsiderohet si një nga parakushtet e rëndësishme në luftën kundër korrupsionit, sepse transparenca dhe korrupsioni janë të ndërlidhura, që do të thotë se më shumë transparencë çon në më pak korrupsion, ndërsa më pak transparencë çon në më shumë korrupsion. Korrupsioni lulëzon në mjedise ku ka pak transparencë, sepse ata që janë në pushtet mund të veprojnë pa u ndëshkuar dhe të shmangin llogaridhënien. Kështu, kur ka më shumë transparencë në sistem, bëhet më e vështirë që të ndodhë korrupsioni, pasi veprimet e pushtetarëve janë më të dukshme dhe objekt shqyrtimi. Në mënyrë të ngjashme, kur ka më pak transparencë, korrupsioni mund të zërë rrënjë dhe të përhapet më lehtë, sepse ata që janë në pushtet janë të mbrojtur nga sytë e publikut dhe mund të veprojnë pa u ndëshkuar. Shkurtimisht, transparenca mund të veprojë si një parandalues i fuqishëm ndaj korrupsionit, ndërsa korrupsioni mund të dëmtojë transparencën dhe llogaridhënien në sistem.

Përkufizimet e përgjithshme të transparencës lindin nga ky raport ndërmjet korrupsionit dhe transparencës. Në këtë drejtim transparenca përkufizohet si “heqje e vellos së fshehtësisë” (Davis, 1998) ose “liria për të parë qartë nëpër dritaret e institucionit” (den Boer, 1998). Ideja e përgjithshme është që diçka po ndodh pas perdeve dhe pasi të hiqen këto perde, gjithçka është e hapur dhe mund të shqyrtohet. Sipas Birkinshaw, transparenca nënkupton sjelljen e çështjeve publike në mënyrë të hapur ose në një mënyrë që i nënshtrohet kontrollit publik (Birkinshaw, 2006). Black e përcakton transparencën në bazë të asaj që nuk është: “transparenca është në kontrast me masat e fshehta politike, ku është e vështirë të zbulosh

se kush i merr vendimet, çfarë janë ato, dhe kush fiton dhe kush humbet nga zbatimi i tyre.” (Black, 1997). Për Ball-in, “transparenca” është një metaforë ose simbol për një mori idesh që tregojnë ekzistencën e korrupsionit si problem. Dhe pastaj ata ofrojnë një zgjidhje – ofrimin e informacionit për publikun përmes vendimmarrjes së hapur. Në këtë drejtim, transparenta mund të shihet si një sinonim për zyrtarët publikë të ndershëm dhe të përgjegjshëm dhe për vendimet publike (Ball, 2009). Prandaj, megjithëse nuk ka një përkufizim të përgjithshëm të transparencës së institucioneve, ekziston një konsensus i përgjithshëm se i referohet *të drejtës së qytetarëve për t’u informuar dhe për të pasur qasje në informacionin që është i nevojshëm për marrjen e vendimeve* (Etzioni, 2016).

Në të njëjtën kohë, transparenta institucionale i referohet masës në të cilën punët e brendshme të institucioneve, siç është qeveria dhe institucionet e tjera shtetërore, sa janë të hapura dhe të lehta për qasje për publikun. Ajo nënkupton zbulimin e informacionit që disponon qeveria (shteti) në dobi të qytetarëve dhe shpërndarja e atij informacioni, në mënyrë që të mundësohet qasja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse (Wanna dhe Vincent, 2018). Kjo mund të përfshijë publikimin e informacionit për aktivitetet dhe vendimet e këtyre institucioneve, si dhe politikat dhe procedurat që ato ndjekin. Informacioni është një parakusht shumë i rëndësishëm në ushtrimin e pushtetit politik dhe ekonomik. Prandaj, sot është kuptuar se transparenta institucionale mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit ndërmjet institucioneve dhe publikut, si dhe në promovimin e llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë. Kur institucionet janë transparente, bëhet më e lehtë për publikun që t’i mbajë ata përgjegjës për veprimet e tyre dhe të sigurojë që ato të veprojnë brenda interesit të tyre më të mirë.

Në një kuptim më të gjerë, transparenta si e drejtë për informacion i referohet:

- *Qasjes së qytetarëve në informacion (të brendshëm) të qeverisë,*
- *Vëllimit, saktësisë dhe afatit kohor të informacionit në të cilin qytetarët kanë qasje,*
- *Mekanizmave që kanë në dispozicion qytetarët, nëse nuk u lejohet qasja në informacionin e brendshëm (të insajderëve) të qeverisë ose nuk është i kënaqshëm vëllimi, saktësia dhe afati kohor i qasjes në informacion.*

Si rezultat i vendosjes së konceptit në nivel ndërkombëtar, roli i transparencës tani konsiderohet vendimtar për procese demokratike kuptimplota dhe efektive. Nga ana tjetër, fshehtësia e tepruar ka një efekt gërryes në të gjitha aspektet sociale, sepse cenon cilësinë e vendimmarrjes publike dhe parandalon përfshirjen e qytetarëve në kontrollin e abuzimeve me pushtetin publik (Florini, 2007).

## 1.3 Marrëdhënia midis dezinformimit dhe transparencës

Dezinformimi dhe transparenta konsiderohen si të ndërlidhura në mënyrë të kundërt pra terma dhe dukuri shoqërore të kundërta. Dezinformimi i referohet krijimit dhe shpërndarjes së qëllimshme të informacionit të rremë ose mashtrues, ndërsa transparenta është një gjendje e çiltërsisë dhe ndershmërisë. Transparenta ndihmon në ndërtimin e besimit dhe parandalimin e përhapjes së dezinformatave. Nga ana tjetër, dezinformimi mund të minojë besimin duke përhapur informacione të rreme, pjesërisht të rreme ose të gabuara. Prandaj, transparenta mund të shihet si kundërpeshja e tyre pasi mund të ndihmojë në parandalimin e informacionit të rremë dhe promovimin e përhapjes së informacionit të saktë (Lazer et al, 2018). Kjo është veçanërisht e rëndësishme në epokën digjitale, kur dezinformata përhapet shpejt dhe shkakton dëme të konsiderueshme, minon besimin tek institucionet me pasoja potencialisht të rënda. Në disa raste, dezinformata mund të përhapet nga vetë institucionet në përpjekje për të manipuluar opinio-

nin publik ose për të fshehur të vërtetën. Mungesa e transparencës së institucioneve qeveritare nënkupton mungesë ose shkurtrim të së drejtës së qytetarëve për qasje në informacion. Kjo nënkupton eliminimin ose marginalizimin e qytetarëve nga proceset vendimmarrëse dhe politikëbërëse (Abramowicz dhe Ho, 2020). Pra, mungesa e transparencës nënkupton kufizim apo deficit të proceseve demokratike dhe në të njëjtën kohë hap hapësirë për përhapjen e dezinformatave dhe spekulimeve, kështu duke dëmtuar funksionimin e mediave.

Mungesa e transparencës së institucioneve rrit rrezikun e dezinformimit dhe kjo mund të shkaktojë shkelje të të drejtave të njeriut nga aspekte të ndryshme, sepse nuk i lejon qytetarët të ndjekin vendimmarrjen në qeveri në mënyrë të informuar. Mungesa e transparencës institucionale mund të çojë në përhapjen e dezinformatave në mënyra të ndryshme. Së pari, kur institucionet nuk janë transparente për veprimet dhe vendimet e tyre, krijohet një mjedis ku dezinformimi mund të lulëzojë, pasi njerëzit bëhen të pranueshëm ndaj besimit të informacionit të rremë ose mashtrues kur nuk kanë qasje në fakte. Së dyti, mungesa e transparencës mund ta bëjë më të lehtë edhe për ata që tentojnë të përhapin dezinformata. Pa transparencë, është e vështirë të kërkojë llogari nga institucionet dhe individët për informacionin që ndajnë. Së fundi, mungesa e transparencës mund ta bëjë të vështirë për njerëzit të bëjnë dallimin midis burimeve të besueshme dhe jo të besueshme të informacionit. Kur institucionet nuk janë transparente, mund të jetë e vështirë për njerëzit që të dinë se kujt t'i besojnë, duke i bërë ata më të prirë të besojnë në dezinformatat që përputhen me bindjet ose paragjykimet e tyre.

Prandaj, rritja e transparencës institucionale është hapi logjik që mund të ndërmerret për të parandaluar ose zvogëluar ndikimin e dezinformimit. Nga ana tjetër, marrja e masave të rrepta nga qeveria për parandalimin e dezinformimit krijon rrezik për shkeljen e të drejtës për lirinë e fjalës, lirinë e medias dhe lirinë editoriale (Hoboken dhe Ronan, 2021). Dhe transparenca institucionale përfaqëson komponentë të rëndësishme të qeverisjes së mirë dhe mund të ndihmojë në promovimin e besimit dhe përgjegjësisë, në balancimin e përpjekjeve për të kundërshtuar dezinformimin, duke ofruar një qasje që siguron qasje në informacion të saktë dhe të besueshëm, ndërsa media dhe publiku ruajnë lirinë e tyre të fjalës.

## 1.4 Metodatat dhe rreziqet në ballafaqimin e dezinformatave

Metodat dhe qasjet për t'u marrë me dezinformimin duhet të fillojnë me një ndërgjegjësim për rreziqet që lidhen me rregullimin e kësaj sfere (Hoboken & Ronan, 2021). Ka disa rreziqe kryesore që lidhen me përpjekjet për të rregulluar dezinformatat. Një nga rreziqet kryesore është potenciali për censurë dhe kufizim i lirisë së fjalës. Qeveritë dhe kompanitë private mund të përdorin rregullativën si një mënyrë për të heshtur ata me të cilët nuk janë dakord ose për të shtypur disa lloje informacioni. Përveç kësaj, dezinformatat janë një fenomen kompleks dhe i shumë-anshëm të cilat vështirë mund të përcaktohen dhe identifikohen. Kjo e ndërlikon procesin e zhvillimit të rregulloreve që synojnë në mënyrë efektive dezinformatat pa kufizuar lirinë e fjalës. Edhe nëse zhvillohen, ato mund të jenë të vështira për t'u zbatuar, veçanërisht në kontekstin e peizazhit digjital të gjerë dhe në rritje. Nga ana tjetër, rregullimi i tepruar i dezinformatave mund të çojë në pasoja të padëshiruara dhe të mbytur lirinë e fjalës dhe të shprehjes. Vështirësi të tjera lindin nga fakti se disa forma të dezinformatave janë të vështira për t'u dalluar nga satira ose parodia, gjë që mund të çojë në censurimin e formave legjitime të shprehjes.

Duke pasur parasysh këto rreziqe, ekzistojnë një sërë qasjesh të ndryshme për trajtimin e dezinformatave, ndërsa qasja më e mirë varet nga konteksti dhe qëllimet specifike të ndërhyrjes. Sipas Wardle dhe Hossein (2017) disa nga qasjet më të mira për përballim të dezinformatave përfshijnë:

- *Rritja e edukimit mediatic*: Një nga mënyrat më efektive për përballim me dezinformatat është rritja e

edukimit mediatic në mënyrë që njerëzit të jenë më të pajisur për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionet që hasin dhe të njohin dezinformata kur do të hasin në to

- *Rritja e transparencës:* Rritja e transparencës, për shembull duke e bërë të qartë se kush qëndron prapa informacionit të caktuar ose kush e financon përhapjen e atij informacioni, mund të ndihmojë në uljen e përhapjes së dezinformatave
- *Bashkëpunimi:* Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë qeveritë, kompanitë e teknologjisë, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, është thelbësor për të trajtuar në mënyrë efektive dezinformatat
- *Inkurajimi i vetë-rregullimit:* vetë-rregullimi ndërmjet platformave online mund të ndihmojë në reduktimin e përhapjes së dezinformatave duke e bërë më të vështirë për aktorët e këqij përdorimin e këtyre platformave për të përhapur informacione të rreme
- *Investimi në hulumtime:* Investimi në hulumtime për të kuptuar më mirë natyrën e dezinformatave dhe mënyrën se si ato përhapet mund të ndihmojë në zhvillimin e kundërmasave më efektive
- *Reduktimi i përfitimeve ekonomike nga përhapja e dezinformatave:* Një tjetër qasje e rëndësishme është zvogëlimi i përfitimeve ekonomike nga përhapja e dezinformatave me atë që do të vështirësohet puna atyre që përfitojnë nga përhapja e informatave të rrejshme.

# Rregullativa evropiane për dezinformatat dhe transparencën

## 02

**Q**asja e Bashkimit Evropian për përballje me dezinformatat është veçanërisht e rëndësishme për Republikën e Maqedonisë së Veriut si vend kandidat për anëtarësim në BE. Dezinformatat janë një sfidë globale dhe BE-ja përballet me çështje dhe sfida të ngjashme, por ka mekanizma institucionalë shumë më të avancuar për përballim me këto procese. Një rol të rëndësishëm luan një strategji gjithëpërfshirëse për përballim me dezinformata, e cila përfshin miratimin dhe zbatimin e rregullores së re që synon kryesisht transparencën më të madhe të platformave të mëdha dhe mënyrën se si moderohen përmbajtje dhe algoritma, investim në kontrollin e fakteve, edukimi mediatic dhe mbështetjen e mediave të pavarura.<sup>1</sup> Qasja në këto burime, si dhe ekspertiza e institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare në luftën kundër dezinformatave, mund të ofrojnë zgjidhje që janë gjithashtu të rëndësishme për kontekstin maqedonas, veçanërisht pasi qasja e BE-së për përballjen me dezinformatat bazohet në vlerat e përbashkëta demokratike, si liria e shprehjes, pluralizmi mediatic dhe mbrojtja e të drejtave themelore. Gjithashtu, respektimi i këtyre vlerave është i rëndësishëm për vendet candidate për anëtarësim në BE, pasi ato janë pjesë e kriterëve demokratike të anëtarësimit që duhet të plotësohen.

## 2.1 Qasja gjithëpërfshirëse evropiane e BE-së në luftën kundër dezinformatave

Në vitet e fundit, përhapja e dezinformatave në platformat online është bërë shkak për shqetësim në shumë vende të botës, veçanërisht për shkak të ndikimit të praktikave të tilla në qytetarinë e informuar dhe sistemet demokratike në tërësi (Nenadić, 2019). Në vitin 2018, Komisioni Evropian (KE) njohu ekspozimin e lartë të qytetarëve të tij ndaj dezinformatave në internet si një sfidë madhore për demokracitë evropiane (KE, 2018a & KE, 2018b). Në përgjigje të këtyre sfidave, për të siguruar qasjen e qytetarëve në

<sup>1</sup> EC (2018). Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, “Tackling online disinformation: a European Approach”, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52018DC0236>, qasur më 15.02.2023



informacione dhe burime të besueshme, KE-ja vendosi disa masa që synojnë krijimin e të ashtuquajturës “qasje evropiane” gjithëpërfshirëse (Ibid). “Qasja evropiane” për përballje me sfidat e dezinformatave në përgjithësi i referohet veprimeve dhe strategjive të ndërmarra nga Bashkimi Evropian (BE) dhe shtetet e tij anëtare për zgjidhjen e çështjeve me dezinformatat. Kjo qasje buron nga rregullimi, vetë-rregullimi i platformave digjitale të iniciuara nga KE-ja (Kodi i BE-së kundër dezinformatave), si dhe komunikimet dhe rekomandimet jodetyruese nga Komisioni për shtetet anëtare.

Në dokumentet dhe politikat e BE-së, dezinformatat përkufizohet si shpërndarja e përmbajtjeve të rreme ose të pasakta me qëllim të përfitimit ekonomik ose politik, ndërsa në të njëjtën kohë mund të shkaktojë dëme në jetën publike, të shkaktojë kërcënim për demokracinë, sigurinë dhe shëndetin e qytetarët.<sup>2</sup> Dezinformatat trajtohet si një sfidë madhore, e cila kërkon një përgjigje të koordinuar nga institucionet, platformat online, mediat dhe qytetarët.

Si akte kryesore në BE për parandalimin e dezinformatave, veçohen disa (me tiparet e tyre kryesore të përshkruara në tabelën numër 1). Detajet e çdo akti individual shpjegohen më në detaje në Aneksin 1.

| <b>Komunikatë e Komisionit Evropian për përballim me dezinformata - 2018.<sup>3</sup></b> |   |
|---|---|
| <b>Përshkrim</b>  | Dokumenti paraqet një koleksion mjetesh për parandalimin efektiv të përhapjes së dezinformatave dhe mbrojtjen e vlerave të BE-së  |
| <b>Masat – synimet</b>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Forcimi i Kodit Vetërregullues të BE-së kundër dezinformatave, i cili përcakton një sërë detyrimesh për platformat online dhe palët e tjera të interesuara për luftë kundër dezinformatave</li> <li>• Rritja e transparencës së reklamave politike në internet</li> <li>• Forcimi i edukimit mediatik dhe inkurajimi i diskursit publik të bazuar në fakte</li> <li>• Mbështetje për media cilësore të pavarura</li> <li>• Përballja me stimujt financiarë për dezinformata, duke përfshirë promovimin e transparencës së reklamave dhe zhvillimin e mjeteve të reja për të zbuluar dhe hequr llogaritë dhe botët e rreme</li> </ul> |
| <b>Plani i veprimit kundër dezinformatave– 2018<sup>4</sup></b>                           |   |
| <b>Përshkrim</b>  | Një grup masash gjithëpërfshirëse të miratuara nga Komisioni Evropian për forcimin e aftësisë së BE-së për të parandaluar, zbuluar dhe reaguar ndaj dezinformatave  |

2 Commission of the European Union (2018), COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE COUNCIL, THE EUROPEAN ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS Tackling online disinformation: a European Approach, COM/2018/236 final (qasur më: 20.11.2022) <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52018DC0236&from=EN>

3 EC (2018). Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, “Tackling online disinformation: a European Approach”, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52018DC0236>, qasur më 15.02.2023

4 EC (2018). Joint Communication to the European Parliament, the European Council, The Council, The European Economic and Social Committee and the Committee of the regions, “Action Plan against Disinformation”, [https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/action\\_plan\\_against\\_disinformation.pdf](https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/action_plan_against_disinformation.pdf), qasur më 15.02.2023

|  |  |
|--|--|
| Masat – synimet  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i aftësisë së institucioneve të BE-së për të zbuluar, analizuar dhe ekspozuar dezinformata, duke krijuar një njësi të dedikuar për monitorim dhe analizë të tendencave të dezinformatave dhe për mbështetje të vendeve anëtare në identifikimin dhe reagimin ndaj fushatave për dezinformata.</li> <li>• Forcimi i koordinimit dhe veprimit të përbashkët kundër dezinformatave</li> <li>• Inkurajimi i platformave online që të veprojnë me përgjegjësi, duke bërë thirrje për përgjegjësi më të madhe për përmbajtjen që publikojnë dhe marrjen e masave për të luftuar përhapjen e dezinformatave, duke përfshirë promovimin e transparencës në reklamimin politik</li> <li>• Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë shoqërore.</li> <li>• Mbështetja e gazetarisë së pavarur dhe cilësore për shkak të rëndësisë së saj në përballjen me dezinformatat</li> </ul> |
| <b>Plani Evropian i Veprimit për Demokraci – 2020<sup>5</sup></b>                      |  |
| Përshkrim  | Plani i veprimit fokusohet në tri fusha: mbrojtja e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme; forcimi i lirisë së medias dhe pluralizmit të medias; si dhe parandalimin e dezinformatave.  |
| Masat – synimet  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbrojtja e sigurisë së gazetarëve.<sup>6</sup></li> <li>• Lufta kundër keqpërdorimit të mundësisë për iniciimin e procedurës gjyqësore ndaj gazetarëve dhe personave të përfshirë në mbrojtjen e interesit publik<sup>7</sup></li> <li>• Vendosja dhe zbatimi i standardeve profesionale gazetareske dhe mediatike duke promovuar vetë-rregullimin dhe fuqizimin e organeve të vetë-rregullimit mediatik.</li> <li>• Forcimi i pluralizmit mediatik dhe transparencës së pronësisë mediatike</li> <li>• Rritja e transparencës në online reklamimin politik</li> <li>• Promovimi i edukimit mediatik dhe aftësive të të menduarit kritik, mbështetje të gazetarisë së pavarur dhe përmirësim të kontrollit dhe verifikimin e fakteve.</li> </ul>  |
| <b>Forcimi i kodit të praktikave kundër dezinformatave – 2018 dhe 2022<sup>8</sup></b> |  |
| Përshkrim  | Masat vetërregulluese vullnetare të miratuara nga Komisioni Evropian dhe online platformat kryesore për luftë kundër dezinformatave.   |

5 EC (2020). Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, “On the European democracy action plan” <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=COM%3A2020%3A790%3AFIN&qid=1607079662423>

6 Commission of the European Union (2021) COMMISSION RECOMMENDATION of 16.9.2021 on ensuring the protection, safety and empowerment of journalists and other media professionals in the European Union, Brussels, C(2021) 6650 (qasur më: 26.11.2022) <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/recommendation-protection-safety-and-empowerment-journalists>

7 Commission of the European Union (2022) Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on protecting persons who engage in public participation from manifestly unfounded or abusive court proceedings (“Strategic lawsuits against public participation”), Brussels, 27.4.2022 COM(2022) 177 final, 2022/0117 (COD) (qasur më: 26.11.2022) <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0177&from=EN>

8 Shiko: The Strengthened Code of Practice on Disinformation 2022 <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/2022-strengthened-code-practice-disinformation>

|  |  |
|--|--|
| Masat –<br>synimet   | <p>Nënshkruesit e Kodit marrin përsipër që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të ndërmarrin hapa për të përmirësuar transparencën e online lajmeve, reklamimin politik dhe përmbajtjen e krijuar nga përdoruesit, duke përfshirë zbulimin e informacioneve në lidhje me identitetin e reklamuesve dhe burimet e lajmeve</li> <li>- të ndërmarrin hapa për të përmirësuar mjedisin e informacionit për përdoruesit, duke përfshirë ofrimin e veglave dhe informacioneve për përdoruesit që do t'i ndihmojnë ata të identifikojnë dhe vlerësojnë informacionet në internet.</li> <li>- të punojnë me kontrollues faktesh dhe studiues akademikë për të ndihmuar në identifikimin dhe përballjen me dezinformatat në internet.</li> <li>- të ndërmarrin masa kundër aktorëve keqdashës që përdorin platforma online për të përhapur dezinformata ose për t'u përfshirë në forma të tjera të manipulimit online.</li> <li>- të ndërmarrin hapa për përmirësim të përgjegjshmërisë së platformave online, duke përfshirë zhvillimin e kushteve më të qarta të përdorimit dhe udhëzimeve të komunitetit dhe duke u ofruar përdoruesve mekanizma të qartë dhe efektive për raportimin e përmbajtjeve fyese.</li> </ul> |
| <b>Akt për Shërbime Digjitale – 2020<sup>9</sup></b>         |  |
| Përshkrim  | Akti synon të mbrojë përdoruesit e internetit duke vendosur një standard të ri për funksionimin transparent të platformave online.   |
| Masat –<br>synimet   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyrime të reja për platformat online të mëdha, duke përfshirë kërkesat për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme, për të siguruar transparencë më të madhe në praktikën për moderim të përmbajtjes dhe për të zbatuar masa efektive për përballim me dezinformata.</li> <li>• Rregulla të reja për online reklamim, duke përfshirë kërkesat për transparencë për përdorimin e teknikave për targetim dhe profilizim të përdoruesve.</li> <li>• Masa të reja mbrojtëse për të drejtat e përdoruesve duke kërkuar që platformat të kenë politika të qarta dhe efektive për moderimin e përmbajtjes, sigurim të mjeteve juridike efektive për përdoruesit në rast të heqjes gabimisht të përmbajtjes dhe të respektojnë të drejtat themelore si liria e shprehjes dhe privatësia.</li> <li>• Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare për të siguruar një përgjigje të koordinuar ndaj përmbajtjeve të paligjshme dhe dezinformatave në internet.</li> </ul>   |
| <b>Akti Evropian për Lirinë e Medias – 2022<sup>10</sup></b> |  |
| Përshkrim  | Një grup rregulla të reja për mbrojtjen e pluralizmit dhe pavarësinë e medias në BE. Dokumenti është në fazën e një propozim- ligjit të dorëzuar në shtator 2022, nga Komisioni Evropian.  |

<sup>9</sup> Shiko: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020PC0825&from=en>

<sup>10</sup> Commission of the European Union (2022) European Media Freedom Act (DRAFT, presentation) [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_22\\_5504](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_5504)

|   |  |
|---|--|
| Masat synimet –   | Masat mbrojtëse ndaj politikave për presion mbi liritë editoriale, forcimin e mbrojtjes së gazetarëve dhe profesionit të gazetarit, sigurimin e financimit të pavarur/të qëndrueshëm të shërbimit publik radiodifuziv, transparencën në shpërndarjen e reklamimit shtetëror, si dhe pronësinë e medias.  |
| <b>Media Evropiane dhe Plani i Veprimit Audiovizual – 2021<sup>11</sup></b> |  |
| Përshkrim   | Paketë masash të miratuara nga Komisioni Evropian për të mbështetur rimëkëmbjen dhe transformimin e sektorit mediatik dhe audioviziv evropian, duke përfshirë masat për luftë kundër dezinformatave.   |
| Masat synimet –   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetje e lirisë së mediave dhe pluralizmit</li> <li>• Promovimi i gazetarisë cilësore dhe edukimit mediatik</li> <li>• Forcimi i konkurrencës së veprave audiovizive evropiane</li> <li>• Sigurimi i kushteve të barabarta për të gjithë lojtarët në tregun e vetëm digjital</li> <li>• Forcimi i transparencës në sektorin mediatik dhe audioviziv</li> <li>• Mbështetja e zhvillimit të teknologjive të reja dhe modeleve afariste</li> </ul> |
| <b>Observatori Evropian i Mediave Digjitale – 2021<sup>12</sup></b>         |  |
| Përshkrim   | Observatori Evropian është një platformë e krijuar nga Komisioni Evropian për të monitoruar dhe analizuar online mjedisin dhe të identifikojë tendencat, rreziqet dhe mundësitë që lidhen me shërbimet digjitale.  |
| Masat synimet –   | Koordinimi, lidhja dhe ofrimi i ndihmës në krijimin e politikave për parandalimin e dezinformatave   |

Në qasjen e BE-së, për parandalimin e përhapjes së dezinformatave, bëhet një dallim i qartë ndërmjet medias, veçanërisht shërbimit publik, dhe mediave sociale si burim ose transmetues i mundshëm i dezinformatave. Një nga specifikat më të rëndësishme të politikave të BE-së është fakti që media trajtohet si subjekt-partner për parandalimin e përhapjes së dezinformatave. Për këto arsye, qasja evropiane për parandalimin e dezinformatave shoqërohet me masa dhe politika për forcimin e demokracisë, të cilat përfshijnë mbrojtjen e profesionit të gazetarit. Këto masa janë të një rëndësie të veçantë dhe ofrojnë udhëzime për strategjitë dhe politikat kombëtare për të parandaluar dezinformatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këto korniza, vëmendje duhet t'i kushtohet masave evropiane për të mbrojtur gazetarët, dhe veçanërisht gazetaret femra, nga kërcënimet online. Është i nevojshëm harmonizimi i legjisllacionit kombëtar në lidhje me median me rregulloren evropiane (Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizive, Akti për Shërbimet Digjitale, propozimi Akti për Lirinë e Mediave në Evropë, etj.) dhe me standardet e tjera evropiane, aktet vetërregulluese dhe bashkë-rregulluese, si dhe me rekomandimet e Këshillit të Evropës. Gjithashtu, Direktiva e BE-së për parandalimin e mundësisë së inicimit dhe abuzimit të procedurave ligjore kundër gazetarëve duhet të integrohet plotësisht në strategjitë dhe politikat kombëtare.<sup>13</sup> Ky

11 European Media and Audiovisual Action Plan, <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/media-and-audiovisual-action-plan>

12 European Digital Media Observatory (EDMO), <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/european-digital-media-observatory#:~:text=The%20European%20Digital%20Media%20Observatory,to%20collaborate%20with%20each%20other.,> qasur më 10.02.2023

13 Commission of the European Union (2022) Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on protecting persons who engage in public participation from manifestly unfounded or abusive court proceedings (“Strategic lawsuits against public participation”), Brussels, 27.4.2022 COM(2022) 177 final, 2022/0117 (COD) (пристапено на: 26.11.2022) <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0177&from=EN>

keqpërdorim quhet Padi Strategjike kundër pjesëmarrjes publike.<sup>14</sup> Direktiva i trajton paditë strategjike si një formë të veçantë ngacmimi, e cila mbështetet në procese ligjore të pabaza ose të tepruara, të incuara zakonisht nga autoritetet shtetërore, kompani të fuqishme ose individë të fuqishëm.<sup>15</sup>

## 2.2 Transparenca si një imperativ i qasjes evropiane

Çështja e transparencës së institucioneve të BE-së merr peshë kushtetuese me Traktatin e Lisbonës<sup>16</sup>, parimet e të cilit përcaktohen nga Rregullorja e Punës e Këshillit dhe e Këshillit Evropian.<sup>17</sup> Në këtë kontekst, Direktiva për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacioneve nga sektori publik është gjithashtu relevante<sup>19</sup>, i cili synon t'i bëjë të ri përdorshme të dhënat e sektorit publik dhe të financuara nga publiku. Direktiva bazohet në dy parime kryesore të tregut evropian: transparencën dhe konkurrencën e ndershme. Direktiva parashikon gjithashtu forcimin e transparencës së marrëveshjeve të partneritetit publik-privat, duke përfshirë informacionin nga sektori publik dhe shmangien e marrëveshjeve ekskluzive.

Transparenca luan një rol kyç në qasjen evropiane për trajtimin e dezinformatave dhe konsiderohet si mjet kryesor për zgjidhjen e problemit me dezinformatat, pasi u mundëson përdoruesve të identifikojnë burimet e informacionit dhe të marrin vendime të informuara në lidhje me besueshmërinë e informacioneve që ata hasin në internet. Në përgjithësi, transparenca konsiderohet si një element kryesor në qasjen evropiane për tu përballur me dezinformatat, pasi ndihmon në krijimin e një mjedisi informacionesh më të hapura, të përgjegjshëm dhe më të besueshëm dhe mbështet përpjekjet e politikëbërësve, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile për të adresuar sfidat e paraqitura nga dezinformatat.

Në dokumentet dhe politikat e BE-së, dezinformatat përkufizohet si shpërndarja e përmbajtjeve të rreme ose të pasakta me qëllim të përfitimit ekonomik ose politik, ndërsa në të njëjtën kohë mund të shkaktojë dëme në jetën publike, të shkaktojë kërcënim për demokracinë, sigurinë dhe shëndetin e qytetarët.<sup>20</sup> Dezinformatat trajtohet si një sfidë madhore, e cila kërkon një përgjigje të koordinuar nga institucionet, platformat online, mediat dhe qytetarët. Qëllimet kryesore të të ashtuquajturës qasje evropiane për përballje me dezinformatat janë:

- 
- 14 Strategic lawsuits against public participation – SLAPPs, qasur më: 26.11.2022, [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS\\_BRI\(2022\)733668#:~:text=One%20of%20these%20techniques%20is,relation%20to%20matters%20of%20public](https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI(2022)733668#:~:text=One%20of%20these%20techniques%20is,relation%20to%20matters%20of%20public)
  - 15 Commission of the European Union (2022) Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on protecting persons who engage in public participation from manifestly unfounded or abusive court proceedings (“Strategic lawsuits against public participation”), Brussels, 27.4.2022 COM(2022) 177 final, 2022/0117 (COD) (qasur më: 26.11.2022) <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0177&from=EN>
  - 16 Treaty of Lisbon amending the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community, signed at Lisbon, 13 December 2007, OJ C 306, 17.12.2007, p. 1–271 [http://publications.europa.eu/resource/cellar/688a7a98-3110-4ffe-a6b3-8972d8445325.0007.01/DOC\\_19](http://publications.europa.eu/resource/cellar/688a7a98-3110-4ffe-a6b3-8972d8445325.0007.01/DOC_19)
  - 17 Council of the European Union, Council Decision of 1 December 2009 adopting the Council’s Rules of Procedure OJ L 325, 11.12.2009, p. 35–35 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009D0937&from=EN>
  - 18 Këtu janë përcaktuar rregullat bazë për mbledhjet, duke përfshirë rregullat e votimit, cilat seanca duhet të jenë publike dhe kur duhet të publikohen dokumentet: procesverbalet, votimi i projektligjeve, shpjegimet e votave dhe deklaratat e bëra nga vendet anëtare, informacione për dokumentet që janë objekt diskutimi dhe konkluzionet kryesore të arritura nga Këshilli.
  - 19 European Parliament and the Council of the European Union (2019) Directive (EU) 2019/1024 of the European Parliament and of the Council of 20 June 2019 on open data and the re-use of public sector information (recast), PE/28/2019/REV/1 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019L1024&from=EN>
  - 20 EC (2018). Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, “Tackling online disinformation: a European Approach”, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52018DC0236>, qasur më 15.02.2023

- Të forcohet qëndrueshmëria e shoqërive demokratike kundër dezinformatave
- Të mbështeten mediat e lira dhe të pavarura dhe gazetaria cilësore
- Të promovohet transparenca dhe llogaridhënia në platformat online dhe reklammat
- Të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet vendeve anëtare të BE-së dhe partnerëve ndërkombëtarë
- Të fuqizohen qytetarët duke përmirësuar edukimin mediatic dhe aftësitë e të menduarit kritik.

Në përgjithësi, qasja aktuale mund të shihet si e projektuar kryesisht për (1) parandalimin e mikroshënjestrim të paligjshëm të votuesve duke mbrojtur të dhënat personale;<sup>21</sup> dhe (2) lufta kundër dezinformatave duke rritur transparencën e platformave online.<sup>22</sup> Një aspekt tjetër i rëndësishëm i qasjes evropiane është theksi mbi bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm, me përfshirjen e qeverive, kompanive teknologjike, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.

21 Masat e transparencës në qasjen evropiane përfshijnë kërkesat për platformat online për të zbuluar informacionin rreth burimeve të reklamave politike dhe përmbajtjes së lajmeve, si dhe masa për të përmirësuar transparencën e algoritmeve dhe praktikave për mbledhjen e të dhënave.

22 Disa nga dokumentet e përmendura të BE-së në lidhje me dezinformimin e trajtojnë gjithashtu çështjen e transparencës si: Transparenca e reklamave politike e mbuluar nga Plani i Veprimit Kundër Dezinformatave- Action Plan against Disinformation Shiko: [https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/action\\_plan\\_against\\_disinformation.pdf](https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/action_plan_against_disinformation.pdf), si dhe me Kodin e Forcuar të Sjelljes kundër dezinformimit nga 2022 (The Strengthened Code of Practice on Disinformation 2022 - Види: 2022 Strengthened Code of Practice on Disinformation | Shaping Europe's digital future, Shpërndarja transparente dhe e drejtë e reklamave shtetërore apo politike, e mbuluar nga Plani i Veprimit kundër dezinformimit - Shiko: [https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/action\\_plan\\_against\\_disinformation.pdf](https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/action_plan_against_disinformation.pdf), Transparenca e pronësisë së medias, e mbuluar nga Plani i Veprimit kundër dezinformimit - Shiko: [https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/action\\_plan\\_against\\_disinformation.pdf](https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/action_plan_against_disinformation.pdf) dhe Funksionimi transparent i platformave online nga Ligji për Shërbime Digjitale - Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?qid=1608117147218&uri=COM%3A2020%3A825%3AFIN>

# Transparenca institucionale dhe dezinformatat në kontekstin maqedonas

## 03

**B**ashkimi Evropian ka zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse për të luftuar dezinformatat, duke përfshirë promovimin e transparencës, edukimin mediatic dhe verifikimin e pavarur të fakteve. Për krahasim, qasja maqedonase për përballje me dezinformatat është ende në fillimet e saj, ndërsa vendi është në proces të zhvillimit të masave efektive për përballim të këtij problemi.

Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022<sup>23</sup>, nënvizon disa fusha në të cilat është e nevojshme të përmirësohet transparenca institucionale. Raporti tregon se organizatat e shoqërisë civile duhet të përfshihen për të përmirësuar transparencën në politikë-bërje dhe gjithë-përfshirjen në proceset konsultative.<sup>24</sup> Theksohet gjithashtu nevoja për transparencë në financimin e partive politike.<sup>25</sup> Transparencë në qasjen në pozicionin gjyqësor. Raporti thekson problemin me deficitin e transparencës dhe efikasitetin e ndihmës shtetërore,<sup>26</sup> si dhe nevojën për përmirësim të transparencës në prokurimet publike dhe transparencën e buxhetit dhe efektivitetin e shpenzimeve publike.<sup>27</sup> Sipas Raportit, Ministria e Financave “duhet të bëjë përpjekje shtesë për të rritur pjesëmarrjen e publikut në çdo fazë të përgatitjes, ekzekutimit dhe raportimit të buxhetit”.<sup>28</sup>

Në drejtim të përmirësimit të lirisë dhe transparencës së medias, raporti thekson se duhet të sigurohet një transparencë më e madhe në reklamimin e institucioneve shtetërore dhe partive politike në media.<sup>29</sup> Raporti vë në dukje problemin e mungesës së detyrimeve ligjore për portalet online, sa i përket transparencës së pronësisë së tyre.<sup>30</sup> Gjithashtu theksohet nevoja e përshtatjes së legjislacionit kombëtar me standardet e BE-së, për të garantuar pavarësinë, standardet profesionale dhe qëndrueshmërinë finan-

23 Komisioni i Bashkimit Evropian (2022) Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022, në shtojcë të, Komunikimit të Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikatë për Politikën për Zgjerim të BE-së për 2022, SVD (2022) 337, i disponueshëm në: <https://www.sep.gov.mk/page/?id=1117#>. Y860ga3MK5c (qasur më 01.12.2022)

24 Ibid, f. 14)

25 Ibid, f. 11-12)

26 Ibid, f. 70)

27 Ibid, f. 16)

28 Ibid, f. 16)

29 Ibid, f. 32)

30 Ibid, f. 94)

ciare të shërbimit publik radiodifuziv, të vazhdojë aktivitetin për vetë-rregullimin e mediave<sup>31</sup> si dhe të zgjidhet problemi me të drejtat e gazetarëve, veçanërisht rastet me kërcënime dhe dhunë dhe të ndëshkohen autorët.<sup>32</sup> Raporti thekson mungesën e transparencës në lidhje me qasjen në informacione.<sup>33</sup> Në këtë kontekst, vërehet se kapacitetet administrative në të gjitha nivelet mbeten të dobëta, me burime të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin dhe implementimin e legjislacionit ekzistues.<sup>34</sup> Disa nga problemet dhe çështjet e evidentuara në raportin e BE-së po trajtohen vazhdimisht në kuadër të programit ndërkombëtar Partneritet për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership), të iniciuar nga SHBA-të.

## 3.1 Aktet kombëtare në lidhje me transparencën

### Partneritet për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership)

Partneriteti për Qeverisje të Hapur është një nismë ndërkombëtare, e iniciuar nga SHBA, ku R. e Maqedonisë së Veriut është anëtare që nga viti 2011.<sup>35</sup> Duke iu bashkuar nismës, Qeveria nënshkroi një Deklaratë me të cilën mori përsipër të përgatisë dhe zbatojë angazhime specifike për promovimin e transparencës, mbështetjen e pjesëmarrjes qytetare, luftën kundër korrupsionit, si dhe përdorimin e teknologjive të reja në administratën publike dhe jashtë saj, për mbështetje të inovacioneve. Në përputhje me këto detyrime, Qeveria, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, përgatit Planet Kombëtare të Veprimit (PKV) dyvjeçare. Deri më tani janë miratuar pesë (5) plane të tilla: PKV1 (2012-2014), PKV2 (2014-2016); PKV3 (2016-2018), PKV4 (2018-2020) dhe PKV i fundit, PKV aktual (2021-2023) të cilat janë paraqitur në Aneksin 2a.

Analiza në zyrë e këtij hulumtimi konstaton vazhdimësinë e strukturës dhe prioritetëve në tre planet e para të veprimit. Konkretisht, PKV1, PKV2; PKV3 kanë një strukturë dhe prioritete pothuajse identike. Me PKV4, ndryshimet më të mëdha fillojnë të vërehen, ndërsa dallimet janë më të dukshme me PKV5. Krahas prioritetit “Parlament i Hapur”, PKV5 përfshin edhe prioritetin “Gjyqësor i Hapur”. Për shkak të këtyre ndryshimeve, Qeveria e RMV-së, me planin më të fundit të veprimit PKV5 (2021-23), e quajti nismën në “Partneritet për Qeverisje të Hapur” (PQH).<sup>36</sup>

Ajo që bie në sy në lidhje me PKV5 është se pesë prioritete janë hequr nga planet e mëparshme të veprimit:

- Krijim i politikave me pjesëmarrje
- Të dhëna të hapura
- Qasje e lirë në informatat me karakter publik
- Menaxhimi efikas me burimet publike (transparenca fiskale)
- Hapja në nivel lokal

31 Ibid, f. 7)

32 Ibid, f. 32)

33 Ibid, f. 112-113)

34 Ibid, f. 112-113)

35 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Partneritet për Qeveri të Hapur <https://ovp.gov.mk/%d0%be%d1%82%d0%b2%d0%be%d1%80%d0%b5%d0%bd%d0%be-%d0%b2%d0%bb%d0%b0%d0%b4%d0%b8%d0%bd%d0%be-%d0%bf%d0%b0%d1%80%d1%82%d0%bd%d0%b5%d1%80%d1%81%d1%82%d0%b2%d0%be/> (vizita e fundit 11.1. 2023)

36 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës së R.S. Maqedonia, (2021) Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2021-2023, [https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023-\\_potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf](https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023-_potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf) (vizita e fundit 11.1. 2023)



Në PKV5, këto prioritete janë hequr përkatësisht shkrihen dhe reduktohen në masa apo aktivitete, në kuadër të prioritetit të ri të quajtur Transparenca, llogaridhënia dhe gjithë përfshirja. Ideja e shkrirjes së prioriteteve të mësipërme mund të konsiderohet e kuptueshme sepse të gjitha kanë një lidhje të drejt-përdrejtë me afirmimin e transparencës. Prioriteti i ri i PKV5 i quajtur Transparenca, llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja parashikon gjashtë (6) masa, që është shumë më pak në krahasim me masat e planeve të mëparshme të veprimit që u referohen prioriteteve të mësipërme: PKV1 kishte 22 masa, PKV2 kishte 35 masa, PKV3 kishte 26 masa, dhe PKV4 kishte 13 masa. (shih tabelën në aneks).

Plani Kombëtar i Veprimit (2021-2023) për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur<sup>37</sup> ose PKV5<sup>38</sup>, vendos tre fusha kyçe – Qeveri e hapur, Parlament i hapur dhe gjyqësor i hapur. Janë vendosur pesë prioritete për Qeverinë e Hapur: (1) transparenca, llogaridhënia, proaktiviteti dhe gjithëpërfshirja, (2) parandalimi i korrupsionit dhe qeverisja e mirë, (3) përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike, (4) qasje në drejtësi, (5) mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike. Për Parlamentin e Hapur janë vendosur tre prioritete: (1) Kuvend për qytetarët me përgjigje të hapur dhe rimëkëmbje të hapur nga pandemia COVID-19, (2) infrastrukturë e përmirësuar TIK dhe (3) pjesëmarrje qytetare/parlament i hapur, Për Gjyqësor të Hapur janë vendosur dy prioritete: (1) qasja në informacion dhe të dhëna dhe (2) performanca e institucioneve.

Në veçanti, transparenca, llogaridhënia, proaktiviteti dhe gjithëpërfshirja prioritare parashikon zbatimin e gjashtë masave:

1. *Shpallja publike e pronarëve të vërtetë të firmave që kanë lidhur kontratat për prokurim publik*, masë për të rritur transparencën në strukturën e pronësisë së personave juridikë për parandalim të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit
2. *Publikimi proaktiv i informacioneve të natyrës publike në ueb faqet të institucioneve* bartës të institucioneve i referohet zbatimit të nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik.<sup>39</sup>
3. *Publikimi i të dhënave bazë për prokurimet publike në faqet e internetit të institucioneve*. Ato janë tashmë të disponueshme në portalin qeveritar Sistemi Elektronik për Prokurimin Publik (SEPP). Masa parashikon që institucionet të krijojnë një seksion (skedë) të veçantë në faqet e tyre të internetit për “prokurimin publik” dhe të publikojnë aty kontratat e prokurimit publik në të cilat marrin pjesë. Gjithashtu është planifikuar të publikohen informacionet dhe dokumentet e mëposhtme në faqen e çdo institucioni (në rubrikën “prokurim publik”): plani vjetor për prokurimin publik (me të gjitha ndryshimet dhe shtesat); shpallje për prokurimet publike (linqe nga shpalljet nga SEPP); njoftimet

37 Shiko: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/final\\_mkd\\_nap5\\_pov\\_2021-2023\\_compressed.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/final_mkd_nap5_pov_2021-2023_compressed.pdf)

38 Bëhet fjalë për Planin e Pestë Kombëtar të Veprimit. Partneriteti për Qeveri të Hapur është një nismë ndërkombëtare ku RMV-ja ka qenë anëtare që nga fillimi në 2011. Me nënshkrimin e Deklaratës, Qeveria mori përsipër të përgatisë dhe zbatojë angazhime specifike për promovimin e transparencës, mbështetjen e pjesëmarrjes qytetare, luftën kundër korrupsionit, si dhe përdorimin e teknologjive të reja në administratën publike dhe jashtë saj, për mbështetje të inovacioneve. Në përputhje me këto detyrime, Qeveria, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, përgatit Planet Kombëtar të Veprimit (PKV) dyvjeçare. Deri më tani janë miratuar pesë (5) plane të tilla: PKV1 (2012-2014), PKV2 (2014-2016); PKV3 (2016-2018), PKV4 (2018-2020) dhe e fundit, PKV5 aktual (2021-2023).

39 Niveli i zbatimit është vlerësuar si i rëndësishëm dhe i referohet transparencës aktive dhe ka dy kërkesa për bartësit e informatave: dërgimi i linqeve nga ueb-faqet e tyre si dhe dërgimi i një raporti vjetor (për zbatimin e nenit 10) në Agjencinë për Qasje të lirë në informata me karakter publik (AQIKP) (). Detyrimet e kësaj mase i referohen 1445 mbajtësve të regjistruar të informacionit publik. Sa i përket linqeve në internet, 322 posedues (22.28%) janë vlerësuar si proaktive transparente, 934 (64.63%) nuk janë në mënyrë aktive transparente dhe 78 (5.39%) janë pjesërisht transparente. Sa i përket detyrimit për raport vjetor, 1334 posedues (92,32%) kanë dorëzuar, dhe 111 (7,68%) nuk e kanë përmbushur detyrimin ligjor. - Shiko Publikimi proaktiv i informacioneve publike në faqet e internetit të institucioneve [https://ovp.gov.mk/nap\\_proposals/%d0%bf%d1%80%d0%be%d0%b0%d0%ba%d1%82%d0%b8%d0%b2%d0%bd%d0%be-%d0%be%d0%b1%d1%98%d0%b0%d0%b2%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%b8%d0%bd%d1%84%d0%be%d1%80%d0%bc%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%b8/](https://ovp.gov.mk/nap_proposals/%d0%bf%d1%80%d0%be%d0%b0%d0%ba%d1%82%d0%b8%d0%b2%d0%bd%d0%be-%d0%be%d0%b1%d1%98%d0%b0%d0%b2%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%b8%d0%bd%d1%84%d0%be%d1%80%d0%bc%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%b8/)

për kontratat e lidhura (link nga njoftimet e SEPP); kontratat e lidhura për prokurimet publike dhe njoftime për kontrata të realizuara (linqe nga postimet nga SEPP).<sup>40</sup>

4. *Përmirësimi i qasjes në informacione dhe numri i të dhënave të hapura të publikuara në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVQL), përfshin mbledhjen e të dhënave dhe matjet e hapjes së NJVQL-ve, si dhe trajnimin për transparencën dhe të dhënat e hapura të 30 njësiteve të vetëqeverisjes lokale (NJVL). Masa ka përfunduar.<sup>41</sup>*
5. *Qasje falas në të dhëna për organizatat e shoqërisë civile dhe përditësim i rregullt.<sup>42</sup>*
6. *Transparenca dhe llogaridhënia fiskale në nivel lokal, si dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje, parashikon formimin dhe vënien në funksion të tabelave elektronike në 20 komuna në të cilat automatikisht do të publikohen raportet tremujore për realizimin e buxhetit të komunës, të përpunuara në mënyrë të kuptueshme dhe të qasshme për qytetarët.<sup>43</sup>*

Zbatimi i prioritetit për transparencë, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje është i lidhur kronologjikisht me dy dokumente strategjike kombëtare, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në problemin e transparencës së institucioneve, konkretisht Strategjia për të Dhënat e Hapura (2018–2020) dhe Strategjia për Transparencë (2019–2021).

## Strategjia për të dhëna të hapura

Termi të dhëna të hapura nënkupton hapjen e të dhënave që rrjedhin nga puna e organeve dhe institucioneve nga sektori publik dhe disponueshmëria e tyre e lehtë dhe e thjeshtë për publikun. Bëhet fjalë për detyrimet e institucioneve dhe autoriteteve publike për të siguruar qasje të lehtë në të dhënat që disponojnë, të cilat do të jenë të disponueshme në format të hapur, përkatësisht në një ueb format i përdorshëm nga kompjuteri që mund të shkarkohet, indeksohet, ripërdoret, kërkohet dhe përditësohet rregullisht.

Strategjia për të Dhëna të Hapura 2018–2020, vë në dukje nevojën për zbatimin më të mirë të Ligjit për përdorimin e të dhënave të sektorit publik dhe akteve nënligjore që lidhen me të. Ligji u miratua me qëllim harmonizim të legjislacionit kombëtar me Direktivën e Bashkimit Evropian për ripërdorimin e informacioneve të sektorit publik 2003/98/EC. Aspekti më pozitiv i Strategjisë është përcaktimi i transparencës. Ky është i vetmi dokument strategjik kombëtar që ofron një përkufizim më të plotë të transparencës: *“Transparencë do të thotë që qeveria është e hapur ndaj qytetarëve dhe vë në dispozicion jo vetëm informacionet, por edhe aktivitetet dhe procesin e vendimmarrjes.”<sup>44</sup>*

40 Zbatimi i masës vlerësohet i rëndësishëm- Shiko: Publikimi i informacionit bazë për prokurimin publik në faqet e internetit të institucioneve [https://ovp.gov.mk/nap\\_proposals/%d0%be%d0%b1%d1%98%d0%b0%d0%b2%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%be%d1%81%d0%bd%d0%be%d0%b2%d0%bd%d0%b8%d1%82%d0%b5-%d0%b8%d0%bd%d1%84%d0%be%d1%80%d0%bc%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%b8-%d0%b7/](https://ovp.gov.mk/nap_proposals/%d0%be%d0%b1%d1%98%d0%b0%d0%b2%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%be%d1%81%d0%bd%d0%be%d0%b2%d0%bd%d0%b8%d1%82%d0%b5-%d0%b8%d0%bd%d1%84%d0%be%d1%80%d0%bc%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%b8-%d0%b7/)

41 Përmirësimi i qasjes në informacione dhe numri i të dhënave të hapura të publikuara në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJQL) [https://ovp.gov.mk/nap\\_proposals/%d1%83%d0%bd%d0%b0%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%b4%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%bf%d1%80%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%b0%d0%bf%d0%be%d1%82-%d0%b4%d0%be-%d0%b8%d0%bd%d1%84%d0%be%d1%80%d0%bc%d0%b0/](https://ovp.gov.mk/nap_proposals/%d1%83%d0%bd%d0%b0%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%b4%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%bf%d1%80%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%b0%d0%bf%d0%be%d1%82-%d0%b4%d0%be-%d0%b8%d0%bd%d1%84%d0%be%d1%80%d0%bc%d0%b0/)

42 Aktivitetet në kuadër të masës kanë bërë progres të dukshëm, shkoni në: Mundësimi i qasjes së lirë në të dhëna për organizatat e shoqërisë civile [https://ovp.gov.mk/nap\\_proposals/%d0%be%d0%b2%d0%be%d0%b7%d0%bc%d0%be%d0%b6%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%b1%d0%b5%d1%81%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%bd-%d0%bf%d1%80%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%b0%d0%bf-%d0%b4%d0%be/](https://ovp.gov.mk/nap_proposals/%d0%be%d0%b2%d0%be%d0%b7%d0%bc%d0%be%d0%b6%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%b1%d0%b5%d1%81%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%bd-%d0%bf%d1%80%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%b0%d0%bf-%d0%b4%d0%be/)

43 Kjo masë ka një zbatim të konsiderueshëm, shih: Transparenca dhe llogaridhënia fiskale në nivel lokal dhe përmirësimi i përfshirjes së qytetarëve përmes mekanizmave dhe mjeteve inovative [https://ovp.gov.mk/nap\\_proposals/%d1%84%d0%b8%d1%81%d0%ba%d0%b0%d0%bb%d0%bd%d0%b0-%d1%82%d1%80%d0%b0%d0%bd%d1%81%d0%bf%d0%b0%d1%80%d0%b5%d0%bd%d1%82%d0%bd%d0%be%d1%81%d1%82-%d0%b8-%d0%be%d1%82%d1%87%d0%b5%d1%82%d0%bd%d0%be%d1%81/](https://ovp.gov.mk/nap_proposals/%d1%84%d0%b8%d1%81%d0%ba%d0%b0%d0%bb%d0%bd%d0%b0-%d1%82%d1%80%d0%b0%d0%bd%d1%81%d0%bf%d0%b0%d1%80%d0%b5%d0%bd%d1%82%d0%bd%d0%be%d1%81%d1%82-%d0%b8-%d0%be%d1%82%d1%87%d0%b5%d1%82%d0%bd%d0%be%d1%81/)

44 Shiko: [https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/strategjia\\_za\\_otvoreni\\_podatoci\\_mk\\_0.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/strategjia_za_otvoreni_podatoci_mk_0.pdf)

Në kuadër të Strategjisë u miratua një Plan Veprimi dyvjeçar, i cili parashikon 20 masa brenda tre prioritetëve:<sup>45</sup>

- (1) *Rregullativë* e favorshme dhe trajnimin e zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e të dhënave të hapura.
- (2) *Institucionet hapin të dhënat e tyre. Këtu* paralojmë krijimi i portalit të ri data.gov.mk, por nuk përmendet aspak se tashmë ekziston një portal funksional [www.otvorenipodatoci.gov.mk](http://www.otvorenipodatoci.gov.mk).
- (3) *Rritja e përdorimit të të dhënave të hapura.*

Nuk ka të dhëna për suksesin e zbatimit të Planit të veprimit, as njoftim për miratimin e një dokumenti të ri pas skadimit të Strategjisë në 2020. Aktivitetet e PKV1,<sup>46</sup> PKV2<sup>47</sup> dhe PKV3<sup>48</sup> kanë për qëllim krijimin, funksionimin dhe përmirësimin e portalit [www.otvorenipodatoci.gov.mk](http://www.otvorenipodatoci.gov.mk). Por me PKV4 (2018-2020) përmendet një portal krejtësisht tjetër <https://data.gov.mk/>, e cila përkon me Strategjinë e të Dhënave të Hapura 2018-2020.

## Strategji për tansparencë

Strategjia për transparencë 2019-2021<sup>49</sup> është fokusuar ngushtë në konceptin e transparencës aktive dhe zbatimin e nenit 10 të Ligjit për qasje në informata me karakter publik. Strategjia mbulon Qeverinë, ministritë, organet në përbërjen e tyre, organet e pavarura të administratës shtetërore, organet e pavarura shtetërore që përgjigjen para Qeverisë (drejtuesit e të cilëve zgjidhen/emërohen nga QRMV), organizatat administrative që përgjigjen para QRMV-së, si dhe ndërmarrjet publike të themeluara nga QRMV-ja dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore. Gjithashtu mbulon jo vetëm ato të formuara me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, por edhe ato të formuara me ligje të veçanta.

Për zbatimin e Strategjisë është miratuar një Plan Veprimi për periudhën 2019-2021 me 45 aktivitete, nga të cilat vetëm dy janë realizuar plotësisht dhe dy kanë filluar.<sup>50</sup> Përditësimi i softuerit të ENER për instalimin e akteve nënligjore nga institucionet dhe organet ekzekutive ka përfunduar plotësisht. Por është e paqartë pse deri më tani Qeveria nuk ka kryer aktivitetin vijues për të miratuar një Vendim për të detyruar të gjitha institucionet që të publikojnë aktet nënligjore në ENER. Gjithashtu, është zbatuar plotësisht detyrimi i Qeverisë për të paraqitur një listë me numër minimal informacionesh dhe dokumentesh të detyrueshme për publikim në faqen e çdo autoriteti dhe të krijohet një kuadër për monitorimin e lidhjes së ueb faqeve me sistemin elektronik. Është kryer pjesërisht hartimi i një vendimi për transferimin e autoritetit vendimmarrës në procedurat për qasje në informacione, si dhe kalimi i autorizimit nga personi përgjegjës te një zyrtar për qasje të lirë në informacione për zgjidhje të pavarur në procedurat për qasjes në informacione.

45 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së V. (2018) Strategjia e të dhënave të hapura të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018-2020) [https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/strategjia\\_za\\_otvoreni\\_podatoci\\_mk\\_0.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/strategjia_za_otvoreni_podatoci_mk_0.pdf) (пристапено на: 29.11.2022)

46 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës së RMV, (2012) Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2012-2014 <https://ovp.gov.mk/nap/%d0%bd%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%b5%d0%bd-%d0%b0%d0%ba%d1%86%d0%b8%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d0%bd-%d0%b7%d0%b0-%d0%be%d0%b2%d0%bf-2012-2014/> (последна посета 03.01. 2023)

47 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, (2014) Informacion mbi rezultatet e grupit punues për zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2014-2016 me një raport përfundimtar <https://ovp.gov.mk/nap/%d0%bd%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%b5%d0%bd-%d0%b0%d0%ba%d1%86%d0%b8%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d0%bd-%d0%b7%d0%b0-%d0%be%d0%b2%d0%bf-2014-2016/> (vizita e fundit 03.01. 2023)

48 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës së RMV, (2016) Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2016-2018 <https://ovp.gov.mk/nap/%d0%bd%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%b5%d0%bd-%d0%b0%d0%ba%d1%86%d0%b8%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d0%bd-%d0%b7%d0%b0-%d0%be%d0%b2%d0%bf-2016-2018/> (vizita e fundit 29.12. 2022)

49 Shiko: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategji/strategjia\\_za\\_transparentnost\\_mk.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategji/strategjia_za_transparentnost_mk.pdf)

50 Shiko: [https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2021/03/izvestaj\\_02\\_monitoring-na-strategijata-za-transparentnost.pdf](https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2021/03/izvestaj_02_monitoring-na-strategijata-za-transparentnost.pdf)

Pavarësisht dështimit në zbatimin e aktiviteteve, Strategjia është domethënëse për sa i përket përkufizimit që ofron për transparencën: *“QRMV-së pranon se një autoritet/qeveri/organ i caktuar politik i administratës shtetërore nuk mund të vlerësohet si transparent pa plotësuar të paktën dy parakushte: (\*) qytetarët mund të realizojnë efektivisht të drejtën e tyre për të kërkuar të dhëna me karakter publik duke mos u përballur me vështirësi, dhe (\*) të theksohet publikimi proaktiv i të dhënave publike.”*<sup>51</sup> Ky përkufizim është krejtësisht i ndryshëm nga përkufizimi në Strategjinë për të Dhëna të Hapura dhe tregon se Qeveria redukton transparencën në një kuptim shumë të ngushtë. Strategjia për transparencë thekson se një përkufizim i tillë është në funksion të promovimit të “transparencës aktive”.

Në parim, promovimi i transparencës aktive nënkupton plotësimin e transparencës, e cila u jep mundësi institucioneve të përdorin avantazhet e teknologjive të reja (Internet), të tregtojnë një sasi të caktuar informacioni pa kërkesën e askujt. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme të kihet parasysh se teknologjia është në funksion dhe ndihmon transparencën, por nuk është parakusht për transparencë. Transparenca është një çështje sistemike dhe kërkon zgjidhje sistemike që mund të jenë të qëndrueshme vetëm në një kulturë transparence, gjegjësisht kultura e administratës publike se është në shërbim të interesave të qytetarëve, përkatësisht interesi i qytetarëve identifikohet me interesin e shtetit.

Në shkurt të vitit 2023, zëvendëskryetarja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përgjegjëse për politika të qeverisjes së mirë, Sllavica Grkovska dhe Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis, nënshkruan Memorandum për Bashkëpunim, me qëllim të përgatitjes së Strategjisë së re për Transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.<sup>52</sup> Në njoftimin zyrtar të Qeverisë, thuhet se me Strategjinë e re do të funksionalizohen dhe përmirësohen rregullat për komunikim ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve dhe parimi i transparencës, ndërsa Strategjia e Qeverisë për Transparencë do të përgatitet përmes një procesi të gjerë konsultativ.<sup>53</sup> Sipas Metamorfozis, synimi i strategjisë së re është të sjellë ndryshime sistematike në drejtim të qeverisjes së mirë. Të dyja palët njoftojnë se Strategjia do të miratohet në një proces të gjerë konsultativ me organizatat e shoqërisë civile.<sup>54</sup>

## 3.2 Aktet kombëtare në lidhje me dezinformatat<sup>55</sup>

Ashtu si në Bashkimin Evropian, edhe ne kemi një përpjekje për të funksionalizuar luftën kundër dezinformatave. Modelet më të zakonshme janë Mbretëria e Bashkuar dhe Estonia, ku ka sektorë të veçantë që vitet e fundit janë “pasuruar” me burime njerëzore dhe financiare ose në nivel politikash (protokollet e

51 Strategjia për Transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2019-2021), f.13

[https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategii/strategija\\_za\\_transparentnost\\_mk.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategii/strategija_za_transparentnost_mk.pdf) (qasur më: 25.11.2022)

52 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2023), Grkovska: Qeveria në bashkëpunim me Metamorfozis do të përgatisë Strategjinë e re për Transparencë, <https://vlada.mk/node/32072> (qasur më 20.02.2023)

53 Grkovska: Qeveria në bashkëpunim me Metamorphosis do të përgatisë Strategjinë e re për Transparencën, publikuar më 13.02.2023, në dispozicion në adresën <https://www.slobodenpecat.mk/grkovska-vladata-vo-sorabotka-so-metamorfozis-kje-ja-podgotvi-novata-strategija-za-transparentnost/>, aksesuar më 20.02.2023

54 Metamorphosis, (2023), Metamorfoza duke mbështetur procesin e krijimit të Strategjisë së Qeverisë për Transparencë do të kontribuojë në avancimin e procesit të transparencës së Qeverisë dhe institucioneve, Shkup, shkurt 2023 [https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti\\_arhiva/metamorfozis-so-poddrshka-na-procesot-za-kreiranje-na-strategija-na-transparentnost-na-vladata-ke-pridonese-vo-unapreduvanje-na-procesot-na-transparentnost-na-vladata-i-instituciite/](https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/metamorfozis-so-poddrshka-na-procesot-za-kreiranje-na-strategija-na-transparentnost-na-vladata-ke-pridonese-vo-unapreduvanje-na-procesot-na-transparentnost-na-vladata-i-instituciite/) (qasur më 20.02.2023)

55 Përveç Propozimit, plani i Qeverisë kundër përhapjes së dezinformatave dhe 3 dokumentet e mëposhtme prekin (në mënyrë të nënkuptuar ose eksplicite) problemin e dezinformimit: 1) Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike e Republikës së Maqedonisë (2018-2022) Strategjia nuk trajton problemin e dezinformatave, por përmban elementë dhe aktivitete që kanë pika kontakti me këtë problem, veçanërisht në lidhje me çështjen e kulturës kibernetike dhe kulturës së sigurisë kibernetike mund të konsiderohet e lidhur dhe 2) Kombëtare. Strategjia për ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe përballjen me kërcënimet hibride - Strategjia përcakton gjashtë fusha të aktiviteteve operacionale për trajtimin e kërcënimeve hibride. Dezinformatat përmenden në disa 3) Strategjia Kombëtare për Ndërtimin e Rezistencës dhe Ballafaqimin me Kërcënimet Hibride. Strategjia trajton dezinformata në një kuadër më të gjerë, si pjesë e kërcënimeve hibride.

brendshme). Maqedonia është një nga vendet e pakta në rajon që ka bërë përpjekje për një luftë sistematike kundër dezinformatave, si vertikalisht ashtu edhe horizontalisht. Një nga ato dokumente ishte Plani i Propozuar i Qeverisë kundër përhapjes së dezinformatave.

## **Plani i propozuar për veprim vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave dhe kundër sulmeve ndaj demokracisë**

Problemi me përhapjen e dezinformatave mori vëmendje të madhe nga institucionet qeveritare për herë të parë në vitin 2019, kur Qeveria promovoi Planin e Propozuar për veprim vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave.<sup>56</sup> Dokumenti përbëhet nga dy pjesë, masat e sigurisë dhe ato proaktive. Zyrtarët e sigurisë theksojnë nevojën e zhvillimit të protokolleve për komunikimin në institucione, një protokoll për komunikimet digjitale për të gjithë nëpunësit civilë (internet, e-mail, celular etj.), si dhe një protokoll për komunikimet në krizë ndërmjet shërbimit të komunikimit të qeverisë qendrore dhe ministritë për të kundërshtuar përhapjen e dezinformatave përmes rrjeteve sociale dhe portaleve të internetit. Këto masa përfshijnë infrastrukturën e brendshme të TI-së në Qeveri dhe ministri, numrin e telefonit dhe pajisjen celulare të Kryetarit të Qeverisë së RMV-së, si dhe zbatimin e një protokollit sigurie për komunikimet digjitale. Pjesa e dytë e Planit të Propozuar parashikon disa “masa proaktive”:

- Promovimi i transparencës aktive si parandalim i dezinformatave.
- Formimi i një grupi veprimi për të luftuar dezinformatat dhe sulmet ndaj demokracisë. Grupi do të analizojë dhe monitorojë dezinformatat dhe do të bashkëpunojë me platformat e mediave sociale të përdorura për përhapjen e dezinformatave.
- Krijimi i një strategjie kombëtare për edukim mediatik.
- Përcaktimi i një modeli për mbështetjen e përmbajtjeve mediatike për luftë kundër dezinformatave, si dhe programe edukative dhe trajnime për punonjësit e medias, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të tyre profesional në luftën kundër dezinformatave.
- Inkurajimi i diskutimit ndërmjet mediave, shoqatave mediatike dhe sektorit civil, për vetë-rregullimin, bashkë-rregullimin dhe vendosjen e standardeve mediatike për portalet e internetit, në përputhje me rekomandimet e KE-së dhe Këshillit të Evropës.
- Vendosja e “kriterëve të qarta për mediat, të cilat janë të akredituara për të monitoruar ngjarjet e qeverisë dhe konferencat për shtyp, në përputhje me standardet e profesionit të gazetarit.”
- Bashkëpunimi me organizatat dhe projektet që punojnë në kontrollimin e fakteve (Fact-checkers) dhe krijimin e një regjistri për dezinformatat e vërtetuara dhe të definuara, si dhe një listë të burimeve që përhapin dezinformata.
- Bashkëpunimi me KE-në dhe përfshirja në sistemin e alarmit të shpejtë për përhapjen e dezinformatave (Rapid alert system), me qëllim shkëmbimin e informacionit për përmbajtjen dhe temat e fushatave të dezinformata në të gjithë Evropën.
- Bashkëpunimi me BE-në dhe NATO-n në luftën kundër dezinformatave.

Propozim Plani u promovua në vitin 2019, por nuk ishte miratuar pasi shkaktoi kritika në mesin e publikut profesionist dhe shoqatave profesionale gazetareske. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) vlerësoi se masat nga Draft-plani kanë një sërë paqartësish dhe mund të interpretohen si përpjekje për të

56 Shiko: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/predlog-plan\\_za\\_akcija\\_protiv\\_dezinformacii\\_final.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/predlog-plan_za_akcija_protiv_dezinformacii_final.pdf)

kufizuar lirinë e shprehjes, nënkuptojnë fushata me pagesë në mediat private ndërkaq shprehi dyshime për njoftimin e bashkë-rregullimit dhe vendosjes së kriterëve për akreditimin e mediave që do të kenë të drejtën të ndjekin ngjarjet qeveritare. Gjithashtu, ata theksuan se politikat për parandalimin e dezinformative duhet të krijohen përmes përfshirjes së plotë të gazetarëve dhe mediave, për të përjashtuar rreziqet që ata do të keqpërdoren ndaj lirisë së fjalës dhe rekomandon qasjen e BE-së për përballje me dezinformatat, duke theksuar se në këtë proces duhet të merret parasysh konteksti lokal.<sup>57</sup>

Një mangësi serioze e Planit të Propozuar (si dhe në dokumente të tjera strategjike) është mungesa e një përkufizimi të dezinformimit, i cili vë në pikëpyetje krijimin e politikave dhe masave efektive, të koordinuara për parandalimin e tyre. Gjithashtu, nevojitet një diferencim më i qartë ndërmjet mediave konvencionale dhe portaleve të internetit dhe rrjeteve sociale, të cilat janë burimi më i zakonshëm i dezinformative në publikun vendas. Në të njëjtën kohë, duhet të merret parasysh rreziku i mundshëm i "pastrimit të informacioneve"<sup>58</sup> përkatësisht rreziku i mundësisë së dezinformative të postuara përmes portaleve të internetit dhe mediave sociale të postohen përmes mediave tradicionale dhe në këtë mënyrë të fitohet legjitimiteti i informacionit të besueshëm për publikun e gjerë.

## Dokumente të tjera

Në këtë kontekst, duhen përmendur edhe dy dokumente që prekin në mënyrë implicite apo eksplicite problemin me dezinformatat. Kjo është **Strategjia Kombëtare për Siguri Kibernetike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018-2022)** që nuk trajton drejtpërdrejt dezinformatat, por përmban elementë dhe aktivitete që kanë pika kontakti me këtë problem, veçanërisht për sa i përket çështjes së kulturës kibernetike dhe kulturës së sigurisë kibernetike që mund të konsiderohen si të lidhura. Dokumenti i dytë është **Strategjia Kombëtare për Ndërtimin e Rezistencës dhe Ballafaqimin me Kërcënimet Hibride të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2021)**. Strategjia përcakton gjashtë fusha të aktiviteteve operacionale për përballje me kërcënime hibride ndërsa në disa prej tyre përmenden dezinformatat. Gjatë kësaj, dezinformatat trajtohet në një kuadër më të gjerë, si pjesë e kërcënimeve hibride (më shumë në Aneksin 2).

57 Shiko: <https://znm.org.mk/znm-del-od-merkite-vo-planot-na-vladata/>

58 Klein Adam (2012) Slipping Racism into the Mainstream: A Theory of Information Laundering, available at: [https://www.researchgate.net/figure/Model-of-information-laundering\\_fig2\\_263138211](https://www.researchgate.net/figure/Model-of-information-laundering_fig2_263138211)

# Praktika e transparencës së institucioneve shtetërore në luftën kundër dezinformatave

## 04

**K**a shumë liderë politikë në mbarë botën që respektojnë idenë e qeverisjes së hapur. Shembullin e ndjek Bashkimi Evropian, edhe pse nuk është një qeveri në kuptimin e vërtetë të fjalës, duke forcuar kështu legjitimitetin e saj. Që nga viti 2011, Maqedonia e Veriut në mënyrë normative ka hapur rrugën për qeverisje të hapur dhe ky proces vazhdon edhe sot.

Prandaj, në mënyrë empirike, hulumtimi shqyrton marrëdhëniet ndërmjet transparencës institucionale (hapjes) dhe dezinformatave në kontekstin maqedonas. Tematikisht, analiza jep një pasqyrë të mënyrave se si perceptohet dhe praktikohet transparenca institucionale nga përfaqësuesit e institucioneve, si dhe mënyra se si ata mendojnë dhe trajtojnë dezinformatat. Në të njëjtën kohë, bazë janë dokumentet strategjike kombëtare dhe planet e veprimit, në të cilat apostrofohen fushat kryesore, prioritetet, masat, metodat, instrumentet dhe bartësit e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara për “qeverisjen e hapur” dhe për përballje me dezinformatat.

### **Në fokus: funksionimi transparent i institucioneve shtetërore**

Në aspektin strategjik, Maqedonia e Veriut me një dokument të veçantë (nga viti 2019) ka theksuar transparencën aktive, gjegjësisht “vullnetare”, që nënkupton publikimin e të dhënave të Qeverisë dhe organeve të administratës shtetërore, pa qytetarët, personat juridikë, mediat dhe ngjashëm të përdorin

mekanizmat për qasje në informacionet me karakter publik të përcaktuar në legjislacion.<sup>59</sup> Në veçanti, me një plan veprimi përcaktohen aktivitetet e planifikuara, por monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë së Transparencës (që i referohet periudhës 2019-2020) përcakton një nivel të ulët të realizimit të planit.<sup>60</sup>

Cila është fotografia sot? Rezultatet në terren janë shumë të ndryshme, madje edhe kontradiktore. Një nga shembujt ndoshta më “transparent”, që vërteton këtë janë *faqet e internetit të institucioneve shtetërore* për të cilat strategjia e transparencës vë në dukje mosfunksionim, pabarazi në numrin e të dhënave, madje edhe institucione që nuk kanë fare ueb faqe, të cilat çdo qytetar mund t’i kontrollojë dhe konfirmojë thjesht duke i shfletuar. Në të njëjtën kohë, në numrin më të madh të institucioneve (ministrive), sipas deklaratave të personave për marrëdhënie me publikun, faqet e internetit përditësohen rregullisht (shpesh çdo ditë), ndërsa për këtë më së shpeshti angazhohen njësitë për marrëdhënie me publikun, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim (për pjesën teknike) me njerëz të sektorit të TI-së, të vetë institucionit. Në raste të jashtëzakonshme, këto janë: departamentet e mbështetjes logjistike (MK), sektori i teknologjisë informative (MP), madje edhe personi përgjegjës për ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik (MLS).

Njëkohësisht theksohet se “në pritje është procesi për krijimin e ueb faqeve të reja të unifikuara, të udhëhequra nga Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës, të cilat do të zëvendësojnë ato të vjetruarat” (MTL, MK, MMJPH, MPB) si një nga mjetet për një transparencë më të madhe të institucioneve. Ndërkohë, Ministria e Mbrojtjes në vitin 2021 ka vendosur një pamje të re në ueb faqen e saj. Në faqen “përparësi” ka linja e transparencës ku një sasi jashtëzakonisht e madhe informacioni për punën e ministrisë mund të gjendet shpejt dhe lehtë, seksioni - publiku ka të drejtë të dijë që përfshin pyetje të shpeshta, pyetësorë, pagat e zyrtarëve... raportet e auditimit, mbikëqyrja inspektuese; seksioni për qasje të lirë në informacione me karakter publik, legjislacioni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, dokumentet strategjike, buxheti dhe zbatimi i tij, prokurimet publike, kontratat e lidhura...”<sup>61</sup> Por këtu hapet dilema nëse bëhet fjalë për mungesë koordinimi dhe organizimi të punës së institucioneve shtetërore dhe jo më pak e rëndësishme, nëse Ministria do ta ndryshojë sërish faqen e internetit apo, nëse deri më tani nuk është përgatitur faqja e re e unifikuar, “shablloni” do të jetë pikërisht ueb faqja e tij?

Megjithatë, adresa kryesore për transparencë dhe përgjegjësi më të madhe të institucioneve shtetërore është Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik<sup>62</sup>, e veçanërisht neni 10, ku obligimet për informimin e publikut nga poseduesit e informatave (organet e pushtetit shtetëror, organet e komunave, qyteti i Shkupit, institucionet dhe shërbimet publike...), si të dhënat dhe kontaktet për punonjësit, zyrtarët, janë renditur në mënyrë taksative për organograme, rregullore, ligje, rregullore, urdhëresa, programe, plane strategjike, buxhete, raporte auditimi, prokurime publike, programe, raporte pune, studime, të dhëna statistikore... Ajo që mungon dhe tashmë është konstatuar është zbatimi efikas dhe konsekuent i Ligjit, që është prioritet i Qeverisë së RMV-së.

Por, parë nëpërmjet prizmit të institucioneve (ministrive), duket se ky mekanizëm funksionon “në mënyrë të përkryer” dhe “pa pengesa”. Përfaqësuesit e marrëdhënieve me publikun theksojnë se të gjitha ministrinë marrin kërkesa (diku më shumë, diku më pak) për qasje në informacione me karakter publik dhe

59 Shiko: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategii/strategija\\_za\\_transparentnost\\_mk.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategii/strategija_za_transparentnost_mk.pdf)

60 Shiko më tepër: [https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2021/03/izvestaj\\_02\\_monitoring-na-strategijata-za-transparentnost.pdf](https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2021/03/izvestaj_02_monitoring-na-strategijata-za-transparentnost.pdf)

61 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me një përfaqësues nga Departamenti i Komunikimit, Analitikës dhe Mbështetjes Operative në Ministrinë e Mbrojtjes, zhvilluar në dhjetor 2022.

62 Shiko më shumë: Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/19)



të gjitha atyre u përgjigjen “sipas rregulloreve ligjore dhe sipas afateve”, natyrisht nga personat përgjegjës të angazhuar për qasje të lirë në informata me karakter publik. Në të njëjtën kohë, nuk i kushtohet vëmendje mundësisë së paraqitjes së kërkesave gojarisht, me shkrim apo në mënyrë elektronike ndërsa qytetarët zakonisht kanë në dispozicion vetëm formën me shkrim. E njëjta gjë është tani dhe mund të kontrollohet në faqet e vetë institucioneve. Jo më pak e rëndësishme është edhe çështja e seriozitetit të kësaj materie, e cila kërkon ekspertizë maksimale të stafit, e cila konstatohet konkretisht në strategjinë për transparencë si një sfidë për institucionet. A është zgjidhja ajo që po bën Ministria e Mbrojtjes, përkatësisht ky proces parashikohet në detaje në “Rregulloren për transparencë në funksionimin e ministrisë” ku përcaktohen njësitë organizative përgjegjëse dhe afati për procedim të një kërkesë specifike.

Njëkohësisht, për forcimin normativ të transparencës, si mekanizëm për reduktimin e dezinformatave, si përmirësim (përveç Propozim-Planit për luftë vendimtare kundër dezinformatave), janë miratuar disa dokumente për forcimin e transparencës së institucioneve shtetërore, të cilat përfaqësojnë “vegla” për qeverisje transparente, hapje, institucione të hapura, të dhëna të hapura.<sup>63</sup> Por kur u kërkuar nga institucionet (ministritë) të shënojnë se cilat nga këto dokumente janë funksionalizuar në punën e tyre, u morën përgjigje formale se “qeverisin sipas të gjitha dokumentet dhe zbatohen në masën më të madhe të mundshme”, se “dokumentet aplikohen në punën e përditshme në të gjithë sektorët”, se “të gjitha udhëzimet janë respektuar plotësisht dhe të gjitha dokumentet janë zbatuar”. Vetëm, Ministria e Mbrojtjes në mënyrë specifike dhe precize iu referua “Strategjisë së Komunikimit të Ministrisë e cila bazohet në Strategjinë e Komunikimit të Qeverisë, Planit të Komunikimit të bazuar në programin 4-vjeçar të Qeverisë, me qëllim që “të flasë me një zë” për temat me interes më të lartë për publikun, Rregulloren për transparencë në punën e Ministrisë.”<sup>64</sup> Për shembull, Portali i të Dhënave të Hapura dhe Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës si koordinatore e aktiviteteve të publikimit të të dhënave të hapura (të disponueshme në faqen e internetit të ministrisë) nuk përmenden.

Çfarë mund të thuhet për dhomën ligjvënëse, transparencën e tij, hapjen në punë? *Kuvendi i RMV-së* prej kohësh ka Kanalin e Kuvendit, të posaçëm (si kanal i tretë në shërbimin publik radiodifuziv) në të cilin transmetohen rregullisht (live) seancat parlamentare, si dhe seancat e komisioneve parlamentare dhe çdo qytetar mund t'i ndjekë ato. Seancat janë të hapura për gazetarët, të cilët mund t'i ndjekin nga galeria dhe të bëjnë pyetje. Gjithashtu, që nga viti 2017, Kryetari i Kuvendit ka krijuar praktikën e informimeve të rregullta mujore me gazetarët të cilët mund të shtrojnë çdo pyetje dhe kjo është pjesë përbërëse e kalendarit të aktiviteteve të Kuvendit. Ekziston edhe Instituti Parlamentar përmes të cilit organizohen vizita në Kuvend, nga shkolla, fakultete, dhe qytetarët pothuajse çdo ditë.

*“Një hap në forcimin e transparencës është faqja e re ku mund të merrni të gjitha të dhënat për punën e Kuvendit, për çdo ligj, agjendat për çdo seancë, votimet, për të gjitha trupat punuese, ngjarjet në Kuvend (takime me ambasadorë, shtetarë) madje me mundësi për personat me shikim të dëmtuar.”<sup>65</sup>*

63 Para së gjithash, Strategjia e Komunikimit e Qeverisë, Strategjia e Transparencës dhe Plani i Veprimit (2019-2021), Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Dhënat e Hapura (2018-2020), Plani i Veprimit për Partneritetin e Qeverisë së Hapur (2021-2023).

64 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me një përfaqësues nga Sektori për Komunikim, Analitikë dhe Mbështetje Operative në Ministrinë e Mbrojtjes, zhvilluar në dhjetor 2022.

65 Deklaratë nga intervistë e kryer me shefin e sektorit për marrëdhënie me publikun në Kuvendin e RMV-së, të realizuar në dhjetor 2022.

Gjithashtu, janë forcuar edhe Sektori për Marrëdhënie me Publikun, i cili mbulon çështjen e dezinformative, si dhe Sektori për Kanalin e Kuvendit. Komunikimi me gazetarët bëhet përmes njoftimeve të rregullta, telefonit, ose përmes grupit të përbashkët në viber. Prandaj konkluzioni i përfaqësuesit të marrëdhënieve me publikun: “Në përgjithësi, Kuvendi është një nga institucionet më transparente, më të hapura. Prandaj quhet Kuvendi Popullor”.<sup>66</sup>

Natyrisht, duhet të jetë gjithashtu i hapur dhe transparent edhe *Institucioni Presidenti i Republikës së RVM-së*. Këtu, Kabineti luan një rol kyç si një shërbim profesional për të mbështetur punën e Presidentit. Instrumentet, mekanizmat dhe burimet janë të shumta. Sipas përfaqësuesit të shërbimit profesional, në faqen e internetit publikohet gjithçka që mund të publikohet me ligj, që nga të dhënat për punonjësit me numrat e kontaktit, kompetencat, trupat e punës dhe anëtarët e tyre, njoftimet, takimet, adresat, intervistat e presidentit etj. Është praktikë të mbahen konferenca të rregullta për shtyp, sidomos pas ngjarjeve të mëdha, pa kufizime në pyetjet e gazetarëve, por edhe informime me gazetarë dhe redaktorë për çështje të ndryshme, veçanërisht për avancime, dekrete apo vendime. “Ne kemi një politikë të disponueshmërisë 24/7 për gazetarët për t’iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të tyre.”<sup>67</sup> Por vërejtjet mund të vihen re, para së gjithash, në faqen e internetit. Domethënë, nëse institucionet shtetërore (ministritë) kanë nevojë për “përditësim” dhe shtim të të dhënave në faqet e tyre të vjetruara, ueb-faqja e Presidentit të RMV-së ka nevojë për më shumë transparencë të të dhënave ekzistuese.

Pavarësisht nga të gjitha shifrat, përqindjet, përafrimet për nivelin e arritur të transparencës së institucioneve shtetërore, nevojitet një vlerësim serioz i asaj që është bërë deri tani dhe një qasje për hartimin e një “strategjie të re afatgjatë për transparencë”. Por hapat që janë bërë deri më tani për transparencë proaktive e bën të pamundur kthimin pas. Gjithashtu paraqet udhëzues për institucionet e tjera. Por duhet pasur parasysh se nuk ka kapacitet që do të arrijë të hapë plotësisht të gjitha institucionet në një afat të caktuar, duke pasur parasysh se Qeveria është organ politik i përbërë nga aktorë të ndryshëm politikë”.<sup>68</sup> Në këtë kontekst, të menduarit e njërit prej përfaqësuesve të qeverisë në drejtim të një qasjeje sistematike, e cila do të përfshijë të gjithë, nga pushteti qendror (ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor) dhe trupat dhe organet e tij, vetëqeverisjen lokale, madje edhe sektorin privat (biznesin).

*“Një sistem që do të funksionojë, por jo brenda Qeverisë dhe kabineteve të ministrave pa departament me kapacitete të kufizuara personeli, por jashtë, si Komision, Agjenci, Institut, Sekretariat për qeverisje të mirë dhe të përgjegjshme, por që nuk do të varet nga vullneti politik i qeverisë. Me autoritetin për të monitoruar të gjithë, si qeverinë ashtu edhe sistemin e drejtësisë, pushtetin komunal, me profesionistë dhe ekspertë të punësuar dhe me përfshirjen e sektorit joqeveritar. Diçka e ngjashme me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit”.<sup>69</sup>*

66 Deklaratë nga një intervistë e zhvilluar me kolegë në Sektorin për Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e RMV-së, realizuar në dhjetor 2022.

67 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm, Shef i Shërbimit të Komunikimit në Zyrën e Presidentit të RMV-së, realizuar në nëntor 2022.

68 Deklaratë nga një intervistë e zhvilluar me një koordinator kombëtar në Qeverinë e RMV-së, realizuar në nëntor 2022.

69 Deklaratë nga intervista e koordinatorit kombëtar në Qeverinë e RSM të mbajtur në nëntor 2022.

# Në fokus: ballafaqimi me dezinformatat në sferën publike

Rritja e dezinformatave, veçanërisht e shprehur vitet e fundit si në nivel botëror, ashtu edhe në nivel shtetëror, do të hapë seriozisht çështjen e marrjes së masave për mbrojtjen e demokracisë nga kjo sfidë. Në këtë kontekst është edhe Propozim-plani për veprim vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave dhe kundër sulmeve ndaj demokracisë<sup>70</sup>, sublimimi i rekomandimeve në luftën kundër dezinformatave të cilin Qeveria e promovoi në vitin 2019.

As atëherë dhe as sot, në asnjë dokument nuk ka konsensus dhe nuk ka një përcaktim formal, institucional të dezinformatave. Gjithashtu, një vit më parë (2018) para draft planit të Qeverisë, Komisioni Evropian miratoi Plan Veprimi të BE-së për parandalimin e dezinformatave në të cilin jepet edhe përkufizimi për dezinformatat:

*“Krijimi, prezantimi dhe shpërndarja e informacionit të verifikueshëm të rremë ose informata të gabuara për qëllime përfitimi ekonomik ose për të mashtruar qëllimisht publikun, që mund të shkaktojë dëm publik. Një dëm i tillë mund të përfshijë minimin e proceseve demokratike ose kërcënimet ndaj të mirave publike si shëndeti, mjedisi jetësor dhe siguria.”<sup>71</sup>*

Qeveria, institucionet shtetërore (ministritë) për sa i përket përkufizimit të dezinformatave mbështeten në “kastën e akademikëve profesionistë, mediat dhe organizata të shoqërisë civile”. E vetmja që veçohet është Ministria e Mbrojtjes, e cila në punën e saj udhëhiqet në radhë të parë nga dokumentet strategjike të NATO – Aleancës dhe përkufizimi për dezinformatat si “informacione të krijuara qëllimisht të rreme apo manipuluese që kanë për qëllim të mashtrujë, përkatësisht të vënë në huti publikun kryesor”. Megjithatë, ka disa qëndrime të përfaqësuesve të sektorëve për marrëdhënie me publikun (në ministritë) se çfarë është dezinformatat, shumica e të cilave theksojnë se bëhet fjalë për informacione të rreme, informacione të pasakta, informacione të pavërteta. Për shembull:

- Informacion i rremë, i paverifikuar, deklaram i fakteve të pasakta, informacion i transmetuar në mënyrë jo të plotë. Qëllimi është të manipulohet opinioni publik, pra t'i lërë publikut një ide të gabuar ose të pasaktë për një gjë të caktuar. (ME)
- Informacione të rreme që askush nuk e di se kush qëndron mbrapa tyre. (MSHIA)
- Informata të rreme që kanë për qëllim të mashtrujë dhe të inicojnë reagimin e një grupi/kategorie të caktuar të qytetarëve apo të gjithë publikut dhe në këtë mënyrë të shkaktojnë mosbesim ndaj punës së institucionit/menaxhmentit. (MASH)
- Gjatë punës udhëhiqemi nga faktet. Nëse ndonjë informacion është në kundërshtim me faktet, e konsiderojmë atë dezinformatë, gjysmë të vërtetë, manipulim me publikun. (MK)
- Informacion i rremë, i prodhuar me qëllim arritjen e një qëllimi specifik që mund të dëmtojë institucionin ose shtetin. (MVL)
- Informacion që është i pavërtetë, i paverifikuar dhe i paargumentuar. Kanë për qëllim të vënë në huti popullatën. MSH

70 Shiko më shumë: <https://vlada.mk/node/18640>

71 Shiko: [https://www.eca.europa.eu/lists/ecadocuments/ap20\\_04/ap\\_disinformation\\_en.pdf](https://www.eca.europa.eu/lists/ecadocuments/ap20_04/ap_disinformation_en.pdf)

- Në parim, ne e barazojmë dezinformatën me informacionin e pasaktë me të cilin subjekti që e publikon dëshiron të dëmtojë besueshmërinë e institucionit (MTL)
- Dezinformatat nuk mund të përkufizohet qartë, por mund të njihet. Ato mund të jenë të qëllimshme, të rezultojnë nga informacione dhe hulumtime të pamjaftueshme, keqkuptime, keqinterpretime. (MD)
- Çdo informacion i gabuar që vendoset qëllimisht dhe me vetëdije në publik nga grupe dhe individë, të organizuar ose jo, me qëllim dëmtimin e interesit publik, duke u mohuar qytetarëve të drejtën për të pasur informacion të saktë, në kohë dhe cilësor. Në këtë mënyrë u mohojnë mundësinë për të marrë vendime dhe përfundime të bazuara në fakte. Kjo e cenon drejtpërdrejt besimin e qytetarëve në institucionet, dhe në raste të caktuara paraqet edhe kërcënim për sigurinë e përgjithshme. (Zëdhënësi i Qeverisë)
- Qëllimisht, me paramendim me qëllim politik ose ideologjik, përhapje të informacioneve të rreme ose mashtruese. Një proces me plan, strategji dhe synim për informacione të tilla të pasakta me qëllim cenimin e shtetit ligjor, stabilitetin politik, krijimin e urrejtjes mes njerëzve, uljen e besimit të qytetarëve në arsim, shëndetësi, shkencë. (Kordinator Kombëtar në Qeveri)

Në të njëjtën kohë, theksohet se konsensusi për atë se çfarë është dezinformata duhet të jetë jo vetëm institucional, por edhe social. Prandaj është e nevojshme: *“institucionet, sektori civil, media, publiku profesionist të flasin hapur për thelbin e dezinformatave, ndërkohë që sigurisht duhet të respektohen standardet evropiane dhe ndërkombëtare.”*<sup>72</sup> Dhe ndoshta më e rëndësishmja, ajo që vijon, edhe pse në fazën fillestare, *“krijimi i një Strategjie Kombëtare për shtypjen e dezinformatave, me përfshirjen jo vetëm të qeverisë, por edhe të Kuvendit, Kabinetit të Presidentit të shtetit, sektorit civil”*.<sup>73</sup>

Në të njëjtën kohë, pothuajse nuk ka asnjë institucion (ministri) që të mos jetë përballur me dezinformata gjatë funksionimit, por, sipas përfaqësuesve të marrëdhënieve me publikun, sapo detektohen, reagojnë menjëherë me përgënjeshtime në media, rrjetet sociale dhe ueb faqjen e vetë institucionit. Qasja ndryshon nga institucioni në institucion:

- përmes koordinimit të kabinetit në institucion dhe këshilltarit special për marrëdhënie me publikun (MSHIA)
- në koordinim me Zyrën e kryetarit të Qeverisë dhe Shërbimin Qeveritar për Marrëdhënie me Publikun (MMJ)
- përmes procedurave të brendshme për vërtetimin dhe verifikimin e fakteve dhe sipas autorizimeve për të përcaktuar bashkërisht mënyrën më të mirë të reagimit dhe daljes në publik (MPB),
- duke dërguar informacione në media për demantim të dezinformatës, përkatësisht duke dërguar informacione dhe fakte të sakta (ME)
- përmes shkresës drejtuar mediave (përfshirë rrjetet sociale) dhe publikut ose me një deklaratë nga personat udhëheqës (MASH)
- përmes koordinimit me ekipin e PR-it në institucion, duke u përgjigjur me argumente dhe fakte (MK)
- përmes kontrollit të fakteve, paraqitjes së provave, bashkëpunimit me mediat, informimeve të rregullta me gazetarët, informimit në kohë për të gjitha aktivitetet dhe temat aktuale (MD)

72 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me Zëvendëskryeministrin përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë, zhvilluar në nëntor 2022.

73 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm, Shef i Shërbimit të Komunikimit në Zyrën e Presidentit të RMV-së, realizuar në nëntor 2022.

- përmes koordinimit me institucione të ndryshme dhe persona përgjegjës, në varësi të fushës/problemit me të cilin lidhet dezinformata (MSH)

Në të njëjtën kohë, një numër i caktuar i institucioneve, para së gjithash për shkak të kompetencave të tyre “specifike”, përballen me dezinformim çdo ditë dhe në vazhdimësi. Kështu:

- *Ministria e Arsimit dhe Shkencës* që mbulon një numër të madh qytetarësh (nxënës, studentë, prindër, mësues, punonjës të institucioneve arsimore) “shfaqja dhe krijimi i dezinformatave (kryesisht përmes rrjeteve sociale) përhapet me shpejtësi dhe mbulon një pjesë të madhe të popullsisë. Por Njësia për marrëdhënie me publikun monitoron mediat dhe rrjetet sociale dhe për këtë arsye zbulon shpejt dezinformatat dhe reagon në kohë”.<sup>74</sup>
- *Ministria e Transportit dhe Lidhjeve*, e cila për shkak të kompetencave të saj, “pritet të ketë një sasi të mirë të informatave spekulative që plasohet në publik. “Ekipi për komunikim i Ministrisë gjithmonë reagon në kohë dhe me shpejtësi me fakte të verifikuara dhe të vërtetuara për të parandaluar përhapjen e dezinformatave. Për më tepër, lufta kundër lajmeve të rreme zhvillohet përmes protokollit për komunikim gjatë krizës.”<sup>75</sup>
- *Ministria e Mbrojtjes* e cila vazhdimisht ballafaqohet me dezinformata të natyrës së ndryshme. “Kërkohej vigjilencë dhe shkathtësi e vazhdueshme e sistemit, në radhë të parë për zbulimin e tyre, transmetimin, sistemin e informacionit të brendshëm korrekt dhe marrjen e vendimit për mënyrën e përballjes me dezinformata. Lidhur me reagimin, Ministria udhëhiqet nga Protokollit për Komunikim të Krizave”.<sup>76</sup>

Sa i përket Qeverisë, ajo merret edhe me dezinformata në baza ditore përmes sistemit të krijuar për komunikim në krizë. “Është një sistem përmes të cilit kontrollohen shumë shpejt lajmet e dyshimta dhe nëse janë të rreme, menjëherë përcaktohen mënyrat dhe kanalet e reagimit për të parandaluar përhapjen e mëtejshme. Zyra e zëdhënësit është e përfshirë përmes përgatitjes dhe dhënies së një përgjigje/përgënjeshtimi të arsyetuar që i dërgohet mediave ku është publikuar dezinformata”.<sup>77</sup> Megjithatë, “jo çdo dezinformim demantohet, vendimi merret sipas besueshmërisë së burimit që e publikon në publik, shpejtësisë së përhapjes së tij dhe përmbajtjes së dezinformatave. Pas vlerësimit, çdo dezinformim nuk demantohet, për të mos i dhënë më shumë fuqi plasimi nga sesa ka”.<sup>78</sup> Në esencë:

*“Përgjigja më e mirë për të parandaluar përhapjen e dezinformatave është transparenca maksimale e institucioneve, por kjo nuk do të thotë se kjo mënyrë do të zgjidhë automatikisht problemin me dezinformatat.”<sup>79</sup>*

Këtë e pranojnë qartë edhe vetë institucionet (ministrinë), të cilat rregullisht i referohen llogaridhënies dhe transparencës si një nga mekanizmat kundër spekulimeve dhe dezinformatave.

74 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me një përfaqësues të Njësisë për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, zhvilluar në dhjetor 2022.

75 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me një përfaqësues të Njësisë për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, zhvilluar në dhjetor 2022.

76 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me përfaqësues nga Sektori për Komunikim, Analitikë dhe Mbështetje Operative në Ministrinë e Mbrojtjes, zhvilluar në dhjetor 2022.

77 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me një përfaqësues nga Zyra e Zëdhënësit në Qeverinë e RMV-së, e zhvilluar në dhjetor 2022.

78 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me bashkëpunëtor për komunikime digjitale në Zyrën e kryetarit të Qeverisë, realizuar në dhjetor 2022.

79 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me Zëvendëskryeministrin përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë, zhvilluar në dhjetor 2022.

Edhe Zyra e Presidentit të Shtetit nuk është e kursyer nga dezinformatat, por shumë më pak se për shembull Qeveria, para së gjithash për shkak të kompetencave të kufizuara dhe faktit që “institucioni është një njeri”. Reagimet ndryshojnë nga rasti në rast. Ndonjëherë “qasja ishte më e guximshme, kur Presidenti vendosi t’i përgjigjet drejtpërdrejt disa dezinformatave në një konferencë për shtyp, ne ndonjëherë u përgjigjeni pyetjeve gazetareske, por nuk merrnim iniciativën nëse shihnim se një histori po fillonte të zhvillohej dhe ne të ishim të parët që do të dilnim me një deklaratë dhe të sqarojmë. Në disa shembuj, rezultoi se ishte mirë që me disa dezinformata nuk kemi shkuar në mënyrë frontale për të bërë një histori më të madhe dhe për ta përhapur atë, ndërsa ndonjëherë ka qenë mirë e kundërta. Çështja është komplekse dhe secili rast vlerësohet individualisht”.<sup>80</sup> Përfundimi është se vetë institucioni rrallëherë bëhet cak i dezinformatave.

Në të njëjtën kohë, duket se vetëm Kuvendi i RMV-së mund të “mburret” se pothuajse asnjëherë nuk përballet me dezinformata në punën e tij, ose nëse shfaqen janë “beninjë” dhe reagohet menjëherë. Shpjegimi se pse Kuvendi nuk i nënshtrohet dezinformimit është se “vetë deputetët e përcjellin opsionin e tyre, pra të vërtetën e tyre, që varet se cilës parti politike i përkasin dhe pastaj të tjerët i kundërvihen. Ata kundërshtojnë vetveten, por ky është qëndrimi i tyre dhe jo dezinformim. Një opsion politik do të shfaqet, do të thotë të vërtetën e tij, pastaj do të shfaqet tjetri dhe do të thotë të vetën. Ndërsa ligji është ai që është dhe mund të lexohet”.<sup>81</sup>

Një problem i veçantë përballë dezinformimit të vazhdueshëm është kur ai shfaqet në formën e një “kërcënimi hibrid”.<sup>82</sup> Këtë shteti e përjetoj intensivisht në muajt e fundit të vitit të kaluar, kur çdo ditë vinin raportime të rreme për bomba në shkollat e mesme dhe fillore, transport dhe qendra tregtare, të përcaktuara si shembull klasik i kërcënimeve hibride. Ministria e Punëve të Brendshme thekson “Njësinë me Marrëdhënie me Publikun dhe Njësinë e Krimit Kompjuterik dhe Forenzikës Digjitale si njësi kryesore në luftën kundër këtyre kërcënimeve, natyrisht në bashkëpunim me OSBE-në, EUROPOL-in, INTERPOL-in dhe të gjitha institucionet e tjera të ndërlidhura nga kjo fushë e funksionimit. «<sup>83</sup> Është takuar edhe Qeveria dhe Këshilli i Sigurimit pranë Kabinetit të Presidentit të Shtetit.

Ndërkohë nga Qeveria bëhet e ditur se do të formohet një ekip i ri operativ për sigurinë kibernetike dhe kërcënimet hibride, i cili do të menaxhohet nga Byroja e Sigurisë Publike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.<sup>84</sup> Kështu ka qenë edhe me Propozim planin për veprim vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave, sipas të cilit Qeveria është dashur të krijojë një grup veprimi për përballje me dezinformata me detyrë analizimin dhe monitorimin e dukurive të dezinformatave dhe koordinimin e luftës kundër përhapjes së tyre. Është mbajtur vetëm seanca Konstituive e grupit të punës dhe këtu ka përfunduar e gjithë puna.<sup>85</sup>

80 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm, Shef i Shërbimit të Komunikimit në Zyrën e Presidentit të RMV-së, realizuar në nëntor 2022.

81 Deklaratë nga intervistat e realizuara me përfaqësues të Sektorit për Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e RMV-së, të kryera në dhjetor 2022.

82 Strategjia për ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe ballafaqimin me kërcënimet hibride të Qeverisë së RMV-së nga viti 2021 i referohet kësaj.

83 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me përfaqësues të Sektorit për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e zhvilluar në dhjetor 2022.

84 Do të krijohet një ekip operacional për sigurinë kibernetike dhe kërcënimet hibride, njoftuar më 19.12.2022. <https://fokus.mk/ke-se-formira-operativen-tim-za-sajber-bezbednost-i-hibridni-zakani/>, qasur më 01.02.2023

85 Kreu shtetëror i bashkuar në synimin për lufte vendimtare dhe një qasje të organizuar në përballjen me sulmet e qendrave për dezinformata dhe lajmeve të rreme mbi demokracinë në vendin tonë, publikuar më 09.09.2019, dt. <https://vlada.mk/node/19020?ln=mk>, qasur më 01.02.2023

Sa i përket burimeve të dezinformative, ato vlerësohen si të jashtme dhe të brendshme, dhe qëllimi kryesor është “minimi i demokracisë, duke vepruar kundër europianizimit të vendit, kundër BE-së dhe NATO-s”.<sup>86</sup> Sipas Agjencisë për Kundërzbulim, e cila është përgjegjëse për monitorimin e kërcënimeve hibride nga aktorë të jashtëm me një interes strategjik për praninë në rajon, “dezinformimi vjen drejtpërdrejt nga vendet e treta ose nga transmetuesit ose përfaqësuesit e tyre në rajon”. Dezinformimi është i vështirë për t’u njohur për publikun e gjerë, i cili nuk është gjithmonë i interesuar për burimin e informacionit dhe besueshmërinë e tij. Rrjetet sociale përdoren më së shumti për përhapjen e dezinformative, nga ku më pas shkarkohen për faqet zyrtare të internetit, të ashtuquajturat “trolls” apo “bots”, faqet e internetit apo portalet, si dhe deklaratat e përfaqësuesve zyrtarë<sup>87</sup>. “Si transmetues të dezinformative mund të llogariten edhe partitë politike, strukturat e biznesit, institucionet shtetërore, vetëqeverisja lokale, subjektet e ndryshme të shoqërisë për shkak të interesave personale apo mosnjohjes së çështjes që paraqesin apo lejojnë të plasohen dezinformata. Këtë e mundëson sistemi mediatik, në radhë të parë portalet dhe mediat sociale, sepse nuk ka asnjë rregullim ose njoftim”.<sup>88</sup> Prandaj shtrohet pyetja e kapaciteteve të institucioneve për të parandaluar përhapjen e dezinformative. Shikuar nga thjerrëza e personelit, numrat janë të ndryshëm. Por dominojnë institucionet me vetëm një punonjës (pa njësi të veçantë për marrëdhëniet me publikun)<sup>89</sup>, si dhe institucionet me dy ose tre punonjës (njëri prej të cilëve është udhëheqës)<sup>90</sup>, dhe të pakt janë institucionet me pesë, shtatë, dhjetë ose më shumë persona në Njësinë për Marrëdhënie me Publikun. Tabloja plotësohet me trajnime sporadike për përballje me dezinformata, të organizuara kryesisht në nivel qeveritar, në të cilat marrin pjesë vetëm pjesërisht.

Padyschim që institucionet shtetërore kanë kapacitete të kufizuara institucionale në luftën kundër dezinformimit. Por pothuajse përjashtim bëjnë ata që do ta konfirmojnë “hapur” (si MVL). Arsyet për këtë janë të shumta. Para së gjithash, theksohet se dezinformimi është një instrument i përhapur i tndikimi në marrëdhëniet me publikun, por jo më pak e rëndësishme është mungesa e një analize të rrënjës së problemit dhe kur nuk ka baza, është e vështirë të flitet për mjetet me të cilat mund të luftosh me dezinformatat. Dhe në fund:

*“Ajo betejë drejtohet nga njerëz të njësive për marrëdhënie me publikun, të cilët nuk trajtohen si funksion në institucione (si kontabiliteti apo burimet njerëzore), por si varëse, të cilët më së shumti vijin e shkojnë pasi largohet funksionari që drejton institucionin.”<sup>91</sup>*

Por pavarësisht të gjithave, shumica e përfaqësuesve të institucioneve theksojnë se përmes Njësive për Marrëdhënie me Publikun (edhe pse me një numër minimal punonjësish) i përgjigjen sfidave duke aplikuar Protokollin e Komunikimit të Krizave. Dhe si argument për këtë, ata theksojnë përvojën në punën me media, njohjen e lëndës dhe fushëveprimit të institucionit amë, si dhe faktin se janë gazetarë profesionistë të trajnuar që njohin shpejt dezinformatat dhe përgjigjen iu përgjigjen atyre institucionalisht.

86 Deklaratë nga një intervistë e zhvilluar me një koordinator kombëtar në Qeverinë e RMV-së, realizuar në nëntor 2022.

87 Përgjigje ndaj një pyetësi të dorëzuar në Agjencinë për Kundërzbulim, dhjetor 2022.

88 Deklaratë nga një intervistë e zhvilluar me një koordinator kombëtar në Qeverinë e RMV-së, realizuar në nëntor 2022.

89 Për shembull, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës.

90 Për shembull, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Shëndetësisë.

91 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm, Shef i Shërbimit të Komunikimit në Zyrën e Presidentit të RMV-së, realizuar në nëntor 2022.

Në këtë kontekst, zbatimi i njërës prej masave të sigurisë nga Plani i Propozuar për veprim vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave (nga viti 2019) – Protokollin për komunikimet në krizë ndërmjet shërbimit qendror për komunikim të Qeverisë dhe ministrive, i cili synon shpejt dhe saktë të përballet me dezinformatat, të cilat përhapen nëpër mediat sociale dhe portalet e internetit. Pyetja është se sa u ndihmon ai “mjet” institucioneve në përballjen me dezinformatat përkundër kapaciteteve të tyre të dobëta institucionale. Fatkeqësisht, dokumenti nuk është i disponueshëm publikisht.<sup>92</sup> Nga ana tjetër, një nga institucionet e pakta që bie në sy me kapacitetet e saj në këtë “betejë” është Ministria e Mbrojtjes. Aktivitetet janë në kuadër të Sektorit për Komunikim, Analitikë dhe Mbështetje Operative (i përbërë nga pesë njësi) ku konceptualisht zhvillohen tre lloje funksionesh – parandaluese, proaktive dhe reaktive. “Ai proaktiv bazohet në zbulimin e hershëm të dezinformatave të mundshme (të ashtuquajturat pre-debunking) dhe parandalimin e tyre me dukshmëri të shtuar të informacionit faktikisht të saktë në fushën e detektuar, si dhe informacion më të gjerë të audiencës kryesore të detektuar për tema me interes për mbrojtjen dhe NATO – Aleanca. Reaktive është procesi i reagimit të shpejtë ndaj dezinformatave në hapësirën e informacionit nëpërmjet monitorimit të duhur, transmetimit të tyre në sistem dhe reagimit të shpejtë, në kohë dhe të duhur. Dhe ajo parandaluese është Qendra Rajonale për Marrëdhënie me Publikun për Trajnim dhe Edukim, e cila së fundi ka zhvilluar kursin e parë për trajtimin e dezinformatave dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë me pjesëmarrjen e komunikuesve të qeverisë”.<sup>93</sup>

Në të njëjtën kohë, vazhdimisht insistohet që institucionet të përgjigjen me masa proaktive dhe reaktive, si dhe të përmirësohen kapacitetet ekzistuese me trajnime. Kjo kundërshtohet nga qëndrimi se deri më tani nuk kishte një strukturë formale ose së paku koordinuese që do të merrej me masat parandaluese për ballafaqim me dezinformata. Domethënë, “Momentalisht jemi duke punuar për krijimin e tij dhe jemi në fazën e konsultimit mes institucioneve. Padyshim që kapacitetet e institucioneve do të duhet të përmirësohen sipas shkallës së kërcënimit të dezinformatave, veçanërisht duke pasur parasysh kërcënimet e sigurisë, por e lëmë të lindë natyrshëm sipas nevojave, kapaciteteve aktuale, përvojat e NATO-s dhe vendet tjera të BE-së, drejtimi i zhvillimit që duhet të arrihet”.<sup>94</sup> Prandaj konkluzioni se:

*“Kapacitetet duhet të përmirësohen vazhdimisht, institucionet duhet të investojnë në shërbimet e tyre të komunikimit, jo vetëm PR promovionale, por edhe PR që nënkupton përgjegjësi, transparencë dhe llogaridhënie, përkatësisht vazhdimisht të gatshëm për t’iu përgjigjur nevojave të medias, publikut, grupeve të ndryshme të synuara..”<sup>95</sup>*

Transparenca, përkatësisht, “transparenca aktive” e vendosur lart në agjendën e institucioneve të pushtetit qendror, realizohet ngadalë dhe në mënyrë të pabarabartë, si në planin ligjor ashtu edhe në planin e veprimit, si dhe në mungesë të koordinimit ndërinstytucional të masave që lidhen me rritjen e transparencës. Prandaj nevoja për një qasje sistematike që do të mbulojë të gjitha nivelet e qeverisjes,

92 I njëjti Protokoll për Komunikimin e Krizave është pjesë përbërëse e programit të Qeverisë “Aksioni 21 – për standardet evropiane në vend” për vitin 2021, i prezantuar publikisht në dhjetor 2020, me indikacion se është zhvilluar një Protokoll për Komunikim në Kriza. Shiko: <https://vlada.mk/search/node/%D0%9F%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%BE%D0%BA%D0%BE%D0%BB%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BA%D1%80%D0%B8%D0%B7%D0%BD%D0%B8%20%D0%BA%D0%BE%D0%BC%D1%83%D0%BD%D0%B8%D0%BA%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%B8%20language%3Amk%2Cund>

93 Deklaratë nga intervista e zhvilluar me përfaqësues nga Sektori për Komunikim, Analitikë dhe Mbështetje Operative në Ministrinë e Mbrojtjes, zhvilluar në dhjetor 2022.

94 Deklaratë nga intervista e realizuar me përfaqësuesin – sekretar për komunikim dhe politika publike në Zyrën e Kryetarit të Qeverisë, e realizuar në dhjetor 2022.

95 Deklaratë nga një intervistë e zhvilluar me përfaqësues koordinitor kombëtar në Qeverinë e RMV-së, realizuar në nëntor 2022.



si dhe segmentet e tjera të shoqërisë. Në të njëjtën kohë, beteja me dezinformatat, në mungesë të një përkufizimi të harmonizuar në institucionet shtetërore, i lë hapësirë secilit dikaster që t'i qaset veçmas interpretimit të tyre. Kjo potencialisht ndikon në efektivitetin e përbaljes me dezinformatat. Kjo ndërli-dhet me kapacitetet e dobëta institucionale, ekipimi kadrovik dhe mungesa e trajnimit të sektorëve për marrëdhënie me publikun për përbalje me dezinformatat që po përhapen vazhdimisht dhe po minojnë demokracinë.

# Mediat dhe gazetarët janë në një udhëkryq mes transparencës së institucioneve dhe rritjes së dezinformatave

## 05

**T**ransparenca ose hapja në qeverisje është një kusht sine qua non në demokraci. “Qeveria duhet të jetë plotësisht transparente në procesin e saj të vendimmarrjes, si dhe në zbatimin e ligjeve dhe politikave që duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe rregulloret e qeverisjes së mirë”. (Ali, Muhammad, 2015:72). Në të njëjtën kohë, të gjitha informacionet duhet të jenë lehtësisht të qasshme dhe të kuptueshme për mediat dhe qytetarët. Në këtë proces, media ka rol të veçantë si një burim i rëndësishëm informacioni nga qeveria për qytetarët dhe nga qytetarët për qeverinë, por në të njëjtën kohë një faktor në luftën kundër dezinformatave dhe manipulimeve. Prandaj shtrohet pyetja, sa mund të kontribuojnë sot, përballë një “pushtimi” të vërtetë të dezinformatave, në betejën me këtë “të keqe” që cenon demokracinë, qeveria e hapur nga njëra anë dhe media nga ana tjetër.

### **Për transparencën e pushtetit qendror**

E parë përmes “lupës” mediatike, hapja e pushtetit qendror është larg nivelit të dëshiruar. Perceptimi i gazetarëve (si nga mediat elektronike ashtu edhe ato të shkruara), i ndërtuar nga përvoja e menjëherëshme në “fushë”, nxitet nga pikëpamja se institucionet janë të mbyllura (sidomos Qeveria dhe ministritë, si dhe vetëqeverisja lokale, komunat), më rrallë se janë relativisht transparente, por transparencja e tyre formale është apostrofuar, madje përmendet e ashtuquajtura “Transparenca e Piarit”. Në të kundërt, hulumtimi “Indeksi i transparencës aktive – 2022” vëren se Qeveria dhe ministritë kanë 85%, dhe veçmas

Qeveria dhe Ministria e Mbrojtjes kanë maksimum 100%, pra publikojnë të gjitha informacionet e parapara nga transparenca aktive.<sup>96</sup>

Prandaj argumentimi i gazetarëve për qëndrimin e tyre kritik ndaj transparencës së institucioneve të pushtetit qendror duket thelbësor. Ata sqarojnë në detaje qëndrimet dhe vërejtjet për transparencën e institucioneve shtetërore. Së pari, nuk mund të thuhet se institucionet nuk janë transparente. Ata janë të hapur për gazetarët si formalisht ashtu edhe teknikisht në kuptimin që mund t'i thërrasin për të kërkuar informacione për një temë apo çështje të caktuar. Kjo nuk është aspak e diskutueshme. Por është më thelbësore, përkatësisht:

*“Treguesi më i mirë i transparencës janë përgjigjet që marrim nga institucionet për pyetjet e kërkuara. Nëse marr përgjigjet përkatëse, përgjigjet që kërkoj, kjo do të thotë se ato janë transparente. Mirëpo, shpesh ndodh që kur institucionet nuk përgjigjen, pyetjeve nuk u jepet përgjigje, të mos marrim përgjigje përkatëse dhe ato të jenë vetëm formalisht-ligjore ose teknikisht transparente..”<sup>97</sup>*

Në të njëjtën kohë, transparenca dështon jo kur bëhet fjalë për gazetarinë e përditshme, por mbi të gjitha kur një çështje e caktuar përpunohet tematikisht, mediatikisht analitikisht. “Një lloj përgjigjeje (kryesisht teknike) për pyetjet gazetareske merret në një kohë relativisht të mirë, por sa e mbulon thelbin e problemit ndryshon nga institucioni në institucion. Cilësia e informacionit të marrë nga ai komunikim është kryesor. Është transparenca relative, kështu funksionojmë ne, pranojmë atë që është në dispozicion që të kemi ndonjë tekst,”<sup>98</sup> megjithëse shumë shpesh këto janë përgjigje të kufizuara institucionalisht, të dobëta dhe të orientuara drejt shërbimit, praktikisht përgjigje që nuk përmbajnë asgjë. Gazetarët madje e konsiderojnë veten se po “aktrojnë” transparenca:

*“Do të dërgojnë zyrtarisht një përgjigje, por nuk është një përgjigje për pyetjen e bërë, por pjesë nga njoftimet për shtyp që tashmë janë dërguar në media, diçka tashmë e publikuar në faqen e tyre, një citat nga ligji, madje të mësojnë çfarë duhet të kishit pyetur në fakt.”<sup>99</sup>*

Në të njëjtën kohë theksojnë se pushteti qendror në situata të ndryshme ka qasje të ndryshme, njëherë është transparente, pastaj jo. Gazetarët tregojnë si shembull transparenca “Ministrinë e Shëndetësisë gjatë krizës së Covid-it, sot në krizën aktuale ekonomike dhe energjetike, Ministrinë e Ekonomisë, ndërsa më jo transparente është Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, ku tekstualisht nuk ka përgjigje për asnjë pyetje gazetareske.<sup>100</sup> Sipas tyre, janë të shumta situatat në të cilat po bëhet një betejë me institucionet shtetërore për marrjen e informacionit të kërkuar. Kur bëhet fjalë për informacione të thjeshta, është më lehtë të merren përgjigje, por kur gërmohet në funksionimin e institucioneve (për shembull, informacion për tarifën për këshilltarët në ministri), atëherë informacioni është më i vështirë për t'u marrë. Në thelb, “beteja e përvetshme e muskujve dhe kondicionit”. Nuk janë të rrallë shembujt, kur gazetarët kërkojnë informacion për një çështje të caktuar nga institucionet kompetente (ministrinë), ata nuk përgjigjen, por të nesërmen dërgojnë një komunikatë për mediat për të njëjtën çështje.

Problem i veçantë për gazetarët është kur në “skenën publike” zhvillohen aktivitete të llojit të pasimit të topit, pra “transferimi i autoritetit nga njëri te tjetri apo një institucion i tretë për informacionin e kërku-

96 Shiko më shumë: Indeksi i Transparencës Aktive – 2022, Qendra për Komunikim Qytetar, <https://www.ccc.org.mk/images/stories/akt22.pdf>

97 Deklaratë e një gazetari nga media online në fokus grup të zhvilluar më 10.11.2022.

98 Deklaratë e një gazetari të një gazete ditore nga fokus grup i realizuar më 11.11.2022.

99 Deklaratë e një gazetari nga media online në fokus grup të zhvilluar më 10.11.2022.

100 Deklaratë e një gazetari të një gazete ditore nga fokus grup i realizuar më 11.11.2022.

ar”, por edhe referimi në “ derë të gabuar“ “zvarritje me përgjigjen”, mbi të gjitha, për ta marrë në kohë që përgjigja të mos dëmtojë askënd, madje edhe “heshtje nga institucionet”. Në të njëjtën kohë, pavarësisht nëse çështja është e thjeshtë apo më komplekse, “çdo gjë që pengon integritetin personal”, në çdo temë ku ekziston dyshimi për konflikt interesi, për ndonjë interes personal të një funksionari, atëherë gazetarët kanë një problem serioz. Në të kundërt:

*“A është transparencë kur ndiqet çdo hap i asaj që ka bërë funksionari gjatë ditës, pavarësisht nëse ka ndonjë vlerë informative apo jo. Në atë mënyrë, vërtet prodhojnë shumë material dhe kjo mund t’i bëjë transparent sipas disa kritereve, por i synojnë atë që ju përgjigjet atyre.”<sup>101</sup>*

Në atë drejtim dhe propozimi i tyre, përveç emaileve dhe fotove të shumta që u dërgohen mediave nga evente të ndryshme në të cilat marrin pjesë funksionarë, pse të mos dërgohen për shembull informacione (me link) për një raport, vendim, analizë të caktuar dhe ngjashëm të publikuar/a në faqen e institucionit, të cilat mediat do të mund t’i lexojnë dhe informojnë publikun. “Në këtë mënyrë do të jenë plotësisht transparente, jo vetëm PR”.<sup>102</sup>

Kjo pasohet nga pyetja për *konferencat për shtyp*, si një nga mjetet e transparencës. Gazetarët besojnë se ofrojnë informacione për tema të shumta aktuale dhe pyetje rreth aktiviteteve të Qeverisë, ministrive, institucioneve shtetërore, por nuk kanë asnjë rëndësi për ata që nuk punojnë në gazetari të përditshme. Më së shumti fokusohen në temën për të cilën është thirrur dhe organizuar konferenca për shtyp dhe shumë rrallë “lejojnë” pyetje për tema të tjera. Edhe kur gazetarët kanë paralajmëruar pyetje në lidhje me konferencën për shtyp, përgjigja që ata marrin është zakonisht në një formë të përgjithshme (pa detaje, të dhëna, vendime, të nevojshme për “historinë” e tyre). As konferencat për shtyp të qeverisë nuk mjaftojnë për të përcjellë informacion cilësor të qytetarët, sepse një njoftim publik përgatitet paraprakisht dhe nuk anon nga tema e synuar. Madje konsiderojnë se janë “të papërdorshme” sepse menjëherë pas seancës së Qeverisë, në orët e mbrëmjes dërgohet një komunikatë për media, ndërsa të nesërmen e njëjta komunikatë do t’u lexohet gazetarëve të cilët presin të bëjnë pyetje për gjithçka, përveç temën për të cilën u thirr konferenca dhe përgjigjet konsistojnë në dy-tri fjali të përmbledhura. Në esencë:

*“Gjithçka konsiston në atë se sa të hapura janë institucionet, sepse nëse nuk duan t’i përgjigjen një pyetjeje, nuk do t’i përgjigjen as në një konferencë për shtyp. Gjithmonë mund të përdorin ndonjë justifikim, se do të kontrollojnë, do të telefonojnë, se nuk janë të sigurt, etj.”<sup>103</sup>*

Një pjesë e pazëvendësueshme e këtij zinxhiri komunikimi janë *zëdhënësit*. Sipas gazetarëve, ata janë zëdhënës të institucioneve shtetërore, por sikur nuk janë. “Ata kërkojnë që për çdo gjë t’u dërgohet një email, madje edhe atëherë do t’u përgjigjen tre nga pesë pyetjeve, gjë që lë dyshime se sa janë të njohur me punën e institucionit ku punojnë prej shumë vitesh. “ Nuk është gjithmonë e nevojshme që ministri të bëjë deklaratë nëse ka zëdhënës, por “zëdhënësi nuk mund t’i përgjigjet pyetjes tuaj nëse ministri apo drejtori nuk e sheh përgjigjen”.<sup>104</sup>

101 Deklaratë e një gazetari nga media online në fokus grup të zhvilluar më 10.11.2022.

102 Deklarata e një gazetari të online medias nga fokus grupe.

103 Dëshmi e një radio gazetari nga fokus grup, realizuar më 11.11.2022.

104 Deklaratë e një gazetari radioje dhe gazetari nga media online nga fokus grupet e mbajtura më 10.11 dhe 11.12.2022.

*“Në ditët e sotme kur informacione ndodhin çdo sekondë, çdo minutë, nuk mund të kërkosh përgjigje nga një institucion ku përgjigja është PO dhe JO, dhe zëdhënësi të thotë të presësh që pyetja të dërgohet tek shërbimet në mënyrë që ata të mund të ju përgjigjen.”<sup>105</sup>*

Kjo qasje e vështirëson punën e gazetarëve, informacioni ndryshon përditë, nëse nuk ka përgjigje për lajmet nga institucionet, “ka kaluar afati”, zëvendësohet me një tjetër nesër. Sigurisht, ka përjashtime dhe shembuj që mbahen mend dhe ritregohen, si për shembull. *Në karrierën time nuk kam takuar kurrë një përkushtim të tillë nga një zëdhënës i një institucioni. Madje edhe të thoni mirë, faleminderit kam informacione, mjafton.*<sup>106</sup>

Në të njëjtën kohë, puna e fotoreporterëve mediatik është e vështirë dhe e rrezikuar. Gazetarët theksojnë se përveç zëdhënësve, institucionet shtetërore kanë edhe fotoreporterët dhe incizuesit e tyre (në radhë të parë Qeveria) të cilët çdo ditë i dërgojnë mediave, pa pagesë, foto galeri dhe inserte nga ngjarje të ndryshme. Sipas tyre, numri i zëdhënësve dhe i përgjegjësve për informim është i mjaftueshëm, “i shohim, ekzistojnë, por sikur janë më të angazhuar në shërbim të institucionit, ministrit, drejtorit, daljes së tyre në televizion, madje incizimin e emisionit dhe çfarë tu përcjellin nga intervista mediave të tjera, kurse për ne nuk kanë kohë të mjaftueshme për atë që duam të marrim si informacion nga konferencat për shtyp”.<sup>107</sup>

Një tregues i transparencës së institucioneve të pushtetit qendror sigurisht se janë *ueb faqet* e tyre. Ato ofrojnë informacione shërbimi, aktivitete të institucionit, galeri ngjarjesh, kontakte. Ato ndihmojnë në punën e gazetarëve, por nuk mund të mbështeten vetëm në ta. Në të njëjtën kohë, problemi nuk është vetëm mënyra se si janë organizuar faqet, por edhe mbrojtja dhe përditësimi i tyre. Në vend të një qasjeje të lehtë dhe të thjeshtë, jo vetëm për gazetarët, por edhe për qytetarët, ofrohen të dhëna, të cilat shpesh janë pothuajse të pamundura për t’u përdorur, si p.sh. “organogramet e institucioneve që kërkojnë një milion klikime për të kërkuar informacion specifik”, ose “të dhëna për përdorimin e të cilave nevojiten udhëzime për të arritur tek informacioni i kërkuar, edhe pse ai është publikuar shumë më herët, kështu duke humbur kohë të çmuar”.<sup>108</sup> Vërejnë kur:

*“Prej muajsh është hakuar kanali bazë i komunikimit të institucioneve, kështu kur nuk kemi faqe të sigurt të institucioneve shtetërore ku gazetarët dhe qytetarët mund të marrin informacion dhe askush nuk jep përgjigje për këtë.”<sup>109</sup>*

Së fundi, një element kyç në promovimin e transparencës së institucioneve është gjithashtu *qasja falas në informacion*. Gazetarët e përdorin shpesh këtë vegëz, veçanërisht ata që bëjnë gazetari investigative dhe përvojat e tyre janë të ndryshme. Sipas tyre, mekanizmi është efektiv dhe joefektiv. Ka raste kur institucionet janë përgjigjur brenda afatit të përcaktuar me ligj, raste kur kanë pritur më shumë se ç’ duhej, por edhe kur pa shpjegime nuk është marrë përgjigje. Ata theksojnë se jo vetëm gazetarët, por edhe qytetarët duhet të kenë qasje në informacionin publik. “Nëse është e vështirë dhe e komplikuar për ne gazetarët të marrim informacione të tilla, atëherë nuk bëhet fjalë për qytetarët”... “është teknikisht një vegëz delikate që kërkon një kërkesë të shkruar me shumë mjeshtëri dhe saktësi që të jetë e pranuar,”<sup>110</sup> për të cilat ata shpesh përdorin ndihmën e njerëzve në Komisionin për qasje të lirë në informacion. Por edhe kur “shkruajmë konkretisht atë që kërkojmë, si për shembull emrin e dokumentit dhe datën e lëshimit, për të cilat

105 Deklaratë e një gazetari nga media online në fokus grup të zhvilluar më 10.11.2022.

106 Deklaratë e një gazetari nga media online për Qendrën për Menaxhim me Kriza nga fokus grup i zhvilluar më 10.11.2022.

107 Deklaratë e një gazetari nga media online në fokus grup të realizuar më 10.11.2022.

108 Deklaratë e një gazetari nga media online dhe një gazete javore nga fokus grupet e realizuar më 10.11 dhe 11.11.2022.

109 Dëshmia e një gazetari televiziv nga fokus grup i mbajtur më 10.11.2022.

110 Dëshmi e gazetarëve televizivë nga një fokus grup i mbajtur më 10.11.2022.

do të duhej vetëm hapja e një sirtari dhe nxjerrja e tij, përdoret afati prej njëzet ditësh që të na përgjigjet institucioni”.<sup>111</sup>

Në përgjithësi, gazetarët e vlerësojnë transparencën e institucioneve të pushtetit qendror, para së gjithash, si formale-juridike dhe teknike, shpesh të lidhura me PR. Sipas tyre, institucionet nuk janë të hapura nëse ndiqet “çdo hap” i zyrtarit dhe nga kjo prodhohet një material i madh, por kur një çështje apo problem trajtohet gazetarisht- tematikisht, këtu kemi shmangie të shpeshta. Për gazetarët, qeveria transparente nuk është ajo me njoftime, foto, inserte të përditshme, është thjesht një PR i mirë. Konferencat për shtyp (sidomos ato të Qeverisë) i konsiderojnë formale dhe jofunksionale, me njoftime që gazetarët i kanë marrë paraprakisht dhe rrallë marrin përgjigje për pyetje të tjera. Prandaj dilema për rolin e zëdhënësve, të cilët rrallë përgjigjen me gojë, duke kërkuar që pyetjet t’u dërgohen me shkrim për t’u konsultuar me autoritetet. Sipas gazetarëve, ueb faqet janë informative, me informacione shërbimi, galeri ngjarjesh, informacione teknike për qytetarët, si dhe informacione për punën e institucionit (vendime, zgjidhje, ligje, protokolle, rregullore...) shpeshherë u duhen. “udhëzime për përdorim”. Vegëza për qasje të lirë në informacione të natyrës publike përkufizohet si “teknikisht delikate”, e cila, mbi të gjitha, kërkon një kërkesë të shkruar me aftësi dhe me shkrim të saktë, që e vështirëson punën veçanërisht për gazetarët e angazhuar në gazetarinë investigative.

## Një vështrim i afërt i një gazetari ndaj dezinformatave

Ka pasur gjithmonë dezinformata, ka dhe ndoshta do të ketë edhe në të ardhmen. Në të kaluarën flitej për propagandë, pastaj për informacione apo lajme të rreme, kurse në gazetari për “rosën gazetareske”. Sigurisht, ka dallime midis tyre. Sot flasim për dezinformata me të cilat gazetarët ndeshen çdo ditë dhe në mungesë të një përkufizimi të vetëm koherent, gazetarët në Maqedoni thjesht vërejnë se këto janë “Informacione dhe lajme të rreme, të pasakta dhe të pavërteta”. Gjatë kësaj, ndoshta është më e rëndësishme se si t’i njohin, si të sillen me ta në mbrojtje të profesionit të tyre. Dhe beteja nuk është e lehtë në vërshimin e një sasive të madhe informacioni dhe po ashtu të njëjtit numër mediash dhe “informatoresh” të ndryshëm. Këtu është rreziku i auto-censurës, e cila nga ana e saj është një rrezik edhe më i madh për dinjitetin e gazetarisë, e cila tashmë po vuan nga një reputacion i keq. Nga ana tjetër, publiku mat gjithnjë e më shumë, njeh se cilat media janë “relevante” dhe ofrojnë informacione të sakta dhe të verifikuara dhe cilat janë “të dyshimta” dhe gënjeshtër, të pavërteta dhe manipulime në treg.

Një aspekt kyç i qasjes evropiane është zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për luftë kundër dezinformatave. Në vitin 2018, BE-ja publikoi një komunikatë për përballje me dezinformatat në internet, duke përshkruar strategji për përballje me dezinformatat. Ai është i fokusuar në dezinformimin online, vendos parime dhe synime, të cilat duhen ndjekur për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe për të trajtuar në mënyrë efektive dezinformimin. Komunikata parashikon gjithashtu masa të veçanta që do të merren nga Komisioni Evropian. Dokumenti paraqet një koleksion mjetesh për parandalim të përhapjes së dezinformatave dhe mbrojtjen e vlerave të BE-së, të cilat përfshijnë masa si rritja e transparencës së reklamave politike në internet, forcimi i edukimit mediatic dhe inkurajimi i diskursit publik të bazuar në fakte (KE, 2018a).

### **Plan veprimi kundër dezinformatave**

Ky dokument synon të forcojë aftësinë dhe bashkëpunimin në BE në luftën kundër dezinformatave. Në të theksohet se lufta kundër dezinformatave kërkon angazhim politik dhe veprim të bashkuar nga të gjitha pjesët përkatëse të qeverive kombëtare, duke përfshirë organet qeveritare që merren me kërcënimet hibride, sigurinë kibernetike, inteligjencën dhe komunikimet strategjike, mbrojtjen e të dhënave, menaxhimin e zgjedhjeve, zbatimin e ligjit dhe mediatic. Një veprim i tillë është planifikuar të kryhet në bashkëpunim me partnerët globalë, institucionet e BE-së, shtetet anëtare, sektorët civilë dhe privatë, veçanërisht platformat online. Plani i veprimit ka katër shtylla për të parandaluar dezinformatat: (1) Përmirësimi i aftësive të institucioneve të BE-së për detektim, analizim dhe zbulim të dezinformatave. (2) Forcimi i koordinimit

dhe reagimi i përbashkët kundër dezinformatave. (3) Mobilizimi i sektorit privat për përbashkjen me dezinformimin. (4) Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë së shoqërisë. Plani i veprimit tregon nevojën për bashkëpunim me tre rajone fqinje: Ballkanin Perëndimor, fqinjët lindorë dhe jugorë të Bashkimit. Për këtë qëllim, Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm krijoi grupe të përshtatshme pune për komunikim strategjik me tre rajonet fqinje. Në këtë kontekst, BE-së është e interesuar ekskluzivisht për dezinformatat që kanë dimension gjeo-politik, për të parandaluar ndikimin rus në këto rajone.

## Plani Veprimi Evropian për Demokraci

Dokumenti jep udhëzime mbi detyrimet dhe llogaridhënien e platformave online në luftën kundër dezinformatave. Ai është i fokusuar në tre fusha. Në të parën, mbrojtjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, theksohet se mediat sociale janë pjesë e kanaleve të manipulimit të opinionit publik dhe se ka përpjekje të dokumentuara për prishjen e procesit zgjedhor nga qeveritë e huaja. Në këtë drejtim, Plani i Veprimit propozon disa masa:<sup>125</sup> miratimi i legjislacionit për transparencë më të madhe të reklamave politike, rishikimi i rregullores për financimin e partive politike evropiane, krijimi i një mekanizmi të përbashkët për vendosjen e ekipeve të ekspertëve që do të punonin për parandalimin e kërcënimeve kibernetike ndaj procesit zgjedhor dhe promovimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe delirberative (këshillimore).

E dyta, për forcimin e lirive të medias, parashikon disa masa dhe rekomandime: (1) Mbrojtja e sigurisë së gazetarëve, duke marrë parasysh kërcënimet ndaj gazetarëve, veçanërisht ndaj gazetarëve femra, si dhe nevojën për financim të qëndrueshëm të projekteve me fokus në asistencën ligjore dhe ndihmë tjetër për gazetarët në BE dhe më gjerë. Në bazë të kësaj mase, KE ka përgatitur një Rekomandim për mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve.<sup>126</sup> (2) Lufta kundër keqpërdorimit të mundësisë për fillimin e procedurës gjyqësore kundër gazetarëve dhe personave të përfshirë në mbrojtjen e interesit publik. Ky abuzim quhet Padi Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (Strategic lawsuits against public participation - SLAPPs) dhe paraqet një formë të veçantë ngacmimi, ndërsa mbështetet në procese gjyqësore të pabaza ose të tepruara, të cilat zakonisht inician nga autoritetet shtetërore, kompani të fuqishme ose individë të fuqishëm. Masa tashmë është shndërruar në një projekt-direktivë të BE-së.<sup>127</sup> (3) Vendosija dhe zbatimi i standardeve profesionale gazetareske dhe mediatike duke promovuar vetë-rregullimin dhe fuqizimin e organeve të vetë-rregullimit mediatik. (4) Forcimi i pluralizmit mediatik dhe transparencës së pronësisë mediatike. Një funksion i kësaj mase është edhe Direktiva e re, e rishikuar për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD). Plani i veprimit gjithashtu parashikon masa për shpërndarje transparente dhe të drejtë të reklamave shtetërore. E treta, për parandalimin e dezinformatave, specifikon disa dallime terminologjike ndërmjet termave: (1) Dezinformim (disinformation), si përmbajtje e pasaktë me qëllime të dëmshme. (2) Informacione të shtrembëruara (misinformation), si përmbajtje të pasaktë pa qëllime të këqija. (3) Aktivitete për informacione taktike nga aktorë vendas ose të huaj (information influence operations) që përdorin mashtrimin për të ndikuar në një audiencë të caktuar të synuar. (4) Ndërhyrja e huaj në hapësirën informative, më së shpeshti si pjesë e një operacioni më të gjerë hibrid.

125 Shiko: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=COM%3A2020%3A790%3AFIN&qid=1607079662423>

126 Shiko: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/recommendation-protection-safety-and-empowerment-journalists>

127 Shiko: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0177&from=EN>

# Kodi i Sjelljes kundër dezinformatave i vitit 2022<sup>128</sup>

Ky dokument është një version i ri, i përmirësuar i Kodit të mëparshëm nga viti 2018, i cili është shembulli i parë në botë, ku industria (platformat online) pranon vullnetarisht të vendosë standarde për vetë-rregullim kundër dezinformatave. Kodi u bën thirrje kompanive të teknologjisë të ndërmarrin hapa për përballje me dezinformatat në platformat e tyre. Kodi i vitit 2022 synon të përmbushë objektivat e përcaktuara nga Komunikata e KE-së e prillit 2018 dhe mbështetet në parimin e vetë-rregullimit dhe parashikon detyrimet që nënshkruetit i marrin përsipër vullnetarisht. Ai u miratua nga platforma të mëdha online, platforma të specializuara, subjekte nga industria e reklamave, organizata hulumtuese dhe organizata të shoqërisë civile, bazuar në udhëzimet e KE-së nga maji 2021, të cilat vendosin një gamë më të gjerë detyrimesh dhe masash për luftë kundër dezinformatave. Sipas parimit të vetë-rregullimit, Kodi është rezultat i nënshkruesve të cilët zgjedhin vullnetarisht se cilin nga detyrimet e parashikuara do të pranojnë dhe janë përgjegjës për zbatimin efektiv të tyre. Ata marrin përsipër të ndërmarrin veprime specifike në disa fusha, si:

- Demonetizimi i shpërndarjes së dezinformatave
- Transparenca e reklamave politike
- Sigurimi i integritetit të shërbimeve online me aktivitete për forcimin e masave për reduktimin dhe sjelljen manipuluese për përhapjen e dezinformatave.
- Fuqizimi i përdoruesve të përmbajtjeve me iniciativa për edukimin mediatik
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet kontrolluesve të fakteve (fact-checkers)
- Mundësimi i qasjes më të mirë në të dhëna për nevojat e studiuësve
- Hapja e Qendrës për Transparençë dhe e një grupi të përhershëm pune.<sup>129</sup>
- Forcimi i Kornizës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit në BE dhe në nivel të vendeve - anëtare<sup>130</sup>

Kodi duhet të jetë pjesë e një kuadri më të gjerë rregullator, në lidhje me legjislacionin për Transparençën dhe Synimin e Reklamave Politike dhe Aktin për Shërbime Digjitale (DSA).

## Ligji për shërbime digjitale

Ligji për shërbime digjitale trajton problemin me dezinformatat në disa nene (nenet 63, 68, 69, 71),<sup>131</sup> Qëllimi i tij është të mbrojë përdoruesit e internetit duke vendosur një standard të ri për funksionimin transparent të platformave online. Kërkon që kërkuesit e lajmeve, rrjetet sociale dhe online tregjet të jenë përgjegjës për menaxhimin e përmbajtjes së tyre. Më konkretisht, duhet të mundësojë kompanitë e mëdha si Google, Meta, (Facebook) dhe Twitter të mbajnë përgjegjësi për përmbajtje të dëmshme ose

128 Shiko: The Strengthened Code of Practice on Disinformation 2022

<https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/2022-strengthened-code-practice-disinformation>

129 Qendra duhet të jetë e hapur për të gjithë qytetarët, të ofrojë një pasqyrë më të mirë të zbatimit të Kodit dhe të ofrojë njoftime të rregullta. Grupi i punës duhet të krijojë një forum për rishikimin dhe përshtatjen e detyrimeve, sipas ndryshimeve teknologjike, tendencave sociale, të tregut dhe legjislative.

130 Kuadri ka gjithashtu Treguesit e Nivelit të Shërbimit (Service Level Indicators) që matin zbatimin e Kodit. Parashikohet gjithashtu zhvillimi i treguesve strukturorë që do të matin ndikimin e përgjithshëm të Kodit në parandalimin e dezinformatave.

131 Shiko: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020PC0825&from=en>

të paligjshme. Gjithashtu, Akti kërkon që platformat online të ndajnë informacione rreth funksionimit të algoritmeve të tyre, të heqin shpejt përmbajtjen e paligjshme dhe të dëmshme dhe të parandalojnë përdoruesit që përhapin informata të shtrembëruara (misinformation).<sup>132</sup>

Akti konsiderohet një triumf politik për BE-në, në përpjekjet e saj për t'i bërë “platformat shumë të mëdha” përgjegjëse për moderimin e përmbajtjeve që shkaktojnë dezinformata. Termi “platforma shumë të mëdha” i referohet platformave që arrijnë 45 milionë ndjekës ose rreth 10% të popullsisë së BE-së. Ligji parashikon që secili prej vendeve anëtare të BE-së të caktojë një Koordinator për Shërbime Digjitale (Digital Services Coordinator) si rregullator i cili është i pavarur, kompetent dhe i paanshëm. Koordinatorët për shërbime digjitale të të gjitha vendeve anëtare të BE-së do të bashkëpunojnë në kuadrin e një grupi të pavarur këshillues, të quajtur Bordi Evropian për Shërbime Digjitale (European Board for Digital Services).

Akti për shërbime digjitale dhe Akti i ri për Tregun digjital (DMA) janë kuadri i ri ligjor i BE-së për një hapësirë digjitale evropiane më të sigurt dhe të unifikuar.

## Akti Evropian për lirinë e medias

Në shtator 2022, KE-ja paraqiti propozim për një Akt Evropian për lirinë e medias (European Media Freedom Act), si një grup rregullash të reja për mbrojtjen e pluralizmit dhe pavarësisë mediatike në BE.<sup>133</sup> Dokumenti parasheh masa për mbrojtje nga presioni politik në liritë editoriale dhe mbikëqyrjen e gazetarëve. Ai fokusohet në financimin e pavarur/të qëndrueshëm të shërbimit radiodifuziv publik dhe transparencën në shpërndarjen e fondeve për reklamat shtetërore, si dhe pronësinë e medias. Dokumenti parashikon masa për mbrojtjen e pavarësisë së redaktorëve dhe publikimin e konfliktit të interesit, si dhe mbrojtjen e përmbajtjes online në platformat mediatike. Ai duhet tu mundësojë mediave (private dhe publike) të operojë shumë më lehtë përtej kufijve të vendeve anëtare të BE-së, përkatësisht në kushtet e një tregu të vetëm mediatik evropian.

Propozim rregullativa parashikon krijimin e një organi të ri rregullator – Bordi Evropian për Shërbime Mediatike (EBMS), i cili do të përfshijë rregullatorë kombëtarë të medias nga vendet anëtare të Unionit. Bordi do të zëvendësojë Grupin e Rregullatorëve të shërbimeve Audiovizuale (ERGA) të krijuar nga Direktiva e BE-së për Shërbimet e Mediatike Audiovizive (AVMSD). Organi i ri do të ketë një rol të veçantë në luftën kundër dezinformatave, ndërhyrjeve të huaja dhe manipulimit të informacionit. Prandaj, Bordi Evropian do të koordinojë masat e rregullatorëve kombëtarë në lidhje me shërbimet mediatike të ofruesve që janë jashtë BE-së, ndërsa targetojnë audiencën e BE-së dhe paraqesin rrezik për sigurinë dhe mbrojtjen publike. Bordi ka kompetenca të promovojë zbatimin efektiv dhe të përhershëm të Ligjit të ri për lirinë e medias dhe kornizës më të gjerë ligjore për median, të ofrojë këshilla të ekspertëve për aspektet rregullatore, teknike ose praktike të rregullimit të medias, opinione mbi masat kombëtare në lidhje me përqendrimin e medias dhe promovojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet rregullatorëve kombëtarë të medias.

## Plani i Veprimit Evropian për Media dhe Çështje Audiovizuale

Plani Evropian i Veprimit për Media dhe Audiovizual është një paketë masash të miratuara nga Komisioni Evropian për të mbështetur rimëkëmbjen dhe transformimin e sektorit mediatik dhe audioviziv evropian. Karakteristikat dhe objektivat kryesore të tij përfshijnë:

132 Shiko: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?qid=1608117147218&kuri=COM%3A2020%3A825%3AFIN>

133 Commission of the European Union (2022) European Media Freedom Act (DRAFT, presentation) [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_22\\_5504](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_5504)



- Promovimi i rimëkëmbjes dhe transformimit të sektorit mediatik dhe audioviziv përmes masave mbështetëse të synuara si financimi, trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve,
- Përmirësimi i diversitetit dhe cilësisë së përmbajtjes mediatike dhe audiovizive evropiane dhe forcimi i konkurrencës së produksioneve evropiane,
- Sigurimi i kushteve të barabarta për të gjithë lojtarët në tregun e vetëm digjital, duke përfshirë mediat tradicionale dhe platformat e reja online,
- Mbështetja e zhvillimit të teknologjive të reja dhe modeleve afariste që mund të ndihmojnë mediat evropiane dhe kompanitë audiovizive për inovacion dhe përshtatje me ndryshimet e kushteve të tregut,
- Mbrojtja dhe promovimi i vlerave themelore të demokracisë, pluralizmit dhe lirisë së shprehjes në sektorin mediatik dhe audioviziv

Transparenca luan një rol kryesor në Planin e Veprimit për Media dhe Çështje Audiovizuale, pasi konsiderohet si një mjet kryesor për luftë kundër dezinformatave dhe promovim të besimit në media dhe përmbajtjen audiovizive. Plani i veprimit përfshin masa për të përmirësuar transparencën në online reklamat dhe për promovim të edukimit mediatik dhe mendimin kritik midis qytetarëve. Ai synon gjithashtu të përmirësojë transparencën e pronësisë dhe financimit të medias dhe të mbështesë gazetarinë e pavarur dhe iniciativat për kontroll të fakteve. Duke përmirësuar transparencën, Plani i Veprimit për media dhe çështje audiovizuale kërkon të promovojë një diskurs publik më të informuar dhe të përgjegjshëm dhe të ndihmojë qytetarët të marrin vendime më të mira bazuar në informacione të sakta dhe të besueshme.

## Observatori Evropian për Media Digjitale

Observatori Evropian për Media Digjitale (EDMO) është një projekt që mbështet dhe bashkon kontrollues të fakteve dhe studiues akademikë me përvojë në fushën e online dezinformatave, platformat e mediave sociale, gazetarë dhe praktikues/aktivistë të edukimit mediatik. Observatori duhet t'u mundësojë atyre të koordinohen më mirë, të lidhen dhe të ofrojnë ndihmë në krijimin e politikave për parandalim të dezinformatave.

Aktet kombëtare  
në lidhje me  
dezinformatat

# Aneksi 2

## **Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018-2022)**

Në korrik 2018, Qeveria miratoi “Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike të RMV-së (2018-2022)”<sup>134</sup> dhe Plani i Veprimit (2018-2022).<sup>135</sup> Strategjia është në resorin e MSHIA-s dhe i referohet mbrojtjes së infrastrukturës kombëtare të komunikimit dhe informacionit dhe e trajton atë si një interes jetik kombëtar, mbi të cilin funksionojnë në shoqëri një numër i madh ekonomik, politik, financiar, social funksionet e shoqërisë, si dhe funksionet e sigurisë dhe ushtarake. Plani i veprimit synon disa fusha të mbrojtjes nga kërcënimet kibernetike, prej të cilave më prioritet është formimi i trupave punues për zbatimin e Strategjisë dhe identifikimi i saktë i infrastrukturës kritike të informacionit. Ai përfshin gjithashtu aktivitete në fushën e krimit kibernetik, qëndrueshmërinë kibernetike, sigurinë kibernetike, mbrojtjen kibernetike, si dhe bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në nivel kombëtar. Siguria kibernetike përkatësisht parandalimi i kërcënimeve kibernetike janë pjesë përbërëse e konceptit më të gjerë të parandalimit dhe luftës kundër kërcënimeve hibride, të cilat mjetullojnë kufijtë e zakonshëm të politikës ndërkombëtare dhe veprojnë në ndër-hapësirë ku njëkohësisht janë legale dhe ilegale, lufta dhe paqja, politika e jashtme dhe e brendshme përballen njëkohësisht.<sup>136</sup>

134 Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike e Republikës së Maqedonisë 2018-2022

[https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/ns\\_sajber\\_bezbednost\\_2018-2022.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/ns_sajber_bezbednost_2018-2022.pdf)

135 Strategjia Kombëtare për Siguri Kibernetike 2018-2022, Plani i Veprimit 2018-2022, në dispozicion në

[https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/AP%20v1.13MK.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/AP%20v1.13MK.pdf)

136 The European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats (Hybrid CoE), Hybrid threats as a concept, available at: <https://www.hybridcoe.fi/hybrid-threats-as-a-phenomenon/>

Strategjia nuk trajton problemin me dezinformatat, por përmban elemente dhe aktivitete që kanë pika kontakti me këtë problem, veçanërisht në lidhje me çështjen e kulturës kibernetike dhe kulturës së sigurisë kibernetike. Ai tregon se promovimi i një kulture të sigurisë kibernetike nënkupton inkurajimin e përgjegjësisë dhe të kuptuarit e kërcënimeve kibernetike në të gjitha sferat e shoqërisë, duke zhvilluar besimin e informuar të përdoruesve në shërbimet elektronike. Strategjia përcakton kulturën kibernetike dhe kulturën e sigurisë kibernetike si pjesë të qëllimeve të saj për forcimin e kapaciteteve kibernetike në shoqërinë maqedonase, si dhe në sektorin publik dhe privat. Ky synim është vendosur në bazë të vlerësimit se një pjesë e madhe e përdoruesve maqedonas të internetit nuk kanë ose kanë nivel të ulët të njohurive për kërcënimet kibernetike, gjë që i bën ata të ndjeshëm ndaj të qenit viktima të sulmeve kibernetike apo abuzimeve.

Në përputhje me këtë synim, Plani i Veprimit parashikon disa aktivitete për forcimin e kulturës së sigurisë kibernetike, tre prej të cilave mund të përdoren për ngritjen e kapaciteteve në shoqëri për njohjen dhe parandalimin e dezinformatave. Konkretisht, këto janë aktivitete<sup>137</sup> për:

1. Zhvillim dhe promovim të programeve mësimore dhe trajnime për siguri kibernetike në të gjitha nivelet e arsimit
2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive bazë për sigurinë kibernetike tek qytetarët me përfshirjen dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve përkatës
3. Ofrimi i edukimit dhe trajnimit dhe rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike në sektorin publik dhe privat.

Nga aspekti i kulturës së sigurisë kibernetike në shoqërinë maqedonase, me interes të madh janë konstatimet e raportit të ekspertëve për vlerësimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike.<sup>138</sup> Ajo i paraprin miratimit të Strategjisë, e cila në thelb është miratuar në bazë të njërit prej rekomandimeve të shumta nga Raporti. Sa i përket kulturës së sigurisë kibernetike në Maqedoni, raporti thekson se ajo nuk është në nivel shumë të avancuar dhe shumica e përdoruesve të internetit nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet dhe “besojnë verbërisht” teknologjitë e informacionit dhe komunikimit dhe shërbimet e internetit.<sup>139</sup> Në të thuhet se siguria kibernetike si temë nuk është e përfaqësuar mjaftueshëm në përmbajtjet e mediave tradicionale dhe atyre online. Arsyeja kryesore për mbulimin e dobët mediatik të sigurisë kibernetike dhe mungesën e interesit dhe njohurive për sigurinë kibernetike në publikun e gjerë. Njëkohësisht, me rëndësi të veçantë është vlerësimi se “shumica e përdoruesve (të internetit) nuk kanë aftësi për të vlerësuar në mënyrë kritike përmbajtjen që shohin ose praanojnë në internet.” Duke pasur parasysh se interneti, veçanërisht portalet e internetit dhe mediat sociale janë burimi kryesor i dezinformatave, ky vlerësim tregon problemin se shumica e përdoruesve të internetit në shoqërinë maqedonase mund të jenë lehtësisht të ndjeshëm ndaj dezinformatave, si formë e kërcënimeve hibride.

## **Strategjia Kombëtare për Ndërtimin e Rezistencës dhe Ballafaqimin me Kërcënimet Hibride**

Strategjia trajton dezinformata në një kuadër më të gjerë, si pjesë e kërcënimeve hibride. Termi “kërcënim hibrid” nënkupton një kombinim të aktiviteteve keqdashëse dhe subversive, të koordinuara dhe të sinkronizuara nga aktorë shtetërorë ose jo shtetërorë, të cilët përdorin mekanizma të fuqisë “të butë” (politike,

137 Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2018-2022, Plani i Veprimit 2018-2022, në dispozicion në: [https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/AP%20v1.13MK.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/AP%20v1.13MK.pdf)

138 Nagyfejeo E. , Weisser C. , Griffin M. (2018) Cybersecurity Capacity Review FYRM, available at:

[https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/reports/cmm\\_fyrom\\_report\\_final\\_13\\_august2018\\_2.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/reports/cmm_fyrom_report_final_13_august2018_2.pdf)

139 Ibid, str. 41, 9.

ekonomike, informative), për të dobësuar institucionet, ekonomitë dhe shoqëritë dhe kërcënojnë sigurinë e tyre.<sup>140</sup> Dokumenti thekson se kërcënimet hibride kanë një natyrë evolutive dhe për këtë arsye, përkufizimi i tyre “duhet të shihet gjerësisht dhe fleksibël”. Ato synojnë aspektet e cenueshme të shoqërisë (politike, ekonomike, ushtarake, civile ose informative) dhe “përfaqësojnë një kombinim të mjeteve ushtarake dhe jo ushtarake, duke përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, përdorimin dhe vendosjen e grupeve të armatosura të parregullta, si dhe përdorimin e forcave të rregullta ushtarake.”

Strategjia lokalizon metodat dhe instrumentet e kërcënimeve hibride dhe trajton problemin e dezinformimit brenda kësaj kornize. Ai thekson se “metoda më e dukshme e kërcënimit hibrid është përdorimi i instrumenteve në sektorin e informacionit. Operacionet informative mund të përdoren për të sulmuar drejtpërdrejt qeverinë, për të formuar opinionin publik dhe për të ndikuar në vullnetin që të bëhet rezistencë. Këto operacione janë të fokusuar në mënyrë specifike në elitën politike dhe sektorin civil dhe janë të sinkronizuara me aktivitetet politike, ekonomike, ushtarake dhe diplomatike të subjektit që krijon kërcënimin hibrid. Operacionet informative përfshijnë përdorimin e mediave, “bots” dhe “trolleve” në rrjetet sociale, por edhe metodat duke vendosur teori të rreme shkencore në publik, paradigma, koncepte dhe strategji që ndikojnë në administratën shtetërore, në drejtim të reduktimit të potencialit për mbrojtjen kombëtare.” Strategjia nuk ofron një përkufizim specifik për dezinformatat, përveçse thekson se ato paraqesin një rrezik të drejtpërdrejtë për qeverinë, elitën politike, sektorin civil dhe administratën publike dhe se “RMV duhet të ketë potencialin dhe kapacitetet për të zbuluar armiqësitë burimet e propagandës, dezinformimit dhe lajmeve të rreme.” Në të njëjtën kohë, theksohet se për përballim me operacionet informative nevojitet një ndërgjegjësim i lartë qytetar dhe aftësi për të krijuar një opinion kritik.

Strategjia përcakton gjashtë fusha të aktiviteteve operacionale për trajtimin e kërcënimeve hibride. Dezinformatat përmenden në disa. I pari nuk përmend drejtpërdrejt dezinformatat, por gjithsesi i referohet këtij problemi dhe parashikon mbrojtjen e procesit zgjedhor nga kërcënimet hibride, veprimtaritë armiqësore kibernetike dhe operacionet informative të kryera nga subjekte të tjera shtetërore dhe jo shtetërore. E katërta, e cila mbulon kërcënimet për shkaktimin e ndarjeve sociale dhe trazirave për të përmbysur qeverinë, përmes dezinformimit dhe operacioneve psikologjike, thekson nevojën e zhvillimit të vetëdijes kritike dhe edukimit mediatic tek qytetarët, si dhe arritjen e një niveli të lartë të tolerancës ndëretnike dhe ndërfaqetare. Fusha e pestë ka të bëjë me kërcënimet nga “trollët” e internetit dhe inteligjencën artificiale, në procesin e përhapjes së lajmeve të rreme dhe dezinformatave dhe operacioneve psikologjike. Këtu, Strategjia thotë se është e nevojshme që shërbimi publik radiodifuziv të zbatojë aktivitete planifikuese për përballje me lajmet e rreme dhe dezinformatat. Është gjithashtu e nevojshme që Qeveria të krijojë një sistem për komunikim strategjik, në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse shtetërore.

Për zbatimin e Strategjisë, u miratua një Plan Veprimi (2021-2025) i fokusuar në gjashtë fusha: politika, ekonomia, forcat dhe kapacitetet ushtarake dhe të sigurisë, shoqëria civile, sektori informativ dhe infrastruktura. Plani parashikon detyra që lidhen drejtpërdrejtë me përballjen me dezinformata në katër nga këto fusha:

- **Politika:** Qendra për menaxhim me kriza duhet të jetë pjesë e infrastrukturës kritike kombëtare dhe në gjendje t'i përgjigjet në mënyrë përkatëse kërcënimeve nga dezinformimi dhe të mundësojë komunikime të sigurta, në bashkëpunim me të gjitha ministritë (deri në vitin 2023). Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (deri në vitin 2022), i cili duhet të krijojë një Sistem për njohjen e hershme dhe paralajmërimin e dezinformatave në lidhje me procesin zgjedhor, (sipas shembullit të platformës britanike Resist Counter-dezinformation toolkit 2018),<sup>141</sup> dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, MSHIA.

140 Strategjia Kombëtare për Ndërtimin e Rezistencës dhe Ballafaqimin me Kërcënimet Hibride (faq. 2) <https://mod.gov.mk/storage/2021/12/Nacionalna-Strategjia-za-gradene-otpornost-i-spravuvane-so-hibridni-zakani-april-2021.pdf>

141 UK Government Communication Service (2019) RESIST: Counter-Disinformation Toolkit. Available at: <https://gcs.civilservice.gov.uk/wp-content/uploads/2021/11/RESIST-2-counter-disinformation-toolkit.pdf>

- **Forcat dhe objektet ushtarake dhe të sigurisë:** Agjencia për Rezerva të Mallrave duhet të krijojë një mekanizëm komunikimi (deri në vitin 2024) në rast të një situatë krize, lidhur me sigurinë e zinxhirit të furnizimit dhe vlerësimin e dezinformatave të mundshme lidhur me të, në bashkëpunim me MM, QMK, MPB, MSH, ME, MTL.
- **Shoqëria civile:** Të gjitha shkallët e detyrueshme të arsimit në programe (deri në vitin 2024) të përfshijnë përmbajtje për njohjen e metodave të manipulimit, dezinformimit dhe lajmeve të rreme. MPSOMZ është përgjegjëse në bashkëpunim me Këshillin për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Sektorit Civil, Departamenti për Bashkëpunim me OJQ të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë, MASH, SÇE, MPPS.
- **Sektori i informacionit:** Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë, përgjegjës për luftë kundër lajmeve të rreme dhe dezinformatave, duhet të krijojë një sistem për komunikim strategjik (deri në vitin 2022) në bashkëpunim me MM, MPB, MPJ, SÇE. Para së gjithash, Sektori Publik radiodifuziv në bashkëpunim me MASH-in duhet të përfshijë në program përmbajtje edukative për njohjen e lajmeve të rreme dhe dezinformatave dhe krijimin e aftësisë për mendim kritik. Gjithashtu, ministrinë në planet dhe programet e tyre vjetore duhet të planifikojnë bashkëpunimin dhe mbështetjen e projekteve të OJQ-ve të drejtuara kundër lajmeve të rreme dhe dezinformatave.

Institucionet bartëse/përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të përmendura duhet të paraqesin një herë në vit (deri më 30 dhjetor) njoftime për shkallën e realizimit të Planit të Veprimit, si dhe propozime për tejkalimin e tyre. Zyra e Këshillit për Koordinim të Bashkësisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit, një herë në vit, deri më 1 shkurt, duhet t'i dorëzojë Qeverisë informacione për zbatimin e Planit të Veprimit.

# Intervistë - pyetje për institucionet shtetërore - Ministritë

## Aneksi 3

1. Si i përkufizon ministria Juaj dezinformatat? A ka një përkufizim të harmonizuar në nivel të institucioneve qeveritare se çfarë paraqet nocioni dezinformim?
2. Cilat janë kapacitetet institucionale të Ministrisë suaj për të parandaluar përhapjen e dezinformatave? A zhvillohen trajnime për punonjësit e ministrisë për përballje me dezinformatat? Si i përgjigjeni sfidave të jashtme dhe të brendshme nga përhapja e dezinformatave?
3. Cilat janë përvojat e mëparshme të ministrisë suaj me parandalimin e spekulimeve dhe dezinformatave? Sa në kohë kanë qenë reagimet e ministrisë dhe si reagoni? A ka një protokoll të caktuar për reagim publik?
4. A mund të tregoni një shembull të një situatë ku jeni përballur me dezinformata në lidhje me resorin dhe punën tuaj, ndaj së cilës ju është dashur të reagoni? Cili ka qenë reagimi juaj, si ka qenë komunikimi me publikun dhe mediat? Cilat ishin metodat e komunikimit me gazetarët lidhur me temën: me telefon, personalisht, e-mail, konferenca për shtyp? Si ka rrjedhur procesi i dhënies së informatave me karakter publik?
5. Në vitin 2019 Qeveria miratoi një Propozim-Plan për luftë vendimtare kundër dezinformimit. Në këtë dokument thuhet se me transparencë më të madhe të institucioneve zvogëlohet mundësia e përhapjes së dezinformatave. Në vitet e fundit, Qeveria ka miratuar disa dokumente dhe iniciativa për forcimin e transparencës së institucioneve qeveritare: Strategjia e Komunikimit të Qeverisë së RMV-së, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Transparencë (2019-2021), Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Dhëna të Hapura ( 2018-2020), Plani i Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (PVQH) 2021-2023.

Cilat pjesë të këtyre dokumenteve i keni funksionalizuar në dokumentet tuaja të punës dhe në nivel të ministrisë? A zbatohen këto dokumente në punën e përditshme.

6. Transparenca aktive e Ministrisë për ... në vitin 2022 arrin në ... (nga 100 % të mundshme), me të cilën ministria është në grupin e institucioneve me ... transparencë aktive (përmbushja e detyrimeve nga 60% në 80%). Rezultatet e fokus grupeve me gazetarë nga ky hulumtim tregojnë se gazetarët shpesh kanë problem të gjejnë informacionin e nevojshëm në ueb-faqet e ministrive. Çfarë po bëhet në ministrinë tuaj për të përmirësuar transparencën?
7. Çfarë kapacitetesh ka ministria juaj për komunikim me qytetarët dhe për marrëdhënie me publikun? Sa punonjës ka në sektorin për marrëdhënie me publikun dhe komunikime?
8. Kush është përgjegjës për përditësimin e ueb faqeve? A monitorohet harmonizimi i versioneve të ndryshme gjuhësore dhe si?
9. Cila është përvoja juaj me aplikimin e mekanizmit për qasje të lirë në informata me karakter publik?
10. Përveç transparencës aktive, si mekanizëm për publikimin e informatave në faqen e ministrisë, si planifikon ministria të afirmojë transparencën e vendimmarrjes? Në cilin nga dokumentet strategjike të ministrisë afirmohet politika e transparencës dhe llogaridhënies?

### 3.a) Pyetje shtesë për ministri të caktuara

#### **Ministria e Punëve të Brendshme**

- Si punon Ministria e Punëve të Brendshme për të shtypur dezinformatat dhe kërcënimet hibride? Cilat janë njësitë në Ministrinë e Punëve të Brendshme që janë përgjegjëse për këtë? Me cilat institucione (të brendshme dhe të jashtme) bashkëpunon Ministria e Punëve të Brendshme në këtë fushë? Deri në çfarë mase, masat për të shtypur kërcënimet hibride dhe dezinformatat mund të përplasen me lirinë e fjalës dhe çfarë hapash ndërmerr Ministria e Punëve të Brendshme për përcaktimin e kufirit ndërmjet përballjes me kërcënimet hibride dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirisë së fjalës?

#### **Ministria e Ekonomisë**

- Pse nuk ka të dhëna për nënkategorinë e Koncesioneve në faqen e ministrisë? Përveç publikimin e informatave në faqen e ministrisë, si planifikon ministria të afirmojë transparencën e vendimmarrjes? Në cilin nga dokumentet strategjike të ministrisë afirmohet politika e transparencës dhe llogaridhënies?
- Çfarë masash merr Ministria e Ekonomisë për të komunikuar në mënyrë transparente me median/publikun lidhur me krizën energjetike dhe implikimet mbi inflacionin?
- Udhëzimet për zbatimin e procedurave të prokurimit publik parashikojnë se një nga kriteret për zgjedhjen e ofertës më të favorshme duhet të jetë vërtetimi se markat (për mallrat, shërbimet ose punimet) janë vendosur në një procedurë të hapur dhe transparente. Si, në cilin dokument, përcaktohen rregullat dhe mekanizmat për sigurimin e provave të tilla për zbatimin dhe vendosjen e një procedure të hapur dhe transparente?

### **Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës**

- Cili është progresi i grupit të punës për Transparencë dhe Përgjegjshmërinë në kuadër të Planit të Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur (PVH) 2021-2023? Pse raporti institucione-shoqata civile nuk është 50-50% brenda këtij grupi pune? Pse nuk ka informacion në faqen e internetit se janë mbajtur mbledhjet e Këshillit për koordinim dhe monitorim të procesit PVH për 2021-23?

### **Ministria e Arsimit dhe Shkencës**

- Si zhvillohet futja e edukimit mediatik në mësimin në shkolla? Pse pjesa e parë dhe e katërt u mbrojtën si të përshtatshme për këtë temë? Cilat janë pritshmëritë dhe planet?

### **Ministria e Kulturës**

- Cilat mekanizma korrigjues të llogaridhënies dhe transparencës janë paraparë gjatë zbatimit të programeve investive-ndërtuese të ministrisë, për të parandaluar manipulimet si me projektin Shkup 2014?
- Çfarë mekanizmash për garantimin e ekspertizës dhe transparencës parashikohen gjatë punësimit të kompanive ndërtimore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?

### **Ministria e Vetëqeverisjes Lokale**

- Si po ecën zbatimi i Kodit të Transparencës në nivel lokal, i cili u miratua në tetor 2022? Cilat janë pritshmëritë?
- Në pajtim me Planin e Veprimit për zbatimin e programit për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim 2021-2026, për periudhën 2021-2023, është miratuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale. Ndër të tjera, Ligji është miratuar me qëllim të promovimit të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies. Cilat nene të ligjit të ri i referohen transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies? Si do të ndikojnë këto ndryshime në praktikën e deritanishme të Inspektoratit Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale për të ndaluar referendume lokale? Në vitin 2017, inspektorati ndaloi 12 nisma për referendume lokale, gjë që është në përputhje me dispozitat e nenit 2 të Ligjit për Ratifikimin e Protokollit plotësues të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale për të drejtën për pjesëmarrje në çështjet e qeverisjes lokale. (2015).

### **Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor**

- Çfarë ndërmerr Ministria për të promovuar të drejtën e publikut për informacion në lidhje me kushtet me mjedisin jetësor, në përputhje me konventat e Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit, si dhe në përputhje me konventën e Aarhus-it, e cila parashikon qasje në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore? A planifikohet të vendoset përgjegjësi penale për shkeljen e së drejtës për informim për kushtet mjedisore?

### **Ministria e Drejtësisë**

- Si po zhvillohet zbatimi i Ligjit për Ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit? Ministria është përgjegjëse për përditësimin e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në mënyrë që të zbatohet neni 9, paragrafi 1 i Konventës, i cili i referohet Prokurimit Publik dhe Menaxhimit të Financave Publike. Çfarë ndryshimesh janë bërë në këto dy ligje? Në veçanti si zbatohet angazhimi i Nenit 9 të Konventës, i cili kërkon marrjen e masave për shpërndarjen publike të informacionit mbi procedurat dhe kontratat e prokurimit publik, si dhe informacionin mbi ftesat për tenderë dhe informacionin e duhur për dhënien e kontratave, duke i lënë kohë të mjaftueshme ofertuesve të mundshëm që të përgatiten dhe dorëzojnë ofertat e tyre?



### **Ministria e Shëndetësisë**

- Si komunikon Ministria e Shëndetësisë me pacientët në lidhje me krizën aktuale me mungesën dhe statusin e prokurimit të terapisë kritike (për shembull terapi për pacientët onkologjikë dhe pacientë me fibrozë cistike)? Çfarë mekanizma dhe rregullore ekzistojnë për llogaridhënie dhe përgjegjësi në kriza të tilla?

### **Ministria e Mbrojtjes**

- Cilat janë përvojat tuaja nga puna e Qendrës Rajonale për Marrëdhënie me Publikun (RCOJ/PARC)? Si po zhvillohet zhvillimi i kapaciteteve për përmablje me dezinformatat?
- Strategjia për Ndërtimin e Rezistencës Kombëtare dhe Ballafaqimin me Kërcënimet Hibrade i trajton dezinformatat si një instrument të luftës hibride. Në përgjigje të kërcënimeve të tilla, Strategjia tregon se është e nevojshme të ofrohet një shërbim i pavarur i transmetimit publik. Çfarë ndërmerr ministria për të realizuar një nga aktivitetet e parashikuara në Strategji, për ofrimin e një shërbimi të pavarur radiodifuziv?

### **Ministria e Transportit dhe Lidhjeve**

Uebfaqja e ministrisë ka një link për prokurimet publike, ku publikohen shpalljet për prokurimet publike, por njoftimet për kontratat e lidhura dhe kontratat e përfunduara nuk publikohen. Pse ndodh kështu?

# Intervistë – pyetje për organet qeveritare

## Aneksi 4

1. Si i përkufizon Qeveria keqinformatat? A ka një konsensus institucional për përcaktimin se çfarë është dezinformatë?
2. Si reagojnë institucionet ndaj sfidave të jashtme dhe të brendshme nga përhapja e dezinformatave? Cilat janë kapacitetet institucionale të Qeverisë për parandalimin e përhapjes së dezinformatave? A ka trajnime për punonjësit në Qeveri për përballje me dezinformatat?
3. Sa janë në kohë dhe sa të përgjegjshme janë reagimet e institucioneve tona, në mungesë të informacioneve të qarta dhe të sakta në opinion? Cilat janë përvojat e mëparshme të Qeverisë lidhur me veprimin në kohë dhe parandalimin e spekulimeve dhe dezinformatave?
4. Deri në çfarë mase e ndjek Qeveria qasjen e BE-së për luftë kundër dezinformatave? Nga njëra anë, Plani i Veprimit i BE-së për parandalimin e dezinformatave është i përqendruar në vetë-rregullim, dhe nga ana tjetër, BE-ja miratoi një ligj të ri për lirinë e mediave. Cili është qëndrimi i Qeverisë?
5. Plani i veprimit i BE-së për parandalimin e dezinformimit e trajton problemin e dezinformimit kryesisht si një kërcënim të jashtëm në një kontekst problematik gjeo-politik. Në Maqedoni, një pjesë e analizave tregojnë se dezinformimi është kryesisht i natyrës së brendshme dhe për qëllime të brendshme fitimprurëse, qëllime politike ditore. Në këtë kontekst, është e mundur që politikat për parandalimin e dezinformatave të kthehen në politika të heshtjes së publikut kritik, mbi të gjitha medias. Si mund ta parandalojë këtë Qeveria?
6. Çfarë po ndodh me zbatimin e Propozim-Planit të Qeverisë për veprim vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave dhe sulmeve ndaj demokracisë? Çfarë ndodh me punën e Grupit të Veprimit për koordinimin e institucioneve shtetërore për luftë kundër dezinformatave dhe sulmet ndaj demokracisë? Cili është mandati, kush e kontrollon dhe kujt i përgjigjet ky grup?
7. Në pikën gjashtë (6) të Planit të propozuar thuhet se me transparencë më të madhe të institucioneve zvogëlohet mundësia e përhapjes së dezinformatave. Vitet e fundit, Qeveria ka miratuar disa dokumente dhe iniciativa për të forcuar transparencën e institucioneve qeveritare. Cilat aspekte të këtyre dokumenteve i konsideroni kritike për parandalimin e përhapjes së dezinformatave? Fokus grupet me gazetarë nga ky hulumtim theksojnë problemin me nivelin e ulët të transparencës së institucioneve.

8. Monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë së Transparencës (2019-2021) konstaton se zbatimi u përball me vështirësi. A po planifikon Qeveria një strategji të re dhe një plan të ri veprimi? Nëse po, çfarë planifikon të përmirësojë me Strategjinë e re të Transparencës dhe çfarë implikimesh do të kishte një dokument i tillë në luftën për të parandaluar dezinformimin?
9. Cili është progresi i grupit të punës për Transparencën dhe Përgjegjshmërinë në kuadër të Planit të Veprimit të Partneritetit për Qeveri të Hapur (OGP) 2021-2023? Pse raporti institucione-shoqata civile nuk është 50-50% brenda këtij grupi pune? Pse nuk ka mbledhje të Këshillit për koordinimin dhe monitorimin e procesit POV për 2021-23? (Në faqen e internetit nuk ka informacion se janë mbajtur takime të tilla, ku monitorohet dhe diskutohet ecuria e POV 2021-23).
10. Indeksi i Transparencës Aktive nënvizon një pabarazi të madhe ndërmjet Qeverisë dhe ministrive për sa i përket përditësimit të faqeve të tyre të internetit dhe postimit të informacioneve online. Ministrinë e Mbrojtjes dhe Financave dhe Qeveria e RMV-së janë më lartë të ranguar në vitin 2021 me rezultate 100%; 94,4% dhe 93,5%. Nga ana tjetër, Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndër-Bashkësive ka rangimin më të ulët, me 28,3%. Ministrinë e tjera renditen ndërmjet 91% dhe 64%. Si planifikoni të arrini përaftrimin e vlerësimeve mes ministrive dhe qeverisë në funksion të transparencës aktive? Si përcaktohen kriteret, kush dhe si duhet të “mbushë” ueb faqet e ministrive?
11. Si planifikon Qeveria të kontribuojë në zhvillimin e mekanizmave efikas për korrigjim, nëse administrata e pushtetit ekzekutiv nuk lejon qasje në informata me karakter publik ose nëse vëllimi, saktësia dhe afati kohor i qasjes në informacione të tilla nuk është i kënaqshëm?

# Pyetje për fokus grupet me gazetarë

## Aneksi 5

1. Si e vlerësoni transparencën e institucioneve ndaj medias dhe gazetarëve? Cili është treguesi më i mirë i jo transparencës së tyre?
2. Cilat institucione në periudhën e kaluar i vlerësoni si më të hapura (më transparente) - listoni disa, dhe cilat si më të mbyllura - listoni disa.
3. Vëreni një tendencë përmirësimi/përkeqësimi të transparencës së institucioneve? Ku, pse?
4. Si i kontaktoni më shpesh institucionet, cilat metoda/kanale komunikimi dhe pse? Dhe si ju komunikojnë/informojnë zakonisht institucionet?
5. Si funksionon sot sistemi i konferencave për shtyp të Qeverisë, ministrive? A është ky një reflektim i transparencës për ju?
6. Sa informacione të sakta, në kohë, relevante dhe të detajuara gjenden në faqet e internetit të institucioneve shtetërore? Cilat janë më shumë/më pak transparente?
7. Si dhe sa kohë merrni informacione për çështjet aktuale sociale?
8. Për cilat tema në periudhën e kaluar keni pasur vështirësi në marrjen e përgjigjeve në kohë dhe të detajuara nga institucionet? Cilat ishin më të hapura/të mbyllura?
9. A përdorni mekanizmin për qasje të lirë në informata me karakter publik? Sa është apo nuk është jo efikas dhe pse/kur ndodh kështu?
10. Si e përkufizoni dhe dalloni dezinformimin nga informacioni?
11. Çfarë dezinformatash keni vënë re në periudhën e kaluar në fushën tuaj të punës dhe çfarë masash keni marrë?
12. Cila është arsyeja kryesore e dezinformatave në Maqedoni dhe cilët janë burimet, bartësit, aktorët e dezinformatave?

13. Nëpër cilat media shpërndahen më shpesh dezinformata?
14. Çfarë ndikon më shumë në vëllimin, fuqinë e dezinformimit në media?
15. A ka qeveria një strategji për luftë kundër dezinformatave? A jeni në rrjedhë dhe çfarë po zbatohet në praktikë?
16. Cili është rezultati i Planit të Qeverisë kundër përhapjes së dezinformatave?
17. Nëse dhe sa jo/transparenca e institucioneve, Qeveria (mund të) luajë rol në përhapjen/ parandalimin e dezinformatave? Deri në çfarë mase?
18. A ka një kurë, një parandalim kundër dezinformimit në hapësirën publike? Si në media, si në institucione, Qeveria?

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit “Përdorimi i gazetarisë së bazuar në fakte për ngritjen e vetëdijes dhe kundër dezinformatave në hapësirën mediatike në Maqedoninë e Veriut” financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet dhe pikëpamjet e Qeverisë Britanike.

